Rruga e Arbërit

Gëzuar Vitin e Ri 2018!

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 12 (140). DHJETOR 2017. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Aktualitet

Masakra në pyjet e Lurës është akuza dhe denoncim

Nga **Dr. Bajram Xheko**



Profil

Sakip Ngota, baxhieri i ndershëm dhe i punës

Nga **Osman Xhili**



Boks

Figura dibranësh - pishtarë të Rilindjes:

Sahit Najdeni, Josif Bageri, Jashar Erebara, Hafiz Sherif Langu, Izet Dibra

Nga **prof.dr. Bajram Xhafa**



PUNIMET FILLOJNË, NDËRSA KONTRATA NUK ËSHTË FIRMOSUR AKOMA

RRUGA E ARBRIT: detaje të urave dhe tunelit të Murrizit

Kompania "Gjoka Konstruksion" akoma nuk e ka hedhur firmën mbi kontratën me qeverinë shqiptare për ndërtimin e Rrugës së Arbrit, por një nënkontraktore e saj ka nisur punimet në vendin e quajtur Ura e Çerenecit.

Muajin e kaluar, gjatë vizitës së qeverisë shqiptare në Peshkopi, kompania prezantoi një video mbi projektin e rrugës. Video 5 minutshe tregonte gjurmën e rrugës, degëzimet dhe gjatësinë e saj, pjesën e ndërtuar, aty ku punimet vazhdojnë dhe segmentet e reja të saj.

Por ndërsa punimet kanë filluar, duket se firma në letër është vetëm një akt formal.

Ky proces nuk ka kaluar pa debat. Opozita ka akuzuar për shpërdorim të fondeve publike. Ndërsa qeveria thekson se Partneriteti Publik - Privat është e vetmja mundësi për të pasur me cilësinë më të lartë dhe kohën më të shpejt këtë vepër të rëndësishme të infrastrukturës publike.

Në numrin e Gushtit 2017 të gazetës ju kemi njohur me segmentet e rrugës së Arbrit, në ndërtim ose të reja, por një pjesë e rëndësishme e këtij aksi janë tunelet dhe urat,për të cilat, bazuar në dokumentet e Autoritetit Rrugor Shqiptar, po përcjellim për lexuesit materialin e mëposhtëm.

Lexoni në faqet 2-5



Foto: **Azem Deva**

Libraria "Fleta XXI"

LIBRI PRANË JUSH

Aty gjeni çdo numër të gazetës "Rruga e Arbërit", mund të pajtoheni ose mund ta porosisni librin tuaj.

Email: fletaxxi@gmail.com

FB: Librari FLETA XXI

NË BRENDËSI: ■Veprimtaritë që mund të bëhen gjatë "Vitit të Skënderbeut" ■ Masakrat osmane ■ Bisedë me Skënderbeun... ■ Heroina e heshtur ■ Kur Aqif Pasha kujdesej për Gollobordën ■ Adem Gjurra, nacionalisti që u përball me fashistët, gjermanët, regjimin komunist të Tiranës dhe Beogradit ■ Shkolla e parë shqipe në Kala të Dodës, mbartëse e traditave shekullore të dijes e shkollimit ■ Zambaku i Korabit ■ Pëllum Kaloshi, i riu premtues në botën e aktrimit ■ Piktori dibran Bajram Mata ■ Një bisedë me Nin Rajtën për Gjokë Doçin ■ Ditë festive në shkollën "Xhevdet Doda" ■ Dritan Jashari, pasues i artistëve që promovuan thesarin e këngës dibrane ■ Argjendi, vogëlushi dibran që përfaqësoi Shqipërinë në Europë ■ Ndahet nga jeta piloti Allaman Destan Isaku ■ Një amanet që dhimshëm po e përcjell ■ Një femër mund t'ia dalë

BOTIME: ■ Personalitete të letërsisë, artit e kulturës vlerësojnë librin e publicistit të njohur ■ "Shpirti rri zgjuar" i Astrit Gjunkshit ■ Në gjurmë të historisë të Dibrës dhe Bulqizës ■ Atdheu jam unë ■ Islam Çenga është një "istikam" në poezinë shqipe! ■ Dritë jete - një libër nga Mevlud Buci ■ Dibra nga Antikiteti në Monarki, një memuar historik i shkruar me dashuri dhe përkushtim ■ Trinom kujtese ■ "Frymëzimi im" i Dhurim Nazifit

Artikuj shkollor, libra, lodra, etj

LIBRARI "DYRRAHU"

Njoftohen lexuesit tanë në Durrës, se duke nisur nga ky numër, gazetën tonë mund ta gjejnë pranë rrjetit të librarive Dyrrah në Durrës. Gjithashtu, pranë kësaj librarie mund të porosisni çdo libër të autorëve dibranë, sidomos ato që mbajnë logon "Botimet M&B"

Gazeta "Rruga e Arbërit" është një media e lirë dhe e hapur.
Çdo kontribut me shkrime, abonime ose donacione është i mirëpritur!
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 12 (140). Dhjetor 2017
Gjendet në treg gjatë gjithë muajit tetor

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Korrespondentë të përhershëm:
Abdurahim ASHIKU
Osman XHILI
Alban TUFA
Hysen LIKDISHA
Samet ZAGRADI
Defrim METHASANI

Kontribuan për këtë numër:
Bajram XHEKO
Bajram XHAFA
Adem BUNGURI
Mina HYSA
Murat KOLTRAKA
Rruzhdi BITRI
Arsim KOLARI
Fatmir TERZIU
Beqir SHEHU
Metush SKEJA
Petro MEJDI
Sakip CAMI
Qazim SHEHU
Eduard DUKAJ
Çerçiz LOLOÇI
Bernard ZOTAJ
Zabit LLESHI

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

PUNIMET FILLOJNË, NDËRSA KONTRATA NUK ËSHTË FIRMOSUR AKOMA

Rruga e Arbrit: detaje të urave dhe tunelit të Murrizit

Kompania "Gjoka Konstruksion" akoma nuk e ka hedhur firmën mbi kontratën me qeverinë shqiptare për ndërtimin e Rrugës së Arbrit, por një nënkontraktore e saj ka nisur punimet në vendin e quajtur Ura e Çerenecit.

Muajin e kaluar, gjatë vizitës së qeverisë shqiptare në Peshkopi, kompania prezantoi një video mbi projektin e rrugës. Video 5 minutshe tregonte gjurmën e rrugës, degëzimet dhe gjatësinë e saj, pjesën e ndërtuar, aty ku punimet vazhdojnë dhe segmentet e reja të saj.

Por ndërsa punimet kanë filluar, duket se firma në letër është vetëm një akt formal.

Ky proces nuk ka kaluar pa debat. Opozita ka akuzuar për shpërdorim të fondeve publike. Ndërsa qeveria thekson se Partneriteti Publik - Privat është e vetmja mundësi për të pasur me cilësinë më të lartë dhe kohën më të shpejt këtë vepër të rëndësishme të infrastrukturës publike.

Në numrin e Gushtit 2017 të gazetës ju kemi njohur me segmentet e rrugës së Arbrit, në ndërtim ose të reja, por një pjesë e rëndësishme e këtij aksi janë tunelet dhe urat,për të cilat, bazuar në dokumentet e Autoritetit Rrugor Shqiptar, po përcjellim për lexuesit materialin e mëposhtëm.



Tuneli i Murrizit. 3246 m.

Tunelet e Rrugës së Arbrit

Do të jene tre tunele në Rrugën e Arbrit. Dy prej të cilëve, ai i Tujanit me gjatës 70 m dhe ai i Qafës së Buallit me gjatës 465 metra kanë mbaruar. Tuneli më i gjatë dhe më i rëndësishëm është Tuneli i Murrizit, i cili do të jetë me një gjatësi 3246 metra, me dy tuba kalimi.

Tuneli i Murrizit do të ndërtohet nga km 19+054 deri në km 22+300. Ai do të ketë një tub për trafikun normal me dy korsi me gjerësi 3.5m secila, si dhe një tub emergjence, paralel me atë të trafikut në një distance aksiale 25m. Këto dy tunele paralele bashkohen midis tyre me anë të 6 galerive të kalimeve tërthore, nga të cilat 4 janë për shpëtimin e këmbësorëve në një rast eventual (Galeri Shërbimi), dhe 2 të tjerët janë për nevojat emergjente të automjeteve (Galeri Emergjence). Seksionet përkatëse tërthore janë projektuar për të mundësuar për arritjen e qëllimit të këtyre galerive. Galeritë tërthore vendosen në largësinë 500m midis tyre përgjatë tërë tunelit. Kuota në hyrje është 835.95m mbi nivelin e detit.

Hapja e tunelit të Murrizit (tuneli i trafikut, emergjencës dhe galeritë) në projek ide është sipas Metodës së Re Austriake të hapjes së Tuneleve (NAMT – New Austrian Method of Tunneling). Pjerrësia tërthore brenda në tunel është 2.5%. Pjerrësia gjatësore e tunelit është 2.25%

Tuneli parashikon marrjen e masave të sigurisë sipas standardeve europiane. Në raste emergjence apo zjarri në tunel ai u mundëson plotësisht udhëtarëve të lënë mjetet e tyre dhe të shkojnë në një vend të sigurt, ndërkohë që garanton akses të shpejtë të ekipeve të zjarrfikëseve dhe të shpëtimit. Për këtë është parashikuar të ndërtohet një tunel emergjence paralel me atë të trafikut. Po kështu janë projektuar edhe galeritë e kalimit nga tuneli i trafikut në atë të emergjencës dhe anasjelltas (çdo 500m). Këto vendkalime do të jenë 2 cope galeri mjetesh dhe 4 cope galeri këmbësorësh, të gjitha të paisura me dyer sipas kërkesave të mbrojtjes nga zjarri e tymi. Sheshet e portaleve të tunelit mundësojnë hyrje/daljen e shpejtë të mjeteve të emergjencës në tunelin/galerinë e emergjencës, ndërsa ndentakimet e galerive te mjeteve me tunelin e trafikut dhe atë të emergjencës do të mundësojnë edhe hapësira vendqëndrimi për mjete.

Sistemi i Mbrojtjes nga Zjarri brenda në tunel përfshin hidrante, linja uji për hidrantet, sisteme fikje zjarri të veçanta, detektor zjarri e tymi, niqe (dhomëza) të mbrojtjes nga zjarri çdo 250m, rezervuar uji të posaçëm, prurje uji jo më pak se 1200 l/min për gjatë të paktën një ore, etj. Brenda në tunel çdo 125m ka dhomëza të thirrjes/lajmërimit të emergjencës. Tuneli është projektuar për t'u pajisur me instalimet e kërkuara elektro-mekanike të sigurisë dhe ventilimit.

Gjerësia e tunelit të trafikut me L=3246m përbëhet nga dy korsitë e trafikut më gjerësi 3.5m secila, dy kuneta anësore 0.35m të gjëra secila, dy trotuare: 2x0.85m, që kanë pjerrësi tërthore2% në drejtim të kunetave përkatëse, pjerrësia tërthore e korsive është -2.5%, ndërsa lartësia e lirë për trafikun është 5.00m.

Përmasat gabarite brenda për brenda tunelit të trafikut janë: baza 10.1m dhe lartësia 6.8m.

Tuneli i Emergjencës me L=3246m përmban korridorin e kalimit të mjeteve me b=3.5m, dy trotuare me b=2x0.7m=1.4m, lartësi të lirë kalimi H=4m, dhe pjerrësi tërthore të pjesës kaluese 2.5%. Përmasat e tij gabarite janë: baza 6.04m dhe lartësia 4.7m.



Prerje tërthore e Tunelit të Murrizit (galeria e tunelit të trafikut)

Tuneli/Galeria e kalimit nga tuneli i trafikut në atë të emergjencës është i ngjashëm me vetë Tunelin e Emergjencës. Të tillë do të jenë dy: km 20+300 dhe 21+300

Galeria e shërbimit/kalimit të këmbësorëve në tunelin e emergjencës konsiston në korridorin e kalimit me b=2.5m, lartësinë e korridorit të kalimit h=2.2m, dhe pjerrësi tërthore i=0%. Galeri këmbësorësh do të jenë 4 copë: km 19+300, 19+800, 20+800 dhe 21+800 me L=4x15.62 m.

Seksioni tërthor i aneksit për vend-qëndrimin e mjeteve në tunelin e emergjencës do te realizohet në km 20+300 dhe 21+300, secili me gjatësi 60m

Në të njëjtin progresiv me tunelin e emergjencës si më sipër, edhe Tuneli i kryesor (i trafikut) ka 2 anekse vendqëndrimi mjetesh në të dy anët e tij (km 20+300 dhe 21+300) me L2x60m. Seksioni tërthor i këtij aneksi ka këto tregues: dy korsi udhëtimi dhe dy korsi parkimi me nga 3.5 m secila, dy kuneta anësore si dhe trotuare. Përmasat gabarite të vendqëndrimit të jetëve këtu janë: baza 15.6m dhe lartësia 7.65m.

Tuneli i Murrizit parashikohet të ketë dy anekse të tillë ven-qëndrimi me gjatësi 60m secili. Në këtë 60 metërsh 40 do të përdorën për vendparkimin e mjeteve, 5m për aneksin

kryesore



Pamje nga punimet në Rrugën e Arbrit te Ura e Cerenecit. Dhjetor 2017.

e thirrjes/lajmërimit të emergjencës, 5m për aneksin e panelit elektrik, dhe 10m për shuarsin e goditjeve.

Tuneli kryesor është i pajisur edhe me vend-lajmërim i emergjencës dhe ato të mbrojtjes nga zjarri.

Të gjitha seksionet tërthore tipe të tuneleve, apo galerive, do të kenë dy veshje:) veshja primare dhe veshja e brendshme. Veshja primare përbëhet nga shtresa e torkretit me trashësi 10-30cm, rrjetë hekuri (deri në tre rrjeta), vendosja e kapriatës metalike harkore, ankera të gjatësive dhe tipeve të ndryshme për përforcimin e shkembit. Veshja e brendshme përbëhet nga 25-40cm trashësi betoni e hedhur në segmente tuneli 12m të gjata dhe hekur betoni sipas rastit .

Portalet e tuneleve do të trajtohen me përforcime të skarpatave të gërmimit me ankera, sikurse edhe tek gërmimet për trupin e rrugës.

Drenazhimi i tunelit do të realizohet në të dy anët e tij mbi thembrën përkatëse të tunelit me anë të tubave të drenazhimit, ku grumbullohen ujërat nëntokësore.

Sistemi i kullimit të ujrave sipërfaqësor të tunelit do të jetë prerazi veçmas atij të drenazhimit nëntokësor. Ai vendoset nën kunetë dhe përbëhet nga një tub beton-armeje sikurse tregohet në seksionet tërthore të tunelit. Në dalje të të dy anëve të tunelit do të ndërtohet një rezervuar që grumbullon ujrat e ndotura të këtij sistemi. Volumi i këtij rezervuari është 105 m3.

GJASHTË URAT E RRUGËS

Rruga e Arbrit do të ketë edhe gjashtë ura të reja, dy prej të cilave janë më të rëndësishmet: ajo e Vashës dhe e fshatit Fshat në Klos.

Gjeometria e seksionit tërthor të urave përmban: pjesa kaluese (korsitë) 2x3.5 m; kuneta e kullimit të ujit - b=2x0.5 si dhe trotuaret b=2x1.25. Totali i gjërësisë =10.5m

Ura B1: Ura B1 kalon mbi Lumin e Tiranës dhe vendoset ne km 8+360 – 8+524. Gjatësia e saj është 164m. Mbistruktura e kësaj ure do të realizohet me trarë të paratensionuar në formë "T" me lartësi h=1.8m. Mbi to do të vendoset soleta monolite me t=0.22m. Lartësia totale e mbistruksturës sipas llogaritjeve është 2.02m. Katër pilat e urës do të jenë rrethore me 33 diameter d=2.4m. Lartësitë e pilave variojnë nga 22 deri 35m. Kuota në hyrje është 356.41m mbi nivelin e detit.

Ura B2: Ura B2, përsëri mbi Lumin e Tiranës, shtrihet nga km 10+710 deri në km 11+026, me gjatësi 316m. Mbistruktura këtu do të realizohet me trarë të paratensionuar, ose dhe b-arme të thjeshtë të parapërgatitur në formë "T" me lartësi h=1.2m. Mbi to do të vendoset soleta monolite me t=0.22m. Lartësia totale e mbistrukturës është 1.42m. Gjithsej janë 15 grupe pilash dhe 2 ballna ure. Pilat e urës do të jenë mure masiv, sikurse dhe ballnat. Lartësitë e pilave variojnë nga 1.6 deri 6.6m. Kuota në hyrje është 372.67 m.

Ura B3: Ura B3 është projektuar mbi gjurme të re në krahasim me projektin e arkivuar ne ARRSH me synimin e eleminimit të Tunelit T2 (Guri Bardhe) dhe përmirësimin e gjurmes të rrugës në planin horizontal (më pak kurba dhe rreze me të medha), dhe atë vertikal (rruga ulet me rreth 77m). Vendndodhja e saj është km 28+304-28+636, ku përshkon një luginë të thellë pranë Fshatit Fshat. Gjatësia e saj është 332m.



Ura B1 mbi Lumin e Tiranës, 164m

Ura B2 mbi Lumin e Tiranës me gjatësi 316m.



Ura B3 përshkon një luginë të thellë pranë Fshatit Fshat. Gjatësia e saj është 332m.



Ura B4, ndryshe Ura e Vashës, ndodhet mbi Lumin Mat. Gjatësia e saj është 398m.

Kjo urë është projektuar si ramë rigjide konsol/kantilever. Ura është e kurbëzuar në planin horizontal. Mbistruktura e urës do të realizohet si box b-arme me h=8m në mbështetje dhe h=3m në mesin e hapësirës. Dy pilat/kollonat qendrore janë 51 dhe 67m të larta mbi tokën natural. Edhe pilat jane me seksion box katror 6x6m. Dy pilat/kollonat e tjera janë box 4x6m me lartësi rreth 31m. Ballnat e urës realizohen me beton-arme masive që do të inkastrohen në bazament shkëmbor. Kuota në hyrje është 554.26 m mbi nivelin e detit.

Ura B4 (Ura e Vashës): Ura B4, ndryshe Ura e Vashës, shtrihet në progresivat km 30+495-30+893 dhe ndodhet mbi Lumin Mat. Gjatësia e saj është 398m.

Edhe kjo urë do të realizohet si ramë rigjide me mbistrukturë tip konsol/kantilever. Në planin horizontal përsëri kemi një urë të kurbëzuar, gjë që kushtëzon projektim të kujdesshëm dhe masa shtesë ankorimi të këmbeve/pilave kryesore. Mbistruktura këtu do të jetë në formë boxi me përmasa lartësi 8m në mbështetje dhe 3m në mes të hapësirës. Ura mbahet nga tre këmbë/pila dhe dy ballna. Këmbet do të jenë 27, 62 dhe 70 m të larta. Struktura e tyre do të jetë box me përmasa 6x6m, që kanë një kapje rigjide me mbistrukturën, si dhe një inkastrim të plotë në shkëmbinj masiv të bazamentit. Ballnat do të përfaqësojnë struktura masive beton-armeje. Kuota në hyrje është 444.96 m Mbi Nivelin e Detit.

Ura B5: Fillon në km 63+090 të Rrugës së Arbërit (km 1+918 i Segmentit 6) dhe mbaron në km 63+302 (km 2+130 i Seg. 6), me gjatësi 212m. Kuota në hyrje është 482.29 m mbi nivelin e detit. Konstruksioni i mbistrukturës së kësaj ure parashikohet të realizohet me trarë "T" të parapërgatitur me h=1.2m, soletë monolite me t=0.22m. Lartësia punuese e trarëve është 1.42m. Ura ka dy ballnat dhe 10 këmbë. Lartësia e këmbëve varion nga 4.6m deri 10.6m.

Ura B6: Ndodhet mbi lumin Drin. Ajo fillon në km 66+870 të Rrugës së Arbërit dhe mbaron në km 67+162. Gjatësia e saj është 292m. Kuota në hyrje është 448.82 mbi nivelin e detit. Përsëri, mbistruktura e kësaj ure parashikohet të realizohet me trarë "T" të parapërgatitur me h=1.2m, soletë monolite me t=0.22m. Lartësia punuese e trarëve është 1.42m. Ura ka dy ballnat dhe 14 këmbë. Lartësia e këmbëve varion nga 3m deri 5.5m. Këmbët/pilat e urës do të jenë rrethore me d=1m.

Përgatiti: **Bujar Karoshi**

Burimi: Autoriteti Rrugor Shqiptar

Rruga e Arbërit nr. 140

aktualitet

Në imagjinatën time nuk arrij dot të rifotografoj dhe të perceptoj kompleksin lurian, krijuar prej mijëra e mijëra vjetësh, që karakterizohej dikur nga një harmoni e përsosur, me konturet e qarta të një eko-biosistemi impresionues...

Masakra në pyjet e Lurës është akuza dhe denoncim

Nga Dr. **Bajram XHEKO**



Rasti i Lurës është tipik i një kontrasti të dukshëm ballafaqimi ndërmjet së bukurës të kohës së shkuar dhe të shëmtuarës aktuale, të kohës moderne, që të trishton, por edhe të revolton. Shkatërrimi i masivit pyjor të Lurës është, në fakt, një requiem, një meshë speciale për "shpirtin" e dikurshëm të Lurës, tashmë inekzistente e të "vdekur".

Pergezoj dhe falenderoj inxhinjeret e apasionuar Hazis Porja dhe Abdulla Diku, per publikimin ne internet te fotografive lidhur me masakren pyjore te Lures, gje qe ka ngjallur komente te shumta nga nje numer i madh specialistesh. Keto jane fotografi te verteta, qe pasqyrojne realitetin e hidhur jo vetem te Parkut Kombetar te Lures por te te gjitha pyjeve te Shqiperise qe po japin shpirt e po zhduken, tamam si barka ne det te hapur qe po mbytet dhe ka leshuar sinjalin S. O. F (Save Our Forests) dhe askush nuk i shkon ne ndihme per ta shpetuar.

Kur i pashe keto fotografi, ne vecanti disa prej tyre qe jane me pikante dhe eksplicite ne paraqitjen e masakres, nuk po u besoja syve, mbulova fytyren me te dy duart, u trondita shume dhe ndjeva qe trupi m'u rrenqeth nga ky akt barbar, antipyjor, antishqiptar dhe antikombetar i cili, brenda nje kohe rekord prej disa vjetesh, zhduku nga harta e gjelbert e Shqiperise mrekulline magjepse natyrale, Parkun Kombetar te Lures.

Si qytetar i atij vendi dhe specialist i pyjeve shpreh indinjaten time te thelle dhe e denoj kete krim monstruoz qe ka cuar ne zhdukjen e atij parku, nje nder margaritaret e rralle te Ballkanit e te Europes. Per mua, shkaterrimi i kompleksit pyjor, liqenor e livadhor te Lures, perfaqeson " martirin " me te madh te pyjeve dhe te natyres shqiptare te cilin, duart e zeza te krimit, ne sherbim te nje politike antikombetare dhe antishqiptare, e rrafshuan njesh me token. Me te drejte, kete masaker Abdulla Diku, duke qene ne pozicionin e specialistit vizionar e patriot, e ka krahasuar me pasojat e bombardimit te Hiroshimes, kurse publicist Selman Meziu, qe njihet per perdorimin me mjeshteri te metafores, e ka quajtur holokaust natyror. Ka edhe shume pylltare te tjere qe e kane ngritur zerin e protestes dhe jane te revoltuar per krimet qe kryhe per dite e me shume ne pyje e s'kane te ndalur, por zeri i tyre, zeri i te gjitheve ne, bie ne vesh te shurdher. Ku eshte dora e shtetit? Ku eshte opinioni shoqeror? Ku eshte...? Asgjekundi! Tashme nje gje eshte e qarte si drita e diellit: ndikimet negative te nje akti te tille vetevrases e te pakuptimte kunder natyres do te shtrihen e do te ndihen edhe pertej kufijve te Lures, sidomos mbi regjimin hidrik, ne mbrojtjen e tokes nga gerryerjet, ne ekonomine e zones dhe, me kryesorja, ne perspektiven e zhvillimit te turizmit ne kete Tirol shqiptar. Shumekush nuk arrin te kuptoje, me sa duket, se natyra nuk ka nevoje per njerez por, jemi ne, njerezit, qe kemi nevoje per natyren dhe prandaj duhet te jemi te ndergjegjshem e te edukuar per t'a respektuar ate, per t'iu pershtatur natyres dhe per te zbatuar verberisht ligjet e hekurta te saj.

Ne imagjinaten time nuk arrij dot te rifotografoj dhe te perceptoj kompleksin lurian, krijuar prej mijra e mijra vjetesh, qe karakterizohej dikur nga nje harmoni e persosur, me konturet e qarta te nje eko-biosistemi impresionues, brenda te cilit cdo element perberes luante dukshem rolin e tij specifik dhe, te gjithe sebashku, si nje e tere e vetme: malet, liqenet dhe burimet ujore te pashterrshme, pylli, livadhet dhe fauna e pasur, qe i kam shijuar dikur, ndersa tani, qe po ballafaqohem me fotografite, me duket vetja sikur jam ne Saharane afrikane. Tronditja mu shtua akoma me shume kur me dilte parasysh Lura e fillimit te viteve '60 , qe e "kisha matur me pellembe" te cilen e kam pasqyruar edhe ne disa shkrimet e mia te meparshme si dhe ne korespondencen qe kam patur me ish studente dhe kolege. Shkaterrimi i parkut kombetar te Lures ka qene nje nder "temat e nxehta" te korespondences me ta. Keshtu, me date 18 Maj 2012 i kam derguar nje leter Selman Meziut lidhur me artikullin e tij, te botuar ne gazeten "Le Radici", Aprile, 2012, qe ben fjale per Luren, per bukurite natyrore te saj dhe shkaterrimin qe po perjetonin pyjet atje. Shkrimi shoqerohej nga dy fotografi me pamje qe mohojne njera tjetren. Njera me Luren e dikurshme te bukur, te gjelberuar me pyje dhe me liqene, kurse tjetra me Luren " e shemtuar ", qe lengon, e masakruar nga prerjet abusive dhe hajduteria e lendes se drurit, process ky qe do te conte me shpejtesi ne zhdukjen totale te pyllit.

Mbas vleresimit qe bera per artikullin, nder te tjera i shkruaj: " E lexova ate me nje fryme! ". Ti e kupton shume mire perse them keshtu. Kam lene atje nje pjese te jetes time dhe, ne kembim, kam marre me vete dhe ngulitur ne memorie kujtimet me te bukura e te paharrueshme per ate dhurate te pacmuar dhe unikale te natyres, qe nuk e gjen ne asnje vend tjeter te botes, gje per te cilen te shpreh pergezimet e mia dhe kenaqesine e vecante kur e lexova kete shkrim". Dhe me tej vazhdoj: "....duke u perqendruar tek shkaterrimi vandalist dhe shkretetimi i Parkut Kombetar te Lures, ti e ke shprehur zemerimin dhe dhimbjen e thelle qe te vlon perbrenda me ane te nje metafore brilante, kuptimplote: " Parku kombetar i Lures nuk ekziston, eshte zhdukur, ai tanime i shembellen nje kufome ne dekompozim te vazhdueshem ". Nje thenie fantastike! Ndonese Lura u shpall "Park Kombetar" shume vite perpara, asnje here ajo nuk e gezoi kete status ne praktike. Vendimi nuk u mbeshtet me fondet perkatese dhe nuk u shpenzua asnje qindarka per te siguruar mbrojtjen e parkut ne rradhe te pare, per te mirembajtur e permiresuar gjendjen ekzistuese. Gjithcka mbeti ne leter dhe ne sirtaret e zyrave, mbeti ne fakt nje " Res Nullus ".

Rasti i Lures eshte tipik i nje kontrasti te dukshem ballafaqimi ndermjet se bukures te kohes se shkuar dhe te shemtuares aktuale, te kohes moderne, qe te trishton por edhe te revolton. Shkaterrimi i masivit pyjor te Lures eshte, ne fakt, nje requiem, nje meshe speciale per "shpirtin" e dikurshem te Lures, tashme inekzistente e te "vdekur". Eshte requiem per Luren tone te dashur, qe s'ishim te zot t'a mbronim, per Luren e te gjithe shqiptareve, per Luren e te gjithe Shqiperise, qe eshte gjymtuar, sakatosur, zhdukur e fundosur si dikur Atlantis! Eshte requiem per vepren makabre te Neronit shqiptar qe, me nje ndjenje autosugjestive perverse, te papermbajtur per veteshkaterrim e vetmohim negative ne permasat e "Doomsday" apo te "Giorno del Giudizio", brenda nje harku kohor " sa hap e mbyll syte " e ktheu mijra, mijra, mijra vjet mbrapa kete copez parajse prrallore te planetit tone, kete perle e kaluar perlen (sikurse te gjitha pyjet, shkurret, zabelet, korijat, livadhet e gjithcka te gjelbert qe mbulonte dikur Shqiperine) dhe e transformoi ate ne nje rrenoje, ne nje " toke te djegur ", ne nje deshmitare qe akuzon per krimet qe jane bere ne pyjet e Shqiperise. Sa keq, sa trishtim, sa deshperim dhe tronditje qe gulcon perbrenda cdo shqiptari.

Per mua, qe e njoh shume mire Luren, qe kam punuar e jetuar atje, kur e pashe "te lincuar" ne fotografi, u shokova aq shume sa mu mbushen syte me lot. Mu kujtuan me nje here pyjet e dendur dhe toponomia e grumbujve pyjore qe e perbenin: Krej Lure, Borie Lure, Fushe Lure, Lan Lure. Mu kujtuan liqenet te alternuar me njeri-tjetrin nga breza pylli, ku shquhej liqeni i luleve per bukurine e tij te rralle dhe kenaqesine e vecante qe te jepte, qe terhiqte me shume vizitore. Arkitekti-natyre cdo gje e kishte konceptuar e ndertuar ne perfeksion! Gjate viteve qe punova ne Peshkopi dhe Burrel, me lidhte shpesh puna qe te kaloja permes liqeneve dhe do ndaloja patjeter tek ai i luleve per te shijuar ujin e burimit qe ishte aq i ftohte dhe aq i lehte! Ai me hiqte lodhjen qe ndjeja nga rruga e gjate malore qe beja ne kembe per te ardhur deri ketu. Ishte nje burim i vogel, i improvizuar, ne anen e siperme te liqenit, bash ne rreshtin e pare te drureve , ku fillonte skaji i pyllit. Nuk e ekzagjeroj te them se kam qene fatlum qe kam pire ate uje. Ishte ilac i vertete.

U zgjata me shume se c'duhet, per te shprehur kenaqesine e rralle qe kam ndjere, dhe ndofta privilegjin qe gezoja, kur , ndodhesha ne Lure: goja me shijonte ujin me te mire ne bote, syte kenaqeshin duke soditur panoramen e mrekullueshme plot kontraste te bukura, mushkerite me mbusheshin me ajer te paster, te filtruar e te oksigjenuar, nervat me qetsoheshin duke degjuar cicerimat e zogjve qe fluturonin te lire, te gezuar e te dashuruar me njeri – tjetrin ne hapsiren e gjelbert e te pafund dhe, here pas here, doktori i pyllit, qukapiku, "vizitonte" druret "paciente" dhe i pastronte ata nga krimbat, larvat e cdo parazit, duke thyer monotonine me zhurmen e embel, cukitjen e tij te zakonshme prej qukapiku. Keto ndjenja, keto kujtime te paharruara, qe pushtuan tere qenien time sot, mbas afro 50 vjetesh, kur po flasim per katastrofen pyjore ambjentaliste te Lures, per bukurite dhe madheshtine e dikurshme te saj, me ftojne te denoj e te mallkoj qeverite e djeshme e te sotme per kete kasaphane bioekologjike, per kete krim makaber te permasave gjigande qe e kane lejuar te kryhet ndaj natyres se bukur shqiptare, ndaj kesaj pasurie kombetare, ndaj ketij thesari qe ja kalon cdo banke.

Per me teper, shkaterrimi i pyjeve te Shqiperise dhe sidomos i Parkut Kombetar te Lures, perben nje krim akoma me te madh per brezat e ardhshem, te cilet do te na mallkojne. Dhe me te drejte! Ndofta, shume pak mund ta dine se pyllit,si komponent kryesor i ekuilibrit te peizazhit gjeografik, i duhen te pakten pese-gjashte shekuj qe te rimarre veten dhe, akoma me shume, te gjallerohen liqenet me uje e te duken ne to troftat e peshqit e tjere.

Lura ngjante dikur me peizazhin zviceran. Ngjante ne miniature me Luzernen, qe une kam pas rastin ta vizitoj ne vitin 1993. Lura, sikurse Luzerna, ashtu sic u permend me siper, dallohej nga kombinimi i shkelqyer i bukurise se pyjeve me pisha, ah e bredh, ku strehohej nje faune e pasur me shpend e kafshe te egra, me liqenet e kristalte mbushur me zambake te bardhe (Nymphaea albaL.), qe notonin mbi uje " si pelikane te krekosur", me malet e larta qe mbuloheshin me debore, me burimet e ftohta qe rridhnin ujin me te mire ne bote, me ajrin e tejngopur me oksigjen, me livadhet e gjelberta ku spikaste ai i njohur si Livadhi i Pelave, ku rriteshin ne te barera te hardallisura te llojeve te ndryshme, disa te rralla ne Ballkan e me gjere, me lule te bukura shumengjyreshe qe arrinin lartesine deri tek gjuri i kalit, nje nga livadhet natyrore me te medha te vendit tone. Nje parajse e vertete! Nuk e teproj aspak po te shprehem ne menyre figurative se: "...Lura perfaqesonte dikur nje pikture te permasave gjigande, nje kryeveper te persosur arti, realizuar prej mijra vjetesh nga autori Nena Natyre, e denje per tu vendosur ne muzeun e Luvrit

investime

Pyjet jane pjese e problemit global dhe do te zgjidhen vetem ne kuader te tij. Vetem atehere do te filloje puna e vertete e per se mbari per te ardhmen e pyjeve dhe per rigjelberimin e Shqiperise.



ne Paris, krahas kryeveprave te tjera te artit boteror! Akoma me teper se kaq, Lura ishte nje diamant i peizazhit shqiptar "...Keshtu ishte Lura kur gezonte ende " imunitetin natyral ". Po tani? Ajo eshte shnderruar ne nje toke te cveshur, e braktisur perfundimisht nga gjelberimi dhe ngjyra e gjelbert, eshte kthyer ne nje shkretetire artificiale nga njeriu i pa kulturuar e injorant qe vetem di te prese e te shkaterroje natyren, ta vrasi ate me nje pasion primitiv diabolik!?! O zot c'po ndodh ne vendin tone! Jemi tamam ne nje situate te ngjashme me konkluzionin qe ka nxjerre shkencetari psikiater austriak Dr. Sigmund Frojd (S. Freud) nga eksperimentet dhe studimet e kryera para luftes se dyte boterore lidhur me instiktet njerezore, ndergjegjen, memorien, emocionet, egoizmin, histerine etj. Frojdi arriti, pak a shume, ne perfundimin se: "modernizmi i njeriut te sotem nuk mund t'ia shkule nga ndergjegjia jeten primitive te shpellave ku kane jetuar brezat e hershem..." , ide te cilat u kristalizuan me vone si " rryma frojdizmi " dhe u perqafua nga letersia perendimore. Ne kete menyre mund te thuhet ne vazhdim, neqoftese fillimi i shekullit XX ishte per shqiptaret shekulli i legjendes se bukes dhe i apotheozes se misrit, shekulli XXI e me tutje do te perjetesohet e do te mbahet mend nga brezat pasardhes si shekulli dhe mijevjecari i legjendes se pyjeve. Shqiperine parajse te para 200 vjeteve qe pershkruan i madhi Naim Frasheri ne vepren "Bageti e Bujqesi", kur mbreteronte nje ekuiliber natyror ideal dhe i harmonizuar: me male te larta, me lisa te gjate, me fusha te gjera me lule, me bregore bukuroshe, me lumenj te kulluar, me cuka, kodra, brinje e gerxhe dhe pyje te gjelberuar, nuk e kemi me, eshte zhdukur bashke me "parajsen pyjore". Kjo tashme eshte nje e vertete e hidhur dhe e dhimbshme jo vetem per njerezit e pyjeve por per cdo shqiptar patriot. Natyra shqiptare e asaj kohe do te kujtohet me nostalgji nga brezat qe do te vijne, do te kujtohet si parajse e humbur, si nje perralle, si nje enderr e bukur dhe e pa besueshme se ka ekzistuar dikur mbi truallin shqiptar. Brezat qe do te vijne do te mund ta perceptojne pyllin shqiptar ndofta nepermjet librave dhe dokumenteve arshivore, po qe se do te ruhen e s'do te zhduken apo digjen sipas tradites psikologjike shqiptaro-ballkanike. Kush pergjigjet per keto krime te mireorganizuara, per kete regres galopant anthropogjen te Lures? Kush pergjigjet per keto vandalizma e anarshi qe ndodhin ne pyjet tona, jashte cdo logjike njerezore dhe te paimagjinueshme per nje vend e shtet te qyteteruar europian? Deri me sot asnje funksionar shteteror e partiak nuk ka dhene llogari per keto krime e te behet shembell per te tjeret. Le te shpresojme se do te ndodhe!?

Ajo eshte shnderruar ne nje toke te cveshur, e braktisur perfundimisht nga gjelberimi dhe ngjyra e gjelbert, eshte kthyer ne nje shkretetire artificiale nga njeriu i pa kulturuar e injorant qe vetem di te prese e te shkaterroje natyren, ta vrasi ate me nje pasion primitiv diabolik!?! O zot c'po ndodh ne vendin tone!

Diskutimet qe ngjallen fotot per pyjet e Lures dhe ku moren pjese nje numer shume i madh specialistesh, tregojne se kemi te bejme me nje problem te mprehte, qe kapercen kufirin strikt pyjor dhe implikon edhe aspektin shteteror, ekonomik, politik, shoqeror etj. Me terhoqen vemendjen dhe vleresoj mendimet e shprehura nga kolegu im i mirenjohur Fadil Llubani dhe te ish studenteve Selman Meziu, Kristo Kauri, Kleanthi Mandi, Shyqyri Bushati, Palush-Jolanda Alia, Riza Doda, Petrit Ruka, Qazim Murati, Bedri Ormenaj, Ilir Gurabardhi. Ndonje komentues ka ngritur me te drejte problemin e pergjegjesise te organeve pyjore per shkaterrimin e Parkut Kombetar te Lures dhe te pyjeve ne pergjithesi. Sigurisht, pergjegjesia per mbrojtjen e pyjeve te Shqiperise, si kudo ne bote, normalisht qe bie mbi organet dhe personelin e sherbimit pyjor. Por, ne kushtet kur administrate pyjore ne Shqiperi ka pesuar, pak a shume, fatin e juristeve universitare qe u zevendesuan me kursantet e kursit te plepave, kur ne minisrine perkatese nuk ekziston nje drejtori , qofte edhe modeste ne personel, qe te drejtoje e kordinoje problemet pyjore ne shkalle kombetare(nje kerkese kjo e bere ne nje nga shkrimet e fundit te Selman Meziut) dhe kur, akoma me keq, nuk kemi ende nje polici pyjore, e cila ekziston edhe ne vendet me te varfra e me te prapambetura te botes, kuptohet qe organet pyjore kane pjesen me te vogel te pergjegjesise ose nuk e ndjejne ate fare.

Pergjegjesia kryesore per gjendjen vajtuese te pyjeve tona, sikurse per deshtimet ne te gjitha fushat e tjera bie mbi ata qe kane drejtuar e vazhdojne ta drejtojne ate vend, pergjegjesi e cila, fatkeqesisht, kamuflohet me vellon e demokracise dhe abuzimin me aspiraten per t'iu bashkuar Bashkimit Europian.

Pse keto fenomene negative ne permbajtje dhe ne permasa kombetare qe shqetesojne dhe ngjallin pasiguri te vazhdueshme ndodhin ne pyje, ne ekonomi, ne shoqeri, ne politike e gjithcka, te cilat pleksen me njera tjetren dhe formojne nje konglomerat qe, me efektin bomerang, na godet vazhdimisht e kudo? Pyes veten time dhe nuk gjej pergjigje! Shkaqet mund te jene disa...

Sikurse permenda me lart, Livadhi i Pelave, krahas masivit pyjor qe ekzistonte dikur, ishte nje komponent i rendesishem, qe plotesonte spektrin e diversitetit biologjik te peizazhit lurian. Per kete super-super perle, per kete thesar te botes bimore shqiptare, me date 5 Shtator 2011 i jam drejtuar me nje pershkrim te posacem ish studentit, tani kolegu im i respektuar Haki Kola, ku nder te tjera theksoj:--- Nuk e di ne se ke rastisur te ndodhesh ne kete livadh e te shijosh bukurine e tij te rralle e magjepse ne periudhen mesi i Majit – mesi Qershorit para se ai te prishej? Mua me ka rene rasti shpesh te jem ne kete periudhe duke qene se punoja ne ndermarrjen pyjore te Peshkopise. ... Kenaqesia qe ndjeja ishte e vecante kur ndodhesha ne mes te ketij livadhi malor aq te madh sa qe nga njeri cep tek tjetri kalorsi i hypur ne kale te dukej sa nje tullumbace e vogel.

Nuk e teproj te them se bari me lule ngjyra-ngjyra me vinte deri ne brez dhe perbehej nga nje flore e pasur ne lloje, madje edhe me specie endemike qe nuk i gjeje ne asnje vend te Ballkanit, qe sherbente si strehe " luksoze " per lepujt e shumte, dhelprat e mjaft gjallesa te tjera, karakteristike per faunen e ketyre zonave. Ndjeja atehere sikur te gjitha organet e trupit: truri, syte, mushkerite, zemra fillonin automatikisht e me shpejtesi rrufe te riprogramonin ne keto kushte te reja, teper specifike, ku mbreteronte nje qetesi absolute, nje gjelberim i pafund barishtor e pyjor qe e rrethonte dhe nje ajer i mbingopur me oksigjen. Shkurt, nje parajse e vertete.

Pikerisht kete perle, kete muze te natyres shqiptare qe ishte krijuar prej qindra e qindra vjetesh, qeveria e atehershme ne vend qe ta ruante e t'a trajtonte si birin e vetem , ne vend qe t'ia propozonte UNESCO-s si pasuri me vlera unikale natyrore e shkencore per tere Europen, kreu nje krim barbar duke e shkaterruar ate. Ushtria e plugoi duke e mbjelle me patate qe nuk prodhoi dot asnje kokerr dhe as faren qe u hodh ne te. Une jam nje nder deshmitaret okulare te ketij krimi monstruoz. Ndjeva me pas nje trishtim te thelle kur pashe ngjyren e murrme te ketij ish livadhi te kthyer ne nje shkretetire te tipit malor!.

Si reagim ndaj masakres pyjore, u perpoqa te sjell kujtimet e mia mbi kompleksin gjeografik, ekologjik e biologjik te Lures, ashtu sic e kam pare e njohur dekada me pare.E kam pershkruar ate me menyren time, duke perseritur pjeserisht edhe ndonje pasazh, me qellim qe specialistet e moshave te reja te mesojne sa me shume e sa me mire per madheshtine reale te Lures, pa qene domosdoshmerisht e tepruar nje gje e tille, por domosdoshmerisht e ngarkuar me emocione, te cilat i japin asaj dimensionin e vertete dhe shkelqimin e dikurshem, emocione te cilave nuk mund t'u shpetosh dot. Ne kete menyre do te mund te kuptohet drejte e te justifikohet perse une dhe shume te tjere perdorim ne menyre te perseritur epitete superlative si margaritar, perle, magjepes etj.

Nga sa u parashtrua me lart lind natyrshem pyetja: pse keto fenomene negative ne permbajtje dhe ne permasa kombetare qe shqetesojne dhe ngjallin pasiguri te vazhdueshme ndodhin ne pyje, ne ekonomi, ne shoqeri, ne politike e gjithcka, te cilat pleksen me njera tjetren dhe formojne nje konglomerat qe, me efektin bomerang, na godet vazhdimisht e kudo? Pyes veten time dhe nuk gjej pergjigje! Shkaqet mund te jene disa.

Realiteti tregon qarte per nje krize akute e te thelle, te gjithanshme, morale, politike, ekonomike, ideologjike e psikologjike neper te cilen po kalon sot shoqeria shqiptare. Ajo nuk ka arritur te behet sensitive ne menyre qe zeri i saj te prodhoje efekte tektonike mbi cdo individ e institucion, ashtu sic ekziston ne shtetet e perparuara te perendimit. Ajo ndodhet ne nje krize ndergjegjeje dhe ndergjegjesimi qe reflekton mungesen e aftesimit per te te marre ne duart e saj fatet e popullit shqiptar dhe drejtimin e vendit ne rrugen e duhur drejte nje te ardhme te sigurte e te lumtur. Per rrjedhim, SHOQERIA SHQIPTARE nuk ka arritur te pervetesoje e te zbatoje standartet perendimore per te qene PLOTESISHT E INTEGRUAR, KOMPAKTE DHE DEMOKRATIKE.

Shoqeria shqiptare, qe nga shpallja e pavaresise se vendit e deri me sot, nuk ka arritur te ndertoje nga themelet nje SHTET MODERN DEMOKRATIK, qe te bazohet ne ligj, qe te godase krimin dhe pandeshkueshmerine e krimeve te kryera, shtet qe te garantoje te drejtat themelore te njeriut dhe te udheheqe me konsekuence luften pa kompromis kunder korrupsionit.

EKONOMIA SHQIPTARE, nga ana tjeter, nuk po arrin te formoje fizionomine e saj, per te qene fleksibel per t'iu pershtatur e pergjigjur ne menyre krijuese konjukturave te tregut te brendshem e te jashtem, gje qe do te conte ne hapjen e vendeve te punes, ne rritjen e te ardhurave personale dhe te nivelit te jeteses se popullit. POLITIKA SHQIPTARE vazhdon me kembengulje traditen e vjeter te kundervenies haptazi unitetit te popullit dhe interesave te tij legjitime, ta mbaje ate te percare e ta sundoje ne funksion te interesave partiake dhe ne sherbim te nje grupi te vogel, te cilet zoterojne milionat e grabitura nga pasuria kombetare nga viti 1990 e deri me sot dhe bejne me to nje jete te shfrenuar luksoze, si karshillek ndaj varferise qe perjeton nje popull i tere.

Ne keto kushte eshte naivitet, eshte deshire platonike dhe puro utopi te mendohet zgjidhja e problemit te pyjeve i shkeputur nga e tere gama e problemeve te tjera jopyjore qe permenda me siper. Zgjidhja e problemit pyjor eshte ne funksion dhe varet nga keto te fundit. Pyjet kane rrenje te thella te cilat nderthurren me rrenjet, po te thella, te kompleksit te problemeve te tjera qe ka vendi. Pyjet jane pjese e problemit global dhe do te zgjidhen vetem ne kuader te tij. Vetem atehere do te filloje puna e vertete e per se mbari per te ardhmen e pyjeve dhe per rigjelberimin e Shqiperise.

Kur te vije ajo kohe, qeveria qe do te drejtoje vendin, kujdesin per pyjet do ta kete si prioritet kryesor te aktivitetit te saj dhe jo si tani qe ato jane " brima e fundit e kavallit " dhe jane katandisur si " mall pa zot " mbi te cilat jane turrur hijenat per te shqyer edhe copat e fundit qe jane ende gjalle. Le te shpresojme se ajo dite, sado e larget qe te jete, do te vije!

Toronto, 3 Tetor 2017

Viti 2017 është "Viti i Skënderbeut", dhe në këtë kuadër, gazeta është e hapur për botimin e materialeve rreth kësaj teme. Ne e mbështesim kërkesën e grupit nismëtar drejtuar kryetarit të bashkisë së Dibrës dhe mbetemi të hapur për të ndihmuar në veprimtaritë që do të organizohet gjatë këtij viti.

Veprimtaritë që mund të bëhen gjatë **"Vitit të Skënderbeut"**

Nga **Murat KOLTRAKA**

Ky propozim i është drejtuar kryetarit të Bashkisë së Dibrës, në lidhje me veprimtaritë kulturoro-historike në kuadrin e vitit të Skënderbeut, të shpallur nga Kryeministri i Shqipërisë z.Edi Rama.

BAZA HISTORIKE E KËRKESËS.

1. Dibra është origjina dhe vendbanim i Kastriotëve dhe se heroi ynë kombëtar Gjergj Kastrioti është dibran.

2. Në Çidhën të Dibrës, heroi ynë Gjergj Kastrioti ka vendlindjen, këtu ka kaluar vitet e para të jetës.

3. Populli i Dibrës gjatë epopesë së Kastriotëve ka përballuar peshën më të rëndë të luftërave. Këtu u zhvillua beteja e parë me turqit, beteja e Torviollit më 1 gusht 1444, me pas 17 beteja të tjera nga 24 gjithsej në territoret shqiptare, si dhe beteja e fundit, rimarrja e Kalasë së Çidhnës në prill 1467.

4. Fshati Kastriot dhe Sina janë vendbanime të Pal dhe Gjon Kastriotit.

5. Gjergj Kastriotit, me t'u kthyer nga Nishi në Dibër, bëri të parin kuvend me fisnikërinë dibrane, më 14 nëntor 1443, ku u lidh besa dibrane në mbështetje të Heroit tonë Kombëtar, u hodhën bazat e ushtrisë çlirimtare dhe me 300 kalorës dibran Skënderbeu mori Krujën, ngriti flamurin Kombëtar.

6. Më shumë se kujtdo në krahinat e vendit tonë na takon ne, dibranëve, në këtë vit jubilar, të bëjmë veprimtari historiko-kulturore në vlerësim dhe kujtim të veprës legjendare të birit tone, Gjergj Kastriotit, Skënderbeut.

PROPOZOJMË KËTA MASA ORGANIZATIVE:

1.-T'i bëhet një kërkesë e veçantë Kryeministrit të Shqipërisë që në veprimtaritë historiko-kulturore, Dibrës t'i jepet prioritet për origjinën dibrane të Kastriotëve dhe kontributin e veçantë historik të tyre në mbështetjen ndaj Skënderbeut, në realizimin e planeve të tij për çlirimin e trojeve shqiptare nga pushtuesit otoman, duke u shoqëruar me mbështetje financiare.

2. Të ngrihet një komision nën drejtimin e Bashkisë Peshkopi-Bulqizë dhe komunës Dibër e Madhe për organizimin e veprimtarive historiko-kulturore.

VEPRIMTARITË QË PROPOZOJMË:

1. Të bëhet një konferencë shkencor me temën: "Skënderbeu dhe mbështetësit e tij dibran'', ku të referohet nga historianë dhe studiues nga të dy Dibrat, të Bulqizës dhe të ftuar të tjerë. Tematika e kumtesave të hartohet nga komisioni nismëtar.

2. Materialet e referuara në këtë konferencë shkencore të botohen në një libër të veçantë si dokumente historike për ndriçimin e historisë së Kastriotëve në trojet dibrane.

3. Të ngrihet një përmendore në fshatin Kastriot, ose në afërsi të tij ku të gjykohet më e arsyeshme.

4. Të vihet një pllakatë përkujtimare në kujtim të Masakrës së Çidhnës së 1 gushtit 1466, ku u shkuan në shpatë minimalisht, sipas kronikanëve të kohës, 8 000 veta gra, fëmijë dhe pleq të pafajshëm.

5. Në shkollën e mesme të Kastriotit, të Fushë-Alies, të Maqellarës të ngrihen dhoma muze kushtuar historisë së Skënderbeut në Dibër.

6. Të zbulohet Pusi i Gjon Kastriotit në Kastriot te Kulla, ose Kalaja e Gjonit si dhe fragmente të shkurtra të mureve rrethues.

7 . Të organizohen marshime nga rinia dibrane (e shkollave të mesme) në vendbanime të Kastriotëve, në Kastriot dhe Sinë, në kalatë dhe në vendbetejat e Skënderbeut në të dy Dibrat dhe në Bulqizë, të shoqëruara me biseda nga historianë dhe studiues të historisë së Kastriotëve.

8. Në shkollat e mesme të organizohen biseda me nxënës për njohjen e historisë së Kastriotëve në trojet dibrane dhe kontributin dibran në mbështetje të Heroit tonë kombëtar në realizimin e planit të tij për çlirimin e vendit tonë nga pushtuesi otoman.

9.-Të emërtohen rrugë dhe objekte me rëndësi me emrin e Skënderbeut në rrethin tonë.

10 -T'i kërkohet gazetës ''Ruga e Arbërit'' të hapë një rubrikë të veçantë me botime nga autor dibranë rreth kontributit të popullit dibran në mbështetje të heroit tonë Kombëtar, Gjegj Kastrioti, Skënderbeu.

Ne kemi hartuar një draft të temave për konferencën dhe shpresojmë në një takim sa më të afërt me përfaqësuesit e pushtetit vendor, të diskutojmë hapat e mëtejshëm.

GRUPI NISMËTAR

Masakrat osmane*

Tursun Bej



I thashë të dashurës: "Pse kjo tirania tënde?"
Më tha: "Megjithë këtë, mos vallë të kam braktisur?"
I thashë: "Në fund të fundit, ç'mund të bësh ti?"
Më tha: "Shpirtin të ta marr dhe s'do jesh veç një trup i zbrazët."

E kam thënë më herët se cili është synimi i renditjes së këtyre perlave të hijshme të vargjeve. Kushdo që e ka vëzhguar krahinën e Shqipërisë me aftësitë e veta perceptuese, e ka të qartë natyrën e saj kryeneçe; për këtë s'e ka parë, mjaftojnë dija dhe njohja. Në të vërtetë, ashpërsia e rrëpirave dhe vështirësitë e rrugëve të hyrjes në atë vend të mbushur plot me njerëz të ligj, janë të tilla që – me ç'thonë – as Aleksandri nuk ia doli dot të depërtonte.

Sulltani Pushtues – *shpirti i tij u prehtë në paqe* – herën e parë e kishte nënshtruar atë me një goditje të vetme dhe, siç e treguam, e kishte asgjësuar armikun, duke ndërtuar aty një fortesë të fuqishme me qëllim që të përforconte pushtimin. Kurse arsyeja e kësaj fushate të dytë në Shqipëri qe se raca shqiptare është bërë e tillë që në karakterin e saj kanë hedhur rrënjë mosbindja, këmbëngulja, rebelimi e arroganca. *Dhe ajo çka e ke për natyrë, nuk zhduket dot nga peripecitë e jetës!* Ata derra qenë nënshtruar dhe kishin pranuar zinxhirin vetëm nga tmerri prej kordhës gjakderdhëse të Sovranit. Skënderbe *Tradhtari* qysh në fëmijërinë e hershme ishte ushqyer me pluhurin e Fronit, por më pas kishte parapëlqyer rebelimin.

Kështu, kishte mbështjellë qafën me rrobën e mohimit të fesë, që është më e keqja e veshjeve, për t'u bërë komandant i një bande mëkatarësh të pafe. U arratis prej Fronit fatlum duke u vënë në krye të atyre të cilëve iu tha: "Unë jam biri i beut tuaj". Me t'iu larguar sysh shkëlqimi i shpatës së Sulltanit, njerëzit e prapë të kësaj province ngritën krye në vende të ndryshme të nxitur nga ky djall tundues dhe, me të në krye, me qëllim që të hidheshin kundër fortesës së Elbasanit, nuse e qiellit. Kurrën e kurrës mos ndodhtë që shqiponja me kthetrat e mprehta të bjerë pre e qifteve dhe e hutave!

Ndonëse ajo fortesë s'kishte rrezik të pësonte as gërvishtjen më të vogël prej armiqve të tillë, sepse dhe ndërhyrja e një *sanxhakbeu* do të kishte mjaftuar për t'i zmbrapsur, prej bindjes ndaj zellit sulltanor, Sundimtari vendosi të mos i linte as t'i qaseshin fortesës. Kupa e zareve të planit të tij u vu në lëvizje: Sulltani do të kthehej në ato anë dhe do të dimëronte në qytetin e Plovdivit.

Rasti e deshi që ai dimër të ishte tejet i ashpër, por prapëseprapë pati ditë këndelljeje e dëfrimesh. Atë dimër, *duke pasur parasysh atë çka do të sillte e ardhmja*, duke përfytyruar të ëmblat krijesa shqiptare, çdo burrë e kaloi kohën duke u argëtuar në shoqëri, me të ngrëna e të pira.

Afrohu! O zemër, le ta përballojmë këtë gjendje të dy bashkë.

Sa s'e kemi takuar të dashurën, të kënaqemi me përfytyrimin e saj.

Në kohën kur pranvera e vitit tetëqind e shtatëdhjetë e një (1467) zuri të shfaqte shenjat e Parajsës së madhërishme, bajraku – përhapës i fitores – u vu në lëvizje, duke përparuar bashkë me pushtimin dhe triumfin.

Për ta pastruar rrugën për atë Shah,
reja u bë shtëpiake e zefi ri fshesar.

Kësaj radhe u gjykua me vend të kalohet nga ana e Beratit.

Kalorës të shumtë në numër si milingonat e me kërcim luani,
armata në trazim e vlim të plotë.

mbërritën nga të gjitha anët dhe iu bashkuan ushtrisë perandorake. Ushtria u lëshua mbi krahinën e Shqipërisë si vërshimi i një armate të stërmadhe. Një vërshim që mbuloi majat e maleve, luginat e kodrat dhe hapësirat me pluhur, si të bëhej fjalë për përmbytjen e përbotshme, duke mbuluar krejtësisht atë vend të mbushur plot me njerëz të ligj.

Çdo vend ku këta mëkatarë rebelë ngujoheshin duke e kujtuar se do qe e pamundur të merreshin, *falë ndihmës së Zotit – lëvduar qoftë* – s'i bëri dot ballë mësymjes së luftëtarëve osmanë. Lugina e Buzursekut, ku këmba e *gaziut* deri atëherë s'ishte shkelur kurrë, është si një lug që nga të dyja anët ka male majat e të cilëve ngrihen deri lart në qiell. Lugaja e saj prek fundin e tokës dhe është e mbushur plot me njerëz të ligj të pafe. Me të mbërritur aty, punë e parë qe grabitja e çdo gjëje që gjendej në të dyja anët e saj. Sidoqoftë, për t'i dhënë të pafeve që gjendeshin aty mundësinë e nënshtrimit me dëshirë, Sulltani i ndali luftëtarët përpara se të hynin në atë luginë. Por meqë ata vazhduan të këmbëngulnin me kryeneçësi për të rezistuar, u desh që ata të ndëshkoheshin.

Kështu, nga njëra anë marshoi ushtria e Anadollit, nga tjetra kalorësia e Rumelisë, të cilat u lëshuan në mësymje.

Kur panë se s'kishte më asnjë mundësi as për armëpushim e as për të rezistuar, të pafetë, duke përfituar nga nata, u sulën kundër ushtrisë së Anadollit. Me ta u morën *gazinjtë* të cilët vranë aq shumë sa qe e pamundur të numëroheshin. Djelmoshat, vajzat dhe gratë e tyre u zunë robër. Kalorësia – strehë e fitores – shtiu në dorë edhe plot lugina e skuta të tjera si kjo, aq sa po të zë t'i rrëfej me hollësi, kjo përmbledhje do të dilte mjaft e zgjatur. Në këtë mënyrë, Sulltani e pushtoi të gjithë vendin e Shqipërisë.

Në përputhje me traditën që ekzistonte që më parë – *"në traditën e Zotit nuk do të gjesh kurrë ndryshim (Kurani 33:62)"* – të gjithë djemtë e vashat e tyre u kapën dhe u bënë robër, ndërsa meshkujt e rritur u mblodhën dhe i lidhën me zinxhirë. Në çdo vendqëndrim, në prani të Sundimtarit, u ekzekutuan me një të rënë shpate aq shumë të pafe sa qe e pamundur të llogariteshin. Të shtyrë nga kjo frikë, të pafetë që kishin mbijetuar pranuan të bëheshin shtetas të shtruar osmanë dhe të paguanin *xhizjen* e përcaktuar nga *Sheriati,* si dhe taksat e zakonshme. Pasi Sundimtari i Gjithësisë dha shah mat në lojën e shahut të pabesisë së armikut, ai kaloi lumin Mat1, me qëllim që të niste rrugën e kthimit. Mahmut Pashain e dërgoi që të bënte pretime kundër fortesës së Shkodrës 2, që ishte e lidhur me frëngjtë.

Ai mbërriti, mësyu fortesën, e mori qytetin, e plaçkiti dhe i vuri zjarrin. Pas kësaj, *gazinjtë* kaluan me not lumin Buna, ku s` kalohej dot me vah, dhe u hodhën në një pretim. Kur u kthye i ngarkuar me plaçkë të pasur, Mahmut Pashai u nderua duke e lejuar të puthte Fronin.

Rebeli Skënderbe, duke ia mbathur porsi bretkosë prej goditjes gjëmëmadhe të ushtrisë osmane, shkoi në bregdet. Edhe atij kordha e zellit të Sundimtarit i dha lejen që të shkonte në *Mbretërinë e të Vdekurve*. Atë kohë kur ky ndëshkim pllakosi mbi shqiptarët dhe Shejtani i tyre shkoi drejt e në ferr, njerëzit që jetonin në malet e ashpra që rrethojnë fortesën e Elbasanit, u dhanë lamtumirën atyre vendeve dhe zbritën në rrafshinën e fortesës. Ajo tokë u mbulua me fshatra e toka të mbjella dhe u bë truall i populluar e i sigurt osman. Pasi u mor në zotërim i gjithë vendi i Shqipërisë, ai iu besua një *sanxhakbeu*, ndërsa vetë Sulltani u kthye lumturisht në kryeqytetin Stamboll.

1. *Māt:* lumë bregdetar i Shqipërisë që rrjedh mes Drinit, në veri, dhe Ishmit, në jug, pa kaluar nëpër asnjë qytet të rëndësishëm.

2. *İskenderiyye:* sot Shkodra. Qyteti shfaqet më shpesh në burimet osmane me emrin *"İşkôdra"*.

(* Titulli origjinal në botim: Fushata e dytë e Madhërisë së tij Sundimtarit të Gjithësishëm në vendin e Shqipërisë. Përktheu: Edvin Cami. Marrë nga libri "Kronikat e Tursun Beut, Botime IDK, Tiranë 2011. www.idk-al.org / e-mail: idk@idk-al.org)

ese

Bisedë me Skënderbeun...

Nga **Ruzhdi BITRI**

Sa çudi me ne shqiptarët, i kërkojmë thellësitë e shekujve sa herë kemi hall. E shkundim gjithë pluhurin e arkivave dhe të mendjeve tona, gati perverse, për të sjellë në vëmendje, ose më saktë, për t'u larguar nga e përditshmja çoroditëse. Kështu shahemi e pështyhemi, kaçemi e puthemi, gucemi e përkëdhelmi, duke u bërë sa qesharakë, aq edhe imponues në sytë e botës, gjyqtares sonë...

Pak kohë më parë, një miku im në rrjetet sociale bënte "thirrje" që Skënderbeu të shkohej në ...litar e unë vendosa që ta shtyja më tej këtë ide, me mendimin se do të jemi në të njëjtën linjë.

I madhi Skënderbe! Më shumë se kurdoherë, në këtë vit do t'ju drejtohemi për të na ardhur në ndihmë, ne, pasardhësve të tu. Dhe ne e dimë që Ti, përsëri nuk do të kursesh asgjë, megjithatë, unë të kërkoj që të marrësh shpatën, kalin, parzmoren, merr edhe Albulenën, Torviollin, Vajkalin edhe të gjitha kështjellat ...mos harro të na sjellësh të gjithë sulltanët e pashallarët osmanë që ti i munde, merri e na i trego dhe njëherë...

Na i trego me gojën tënde, se, po nuk fole ti, ne do t'ua numërojmë të gjitha, të bëra e të pabëra, të shkruara e të pashkruara. Sa për ato të pashkruarat, o i madhi Skënderbe, do t'i shkruajmë vetë, ashtu siç dimë e bëjmë përherë ne shqiptarët, pasardhësit tuaj, të shekullit XX-XXI.

I madhi Skënderbe, kur ti ishe 500 vjeçar, ne të patëm kërkuar të na ndihmoje, por, me sa duket, atëherë nuk qe e mundur të mësonim më shumë se plot dyer ishin të mbyllura. Dhe ti, Skënderbe, asokohe nuk fole, qëndrove ashtu në heshtje. Ndërsa këtë radhë, ndryshon puna. Shumë veshë e sy sot janë çelë dhe Ti, s'ke nga t'ia mbash, tani Ti do të flasësh... Ne do të tundim të gjitha kalatë tuaja, do të nxjerrim letrat nga arkat e vjetra e, nëse nuk na sheh ti, do ta varim edhe Hamzain. Le që çfarë do të shohësh ti sot?! Ti nuk di se ne kemi një tribunë të mendimit shkencor që është facebuku, kemi hoxhallarë e shehlerë, kemi fshatarë me e pa tokë, por kemi edhe deputetë e Kuvend, por jo si ai i yti. Ne nuk bëjmë "besëlidhje" si ato të tuat për të mbrojtur trojet tona, ne i bëjmë për t'i shitë ato...

Dua të të them edhe diçka tjetër Skënderbe! Ti na ke ngatërruar edhe me ato emrat tu, edhe me fetë e tua. Si, more Skënder, e kishe ndërruar emrin tri herë, edhe fenë ?!!! Ah, ç'na ke bërë, more burrë?! Na mësove keq edhe ne, sepse atë po bëjmë të gjithë shqiptarët. Shumë prej nesh janë bërë grekë, italianë, anglezë e amerikanë, por edhe turq, ndërsa shqiptarë kanë mbetë pak, shumë pak.

O i madhi Skënderbe! Për "Vitin Tënd" ne e kemi marrë seriozisht, po bëjmë përpjekje të lavdërueshme... Kemi filluar të kërkojmë në Anadoll, i kemi rënë kryq e tërthor gjithë Mesdheut, duke të të kërkuar Ty. Kaluam në disa ishuj grekë dhe, për çudi, atje mësuam se ti ishe grek (!). Pastaj kaluam nga Hungaria dhe atje na thanë se ti paskëshe qenë vëllai i Janushit (!). Epo thamë se kaq ishte, por jo. Kur kaluam nëpër Shkup, na thanë se në sheshin e atij qyteti nuk ka vend për ty.

Një farë Aleksandri kish pushtuar gjithë Çarshinë e rrudhosur të shqiptarëve. Nga aty u kthyem për në Kosovë, aty ku gjyshi yt luftoi më 1339. Këtu gjërat ishin më ndryshe. Përveç serbëve kishte edhe plot shqipfolës, medemek shqiptarë, të cilët i mërziste emri yt, luftërat e tua.

Kthehemi në Shqipëri me ndjenja të trazuara, por një luftë e brendshme valon mes krahinave tona. Sjelljet e këtyre "luftëtarëve" të kujtojnë atë plakën që kishte tre djem të sertë, të cilët, përveç se sulmoheshin nga fshati, ziheshin edhe me njëri-tjetrin dhe nëna u tha: "O bijtë e mi, gjithë dynjaja qëllon mbi ju e ju qëlloni njëri tjetrin!".

Përpjekjet e disa "historianëve" shqiptarë për relativizuar origjinën tënde, Skënderbe, s'bëjnë gjë tjetër veçse ndihmojë ujqërit ballkanikë. Këta "historianë" të quajnë beratas, ca të tjerë thonë je matjan, mirditor e hasjan të bëjnë të tjerë...

O Zot, ruaje Shqipërinë nga shqiptarët, ka thënë dikush... E njëjta situatë ndodhi edhe me Ismail bej Vlorën më 2012. "E solli Porta e Lartë", - thanë disa mjekërcjepë. "Mbetët të fundit" - thuhet t'i kenë thënë ata të Portës së Lartë. Bëjeni edhe ju "Mëvetësinë" se nuk mbeti asnjë komb i Ballkanit pa e fituar atë (!). Për ty, i madhi Skënderbe, akuzat janë më të "rënda". Thonë se t'i ke vrarë shumë njerëz, ke vrarë "vëllezër" osmanë, që asokohe rastësisht ishin me shpata e ushta në duar... Eheee, thonë e ç'nuk thonë për ty, por

I madhi Skënderbe, kur ti ishe 500 vjeçar, ne të patëm kërkuar të na ndihmoje, por, me sa duket, atëherë nuk qe e mundur të mësonim më shumë se plot dyer ishin të mbyllura. Dhe ti, Skënderbe, asokohe nuk fole, qëndrove ashtu në heshtje. Ndërsa këtë radhë, ndryshon puna...

ajo që na çudit është fakti se shumë politikanë kanë identifikuar veten me ty.

Kështu bëri Ahmet Zogu. "Vij nga Mati, aty ku ka le Skënderbeu..." Erdhën edhe disa italianë që kërkonin ca prona. Me gjermanët na doli problem, ata thonë se je e njëjta racë me ata... Por më shumë na u shpif ai që thoshte se ishte më i madh se ti, më i zoti... Për 45 vjet ti na u duke shumë i vogël, sa të kujtonim vetëm kur shihnim kalin tënd. Bile, Skënderbe, ka edhe prej atyre që thoshin e thonë se: "...unë e kam mik Skënderbeun, se kam marrë gruan nga Dibra dhe se gruaja e tij është mbesa e afërt me ju. Dhe a e di Ti, se për shkakun tënd, kjo zonë është "respektuar" duke e lënë në gjendje të mjerueshme.

Vendlindja jote, Dibra, është zona më e diskriminuar në Shqipëri, dhe kjo për fajin tënd, Skënderbe!

Para do kohësh, edhe një "Skënderbe" na u prezantua, i cili paska lidhje edhe me Berishët e Muhurrit, ky u vetëquajt Gjergjsali Bej, i cili i vëllazëroi Korabin me Jezercën. Tani kohët e fundit të tjerë burra i "vijnë" vërdallë emrit tuaj. Njëri është me post të lartë.

E sa do të shohim e dëgjojmë këtë vit, se është Viti YT. Në Dibër, janë dyndë historianë, arkeologë, politikanë e deri te veterinerë, agronomë e mësues, të cilët po s'po lënë gur pa lëvizë e vend pa shkelë, a thua këta janë të parët. Erdhi Marini si veriu e tha se: "Pali historisë i priu". Erdhi Pëllumbi dhe historinë e zuri nga fundi; qe dhe një Skënder (por jo pasha), që tha se ishte i pari në atë kala (!).

Të parët!!! Ne dimë se vite më parë aty kanë shkelë edhe Kristo akademiku, profesor Shuteriqi, profesor Ademi e Iljazi. Më pas një Haki e një Ali, një Zenel e një Murat, por Marini i vu kapak.

Të gjithë po flasin për ty, të gjithë të duan, të kërkojnë... Këtë vit na duhesh, o i madhi Skënderbe. Edhe ai i gjati erdhi dhe t'i numëroi 18 betejat e Dibrës. Këtë vit po ju thërret dhe në emrin tënd do të organizohen festime, do të shpenzohen edhe ndonjë dorë para...

Ndoshta edhe Presidenti i Republikës do të mësojë se busti që mban në zyrë të përket TY, që ende nuk e di që vendlindja jote është në Sinë! Vendlindja jote...!

U shqepën dibranët duke hamendësuar e treguar se dinë vendin ku ti lidhje kalin, ku farkëtoje shpatën, ku bëheshin vorbat e venës, kush të piqte kafen, etj., etj. I bënë me gojë përrenjtë e mullinjtë, kodra e rrëpira e çdo gjë e lidhin me emrin tënd.

Aktualisht, në Dibër të Poshtme po zhvillohet një luftë e ashpër në mes Sinës, Çidhnës, Çeliasit, Kastriotit, Kuke e deri në Muhurr te Mazrekët e Gardhi i Poshtëm dhe e gjitha kjo për fajin tënd, o Skënderbe, se nuk na i shkruajte me dorën tënde këto gjëra...(edhe pse i shkrove me shpatë). Ti, duhet të dish se të gjithë shqiptarët e më së shumti dibranët, duan secili të të ketë në bahçen e vet, duan "pronësinë" mbi TY.

Dhe këto ndodhin se ne kemi Ligjin 7501, kemi Agjenci Pronash, hipotekë, komisione për pronat; kemi celularë e kompjuter e ç'nuk kemi. Ajo gjëja më e madhe që kemi janë disa ekrane që mbushin hapësirën mediatike një natë me "histori kodoshësh" e natën tjetër me "kodosh të historisë", të cilët kanë të përbashkët urrejtjen ndaj teje. Sidoqoftë, i dashur Skënderbe, ti do të na duash këtë vit dhe mos u zemëro me ne, se na duhesh shumë. Na duhesh ti, por edhe Hamzai juaj, i cili ngjan me Saimirin.

I dashur Skënderbe! Kur ti të bëhesh 600 vjeç, gjysma jonë nuk do të jemi më e këta që të përmendin, nuk do të jenë në jetë.

Urojmë që ata që do të jenë, të të shohin jo si ne për interesat tona, por si vlerë e madhe e historisë së popullit tonë. Faleminderit!

Dhjetor 2017

Një femër mund t'ia dalë

Nga **Samet ZAGRADI**



T'ia dalësh mbanë në një mentalitet të ndrydhur nuk është aspak e lehtë! E vështirë për të mos thënë e pamundur, është të bëhesh e suksesshme në një ambjent ku mund të gjykohesh apo përgojohesh pothuajse për çdo gjë. Të jesh femër e të mbijetosh në dallgët gjigante të paragjykimit që na shoqëron çdo frymë që marrim, do të thotë sukses. Të kapërcesh çdo barrierë të ngritur prej qindra vitesh, do të të thotë arritje. Të pakta janë ato femra të vërteta që ia dalin të mposhtin çdo paragjykim, të çajnë furrishëm drejt suksesit duke punuar fort e duke qenë një shembull për pjesën tjetër më pak të guximshme. E tillë është Sadetja.

Ajo ia ka dalë mbanë të depërtojë në mentalitetin e një qyteti të vogël e të mbyllur. Ka punuar fort dhe ka hedhur hapa të cilët kontribuojnë shumë dhe në komunitetin ku ajo jeton, duke u bërë një shembull për t'u ndjekur nga qindra femra të cilat mbeten rëndomtë nën kthetrat e mprehta të disa dogmave të vjetëruara që fatkëqësisht akoma egzistojnë. Ajo është bërë agjent ndryshimi në zonë. Lindi në një fshat të vogël të Dibrës, ku u rrit përpara qindra syve kurioz të cilët nuk mundën t'i kufizojnë dëshirat e saj. Nisi studimet në gjimnazin e Peshkopisë, për të vazhduar universitetin, masterin, specializime e më pas drejton një institucion mjaft të rëndësishëm po në këtë zonë. Është nënë e dy fëmijëve, drejtuese e një grupi të rinjsh vullnetarë që realizojnë punë të mrekullueshme në qytet, zonjë shtëpie dhe akoma ia del për mrekulli në detyrat që vetëm një femër e fortë di t'ia dalë. Ajo nuk tundohet nga askush, por çdo ditë ndjek ëndrrat e saj duke punuar fort.

Dita e saj nis që herët në mëngjes, madje-madje shumë herët, pa dalë akoma dielli. Amina 7 vjeçare, fëmija i saj i parë, duhet të jetë gati për t'u çuar në shkollë, e ndërsa Amar, që sapo ka mbushur një vjeç do një vëmendje shumë më të madhe. Ora 8 e mëngjesit, të buzëqeshur, atë e shohim teksa përshëndetet me kolegët, nxënësit e teksa drejtohet në zyrën e saj në konviktin e Shkollës pedagogjike "Nazmi Rrushiti", ku mban dhe postin e drejtoreshës së këtij konvikti. Një post sa i bukur, por dhe i vështirë, duke qenë që marrëdhënien e ka të drejtëpërdrejtë më një moshë mjaft delikate dhe me punojës pothuajse dy herë mosha e saj. Me magjinë e fjalës Sadetja arrin të balancojë marrëdhëniet me nxënësit e kolegët në mënyrë që procesi i punës të mos hasë pengesa, të cilat nuk do të ishin të pëlqyeshme nga asnjëra palë. E ulur pranë kompjuterit të saj, e zhytur thellë duke menduar sërish Amarin, Aminën, shtëpinë, kolegët, të rijntë, konviktorët, shërbimet që u bëhen atyre, ushqimin, prindërit dhe një milion gjëra të cilat qëndrojnë të stamposura në kokën e saj. E çuditshme që ia del të bëj çdo gjë, i habitshëm fakti se çfarë energjie ka. Prej tri vitesh ajo vazhdon të trajnojë të rinjtë e grupit *Ipact* vullnetarisht për t'i mësuar ata të marrin nisma të rëndësishme në komunitet. E vëmendshme në çdo temë që ajo trajton duke I bërë këto të rinj të dobishëm për vendin, komunitetin dhe qytetarët, të cilët më të vërtetë ka nevojë për ndryshim. Vizitat në konvikt në çdo lloj orari nuk janë të rralla për të. Kontrolle rutinë, emergjenca, probleme të ndryshme e detyrojnë atë që as në darkë të mos kalojë e qetë atë pak kohë me familjen e saj. Darka duhet me patjetër ta gjejë në shtëpi, duke kryrer detyrat e një nëne, bashkëshorteje, bije, motre apo detyrave që i ngarkohen një femre si Sadetja. Padyshim që ajo ja del. Si ajo ka shumë, por nuk ka mjaftueshëm. Gojët e liga vrasin qindra ëndrra, dhjetra qëllime dhe pasione të mbytura nën stofkullën e këtij mentaliteti të ngurtë. Vrasin çdo tentativë për t'u bërë një Sadete, e cila bën çdo gjë dhe ia del të edukojë një familje të shëndoshë, një shoqëri dhe një komunitet të cilin ka nevojë për të.

Unë jam i bindur që çdo femër ia del. Çdo vajzë ka aftësinë të ndryshojë vetë vetveten, më pas të bëhet shembull për të tjerat. Ndryshimi nuk vjen vetë, atë duhet ta kërkosh. Duhet të vuash, të punosh fort, të krijosh një plan e më pas ta ndjekësh derisa ta bësh atë realitet. Përpiqu, mbyll fort veshët, mos dëgjo asgjë dhe më pas vazhdo drejt, sepse ndryshe nuk do të mund t'ia dalësh. Bëhu ti një Sadete, bëhu një vajzë e fortë dhe përpiqu të ndryshosh mënyrën e të menduarit. Jeta jote varet nga mënyra se si ti mendon.

Dita e Sadetes nis sërish e njëtë. Ajo lodhet, por është e lumtur. Ajo jeton si ne! Unë, ti, në të njëtin komunitet, por fokusohet te qëllimet e saj. Ajo përplaset me shumë padrejtësi, por me këmbëngulje prej femre ia del. Ajo sakrifikon çdo gjë dhe shijon frytet e punës së vazhdueshme. Ajo po kontribon që shoqëria jonë të mos paragjykojë. Ajo u shkollua, ka një punë të mirë dhe gëzon një familje të shëndetshme. Pse? Sepse guxoi! Punoi! Mësoi! Nuk qëndroi stoike e paragjykimeve, e fjalëve, të cilat po lënë pas shumë ëndërra dhe pasione. Ky është një shembull që padyshim të gjithë vajzat dhe jo vetëm duhet ta ndjekin si agjente e suksesshme ndryshimi.

Ka pak vite që Sakip Ngota e ka shtuar gamën e prodhimeve, duke futur kosin dhe dhallën, që mbajnë logon e tij. Sidomos në verë janë produkte shumë të preferuara dhe të dëshiruara nga njerëzit.

profil

Sakip Ngota, *baxhieri i ndershëm dhe i punës*

Nga **Osman XHILI**



Ishte viti i hershëm 1971, kur djaloshi nga Çetushi Sakip Ngota, lirohet nga ushtria. Që të thoshte të vërtetën, djaloshi i i ri nuk e kishte me qejf të punonte në kooperativë. Jo se nuk mundej, por vlera e pakët e dites se punës ishte shkaku që donte të shkojë diku tjetër. Familja e tij kishte nevojë për të më shumë se kurrë dhe donte të kishte një punë , apo një zanat me fitim më të madh. Mori vesh se do hapej një kurs gjashtë mujor për baxhier dhe ai vrapoi të ishte një prej kursantëve të rinj. Me kohë, do t'ja merrte dorën, se në fund të fundit, askush nuk kishte lindur i ditur. Trajnimet bëheshin nga Mehmet Përnezha dhe Fadil Dufi,dy specialistë me eksperiencë të kohës. Dy vjet më vonë, bëri sërish një trajnim tjetër në Tiranë dhe tashmë e ndjente veten më të aftë e më të kompletuar. Ishin gjashtë djem të rinj nga Dibra, të cilët më vonë do të bëheshin baxhjerë të talentuar e nuk do linin zonë e fshat të rrethit pa shkelur, nga Golloborda e deri në Lurë. Vetëm në malet mbi fshatin Sinë, afër liqeneve të Lurës, në vendin e quajtur Pllajë, punoi 12 vjet. Përpunonte një sasi prej 25 kunjtalë qumësht, duke e kthyer në djathë të llojeve të ndryshme me një cilësi vërtetë shumë të lartë. Dukej sikur aromat e luleve të bjeshkës ishin të stampuara në të. Më vonë punoi dhe si përgjegjës i fabrikës së qumështit, derisa e mbylli këtë kapitull, në vitin 1993. Një mik i tij e kërkoi në Këmishtaj të Lushnjes, ku mësoi dy kursantë të rinj. Kryetari i asaj komune e lut më pas të qëndrojë atje, duke i gjetur truall e duke i krijuar kushte të favorshme për ushtrimin e aktivitetit, por Sakipi nuk qe dakort dhe kthehet në Dibër, për të parë ndonjë mundësi të re.

PLOTESIM I ENDRRES

Sakip Ngota ishte mësuar me punë e jo të rinte duarkryq, se mos i vinte ndonjë mrekulli nga qielli. Aty në një nga rrugët e qytetit të Peshkopisë, bleu një copë truall dhe hapi një dyqan për fruta e perime. Jo se sillte të ardhura të mëdha, por diçka fitonte, nga e cila dhe konsumonte për nevojat e familjes dhe akumulonte. Por prapë, nuk e dinte përse, mendja e tij rrihte diku tjetër. Kujtime të hershme i vinin në mendje, baxho e fshatra të ndryshëm, kolegë e blektorë me të cilët pati diskutuar, kishte punuar e ngrënë së bashku. Ndoshta do të vinte një ditë, që ai të kishte baxhon e tij. Kjo ditë vonoi pak, por erdhi. Ishte viti 2010. Sakipi nuk e harron dhe nuk ka se si ta harrojë atë ditë, bile e ka të stampuar në logon e prodhimeve të tij. Maksim Hajrullai, në atë kohë drejtor i bujqësisë së qarkut Dibër, i bën një ofertë. I afron një kredi prej 80 miljon lekësh nga A. Z.H.B.R-ja, ose sic quhet, Agjensia e pagesave, me afat shlyrës gjashtë vjeçar, pa asnjë interes. E si nuk e pranoi Sakipi! Ai kishte kohë që e ëndërronte. Nuk i mbetej tjetër, vetëm të falenderonte Zotin për këtë mundësi, pa harruar dhe sebepin, drejtor Hajrullain. Shumë shpejt, dyqani i frutave dhe perimeve, u kthye në një baxho. U blenë dhe makineritë, u ndërtua kaldaja poshtë dhe Sakipi filloi të mbledhë qumështin nga fermerët. Lokali i punës nuk ishte krejt i përshtatshëm, por me pak sforco, ai do t'ja dilte.

Filluan prodhimet e para. Djath i zakonshëm lope, delje dhie, djath kaçkavall, djath Korabi,djath fet që pritet në formë trekëndëshi dhe plot djathra të tjerë. Ka dhe gjizë të ëmbël dhe të mrekullueshme, që shpesh të detyron ta harrosh dhe shijen e djathit. Deri në 45 kunjtalë qumësht arriti të përpunojë Sakipi në baxhon e tij. Do të ishte padituri dhe miopi profesionale po të llogarisje vetëm fitimin e Sakipit, apo punësimin e familjes së tij, në bilancin e gjërave pozitive. Sa e sa fermerë që ishin bërë gati të shisnin bagëtitë e tyre, panë një dritë në fund të tunelit, gjetën një strehë te baxhoja e tij. Ata e falenderuan pafundësisht për këtë sipërmarrje, që bartëte në vetvete kushedi sa rreziqe. Prishja e qumështit, mungesa e tregut, konkurenca e pandershme e plot faktorë të tjerë, silleshin si korba në qiell të hapur për ti shkatërruar biznesin e për ti shpallur falimentimin. Shpesh Sakipi revoltohet me konkurencën e pandershme, duke shtruar pyetjen, që shpesh mbetet pa përgjigje. E si mundet të dalë djathi në treg me 2500 apo 3000 lekë kilogrami, kur duhet të jetë sëpaku dyfish? Në fakt, përgjigja është krejt e qartë. Gjizë, niseshte, apo të tjera gjëra dhe lëndë të huaja, që vetëm djathë nuk mund të quhen. – Djathi im është bio, thotë me krenari Sakipi. – Asnjë cc lëndë të huaj nuk ka në të.

Qëndrova pak kohë te dyqani i tij, ndërsa po bëja një intervistë të vogël. Klientë të shumtë vinin në dyqan dhe ai shpesh detyrohej të shkëputej. E kishim bërë marrëveshjen, nuk kishte problem për mua, vetëm tu shërbente njerëzve. Banaku është plot me djathra të ndryshëm, bile ka dhe copa të vogla, të prera, që klientët ta provojnë dhe ta testojnë djathin që blejnë. Kjo ndoshta do tu shërbente vetëm klientëve të rinj, pasi ato të "vjetrit" dhe që janë larg, bëjnë porosi me telefon. Megjithë trupin pak të shëndoshë, Sakipi bën lëvizje të shkathta, duke u shërbyer njerëzve, duke i respektuar dhe në fund, kur peshorja tregon peshën fikse, ai hedh dhe një copë tjetër djathi, për të marrë hallallikun. Një grua, të cilës i shërbeu, nuk mundi të mos e shprehë konsideratën e saj. – Ua bëftë Zoti hallall! Shumë të mirë e bëni djathin. Nuk di pse ndjeva një kënaqësi, kur zonja bëri konstatimin. Thashë me vete se Sakip Ngota meriton shumë gjëra, të cilat nuk po ja japim. Të paktën një shkrim le ti bëjmë, si një fjalë e mirë për njerëzit e ndershëm të punës.

Ka pak vite që Sakipi e ka shtuar gamën e prodhimeve, duke futur kosin dhe dhallën, që mbajnë logon e tij. Sidomos në verë janë produkte shumë të preferuara dhe të dëshiruara nga njerëzit.

LEJA E NDËRTIMIT

E thamë që më parë, se lokali ku punon Sakipi, nuk është i mjaftueshëm për të punuar lirshëm. Duhen më shumë hapësirë për të futur produktet, për të stazhionuar djathin, për të mbajtur materialet, apo hapësira për të lëvizur dhe parkuar makinat që sjellin qumështin dhe marrin prodhimin e përpunuar. Sakipi ka blerë dy dynymë tokë në hyrje të fshatit Melan, për të ngritur një baxho të re. Më pas shtoi dhe dy dynymë të tjerë. Lejen e ndërtimit nuk ja jepnin që nuk ja jepnin për vite të tërë. Po përse xhanëm, kur nuk e ndihmojmë tjetrin, të paktën të mos e pengojmë. Zili për njerëzit e punës, injorancë, prezantim force, apo çfarë dreqin duhet ta quajmë këtë veprim? Po të ishte në ndonjë shtet tjetër, kushedi sa lehtësi do ti afroheshin këtij njeriu që do të punësonte mbi dyqind fermerë, duke marrë qumështin e tyre. Kushedi çdo të bënte nje shtet, sadopak i përgjegjshëm dhe me dy para mend në kokë, për të vënë në punë këtë njeri tashmë të moshuar, të na afronte shërbimet e tij cilësore! Po të ishte jashtë ama, se tek ne vetëm pengesa e burokraci të afron shteti, a thua se ka për detyrë të bëjë të kundërtën e asaj që duhet. Nuk di si rrodhën ngjarjet, por më së fundi e morri dhe lejen e ndërtimit. Projekti është gati dhe inshalla, në muajin mars të vitit që vjen, fillojnë punimet për ndërtimin e baxhos së re. Ajo do të jetë me një kapacitet prej 100 kunjtalësh në ditë, duke u hequr blegtorëve të zonës një barrë të rëndë nga shpina.

Sakip Ngota tani u afrohet të shtatëdhjetave dhe ka përgatitur me kohë zëvendësin, djalin e tij, Shemsiun. Por sërish ai nuk dorëzohet, duke punuar në të gjitha frontet, si një ushtar i paepur, duke kontribuar për familjen dhe shoqërinë.

Sakip Ngota tani u afrohet të shtatëdhjetave dhe ka përgatitur me kohë zëvendësin, djalin e tij, Shemsiun. Por sërish ai nuk dorëzohet, duke punuar në të gjitha frontet, si një ushtar i paepur, duke kontribuar për familjen dhe shoqërinë.

Aty në një nga rrugët e qytetit të Peshkopisë, bleu një copë truall dhe hapi një dyqan për fruta e perime. Jo se sillte të ardhura të mëdha, por diçka fitonte, nga e cila dhe konsumonte për nevojat e familjes dhe akumulonte. Por prapë, nuk e dinte përse, mendja e tij rrihte diku tjetër. Kujtime të hershme i vinin në mendje, baxho e fshatra të ndryshëm, kolegë e blektorë me të cilët pati diskutuar...



profil

Heroina e heshtur



Ndoshta do të kishte dashur të studjojë në ndonjë degë tjetër të universitetit dhe jo atë të agronomisë, por në ato vite të para nëntëdhjetës, shumë pak mund të zgjidhje dhe gjërat ishin paracaktuar. Majlinda, vajza nga Sohodolli i Peshkopisë, atëherë me mbiemër Merdini, në vend të matematikës, që kishte për zemër, shkoi gjunjëkëputur për agronomi në Korçë. Por dhe pse nuk ishte zgjedhja dhe dëshira e saj, ajo ishte mësuar të ishte në ballë të gjërave, tek më të mirat në çdo drejtim. I mblodhi në front të gjithë aleatët e saj, guximin, këmbënguljen, vullnetin, inteligjencën, krenarinë dhe i fitoi të gjitha betejat, duke pasur në fund të pesë viteve të universitetit një mesatare mbi 9,7.

Do të duheshin shumë vite në kërkim të një pune të përshtatshme për të. Shumë organizata të huaja vepronin e punonin në territorin shqiptar dhe njëra prej tyre ishte "Agritra Vision". Duhej një menaxhere e aftë, të ishte komunikuese e mirë me të tjerët dhe të dinte të punonte në grup. Majlinda mendonte se i kishte këto cilësi dhe mund t'ja dilte mbanë. Ishte e re, e shkolluar dhe edukuar. Askush nuk kishte lindur me përvojë, koha do ta sillte dhe atë. Organizata kishte si qëllim rritjen e rolit të gruas në shoqëri dhe në komunitet, por që të realizohej kjo, duhej të rritej dhe roli i saj në ekonominë familjare. Duhej ndryshim koncepti, jo thjeshtë lindje dhe rritje fëmijësh, por më shumë akoma. Ishte pak e vështirë ti bëje gratë ta kuptonin thelbin e problemit dhe aq më pak ta besonin. Si mund të punonin ata, kur dhe për burra ishte vështirë të gjeje punë dhe vetëm emigracioni ishte një portë e hapur për njerëzit? Filluan bisedat e para, trajnimet e para, u ngritën grupet e para të grave nëpër fshatra. Dashurie Zerja në Melan, Lirije Rexha në Pocest, Flutura Begu në Vakuf, ishin të parat që përqafuan idenë. Jufkat, ëmbëlsirat, përpunimi i djathit, kompostot, reçelnat, të gjitha këto produkte të shijshme e cilësore, u bënë tashmë një realitet i prekshëm. Esmaja, Redifja, Sabria dhe Naimja ishin disa më aktivet nga grupi i fshatit Begjunec. Ato mblidhnin, përpunonin dhe tregëtonin, arra, lajthi, fruta pylli e plot produkte të tjera, duke shtuar të ardhurat në ekonominë e tyre familjare. Po kaq me përkushtim punoi dhe grupi i grave të Staravecit, ku bënin pjesë Shpresa, Emrija, Nafija, Flora dhe gra të tjera, që bashkuan forcat, idetë, mendimet, ku nuk harruan të vlerësojnë krahas të tjerave dhe erëzat. Gratë e Muhurrit kishin prioritet përpunimin e djathit të dhisë dhe punët e dorës, kurse në Deshat ndërtuan një serë jo të vogël për rritjen e perimeve. Punët ishin organizuar në mënyrë të tillë, që të kishte më shumë bashkëveprim e bashkëpunim, se sa konkurencë e xhelozi. Rezultatet nuk vonuan të vijnë, ashtu si frutat në një stinë të mbarë e të bereqetshme. I pamë produktet e tyre të shfaqen e të tregëtohen në dyqane, i pamë në panairet e qytetit në " Festën e të vjelave", i pamë në pedonale dhe në sheshe të Tiranës. Gjithnjë e më të arrira performanca e tyre, gjithnjë e më shumë sasi, gjithnjë e më shumë cilësi e vlerë. Grupe grashë dibrane i dërguan jufkat deri në panairin e Torinos në Itali, si një produkt tipik dibran e shqiptar, duke merituar respektin e organizatorëve dhe publikut të gjerë.

Të gjitha këto aktivitete patën një ndikim të madh në disa drejtime. U shtua ndjeshëm besimi se ato munden të bëjnë gjëra të bukura, që dhe vetë nuk do ti kishin besuar më parë. Rritën personalitetin e tyre në familje, në komunitet dhe në institucione. Filloi njohja, komunikimi dhe lidhja e

Qindra gra në Shqipëri, në heshtje, japin kontributin e tyre, për ndërtimin e një shoqërie me mundësi të barabarta, të lirë nga dhuna dhe diskriminimi, me akses të barabartë në shërbime dhe në vendimmarrje. Gjashtë gra u vlerësuan me mirënjohje të veçantë dhe u dekoruan pikërisht për kontributin e tyre në këtë drejtim. Njëra prej tyre ishte Majlinda Hoxha, dibranja e palodhur, menaxherja e talentuar me një vizion të qartë e plot plane të bukura për të ardhmen.

kontratave të para me blerës dhe subjekte të interesuara për punën dhe produktet e tyre. Të gjitha këto arritje të tyre, tregon Majlinda, na bënin ne stafin, të ndjeheshim krenare me ato arritje. Bashkë me koleget, zonja të nderuara si Bukurie Begu, Servete Kera dhe Fllanxa Shehu, mendonim si ti motivonim akoma më shumë grupet prodhuese të grave, si ti shtynim akoma më tej këto arritje të tyre.

STACIONI I RI

Kaq shumë isha dashuruar me punën me gratë, sa do të kisha dashur të mos shkëputej ky rrugëtim për tërë jetën. Një propozim i ri kishte ardhur në tavolinën time, kujton menaxherja e talentuar, për të punuar me një tjetër organizatë, atë të " World Vision". Nuk i thashë jo. Kisha kaluar plot 17 vite tek puna e parë dhe kisha mësuar kaq shumë praktika dhe eksperienca të reja, që me fare pak përshtatje, mund ti adaptoja në pozicionin e ri, ku pritej të kaloja. Nga puna me gratë, duhej të ndryshoja paksa kursin, tek puna me fëmijët, me nxënësit. Ishin ato një nga pjesët më të bukura të shoqërisë tonë dhe si të tillë meritonin një përkujdesje të veçantë. Unë tashmë, pothuaj kisha rritur e shkolluar tre fëmijët e mi dhe kjo kishte qenë një eksperiencë jo e vogël për ta pasur në konsideratë. Duheshin bërë bashkë të gjithë aktorët e faktorët e shoqërisë, nëse donim që ata të rriteshin të shëndetshëm si nga fiziku, ashtu dhe psikologjia e të menduarit. Prindër, mësues, institucione shtetërore dhe organizata të ndryshme, duhej të kordinonim punët në mënyrën më të mirë të mundshme për të përmirësuar kushtet, infrastrukturën shkollore e më gjerë akoma. Sot, thotë Majlinda, organizata jonë punon me 40 shkolla të ndryshme, nga të cilat 15 nëntëvjeçare, 21 vartëse dhe katër shkolla të mesme. Monitorohen dhe mbështeten afërsisht 4000 fëmijë, duke pasur në vemendje kërkesat dhe nevojat e tyre. Është e para herë që bashkia ka hartuar një plan social në lidhje me nxënësit e shkollave, duke e shoqëruar këtë me buxhetin përkatës. Po kështu, me drejtorinë arsimore të rrethit kemi hartuar një projekt të përbashkët për ti trajtuar shkollat si qendra komunitare. Nuk kanë qenë jashtë vemendjes dhe nxënësit me aftësi të kufizuara, duke pasur si prioritet gjithpërfshirjen e tyre. Dimrin e acartë të vitit të kaluar shpërndamë rreth 240 pako ushqimore për familjet në nevojë. E dimë që kjo nuk e zhduk varfërinë, por është një shenjë për ta, që nuk janë vetëm në betejën me jetën dhe për jetën. Tashmë janë gati dhe 700 pako me veshje goxha të mira e të bukua, që do shpërndahen në Maqëllarë dhe Kastriot. Të tjera projekte sillen në tryezën e së nesërmes për bimë mjekësore, për mbjellje arrash e lajthishë, për ta bërë më të bukur jetën e bujkut, të blegtorit, të çdo burri, gruaje e fëmije, që Zoti i ka zbritur në tokë.

FAMILJA

Dëgjon këto gjëra, sheh një përkushtim të tillë për punën dhe pandeh se kjo grua nuk ka asnjë obligim tjetër. Në fakt ka dhe një pjesë të padukshme, atë të cilën çdo grua, çdo nënë e bën me një përkushtim të veçantë, aftësi që vetë Zoti u ka dhënë atyre. Atëherë kur muzgu i natës është shtrirë tej e tej, ato gatuajnë, lajnë, pastrojnë dhe përgatiten për ditën e nesërme. Por për Majlindën gjërat do të kishin qenë shumë më të vështira, mos të themi të pamundura, po të mos kishte qenë ndihma e bashkëshortit të saj, inxhinjer Ismetit. Të dy së bashku krijuan familjen, i edukuan dhe shkolluan fëmijët në mënyrën më të mirë të mundshme. Dy vajzat e familjes Hoxha po përmbyllin studimet në Poloni. Imelda për informatikë, kurse Nerivana për menaxhim dhe biznes ndërkombëtar. Djali, më i vogli, akoma është në gjimnaz, por priret nga teknologjia. Janë këto arritje të tyre që i bëjnë prindërit të ndihen krenar dhe të kuptojnë e besojnë se mundi dhe investimi nuk paskan shkuar kot.

30 TETOR 2017

Në Tiranë përkujtohet 72 vjetori i Ditës së Kombeve të Bashkuara, një aktivitet që i kushtohej barazisë gjinore dhe fuqizimit të rolit të gruas në shoqëri. Qindra gra në Shqipëri, në heshtje, japin kontributin e tyre, për ndërtimin e një shoqërie me mundësi të barabarta, të lirë nga dhuna dhe diskriminimi, me akses të barabartë në shërbime dhe në vendimmarrje. Gjashtë gra u vlerësuan me mirënjohje të veçantë dhe u dekoruan pikërisht për kontributin e tyre në këtë drejtim. Njëra prej tyre ishte Majlinda Hoxha, dibranja e palodhur, menaxherja e talentuar me një vizion të qartë e plot plane të bukura për të ardhmen.

Osman XHILI

Bëj pajtimin tënd me PayPal

përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Ne nuk jemi gazetë e pavarur, ne jemi gazetë e lirë dhe pavarësia jonë garantohet vetëm nga mbështetja e lexuesve...

Më shumë mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit
ose ndiq linkun: goo.gl/1bq2r6

Intervistë me këngëtarin dibran Dritan Jashari



Pasues i artistëve dibranë, që promovuan thesarin e këngës së mirëfilltë dibrane

Qysh fëmijë i hyri në zemër tradita e folklori, të cilat filloi t'i vrojtojë në vitet e rinisë. Dritan Jashari, tashmë artisti i mirënjohur i këngës dibrane, është njëri nga pasuesit e artistëve dibranë që e promovuan thesarin e këngës së mirëfilltë dibrane. Menjëherë pas Hazis Ndreut, Qerim Sulës, Sherif Dervishit, ... ai që do e përfaqësojë denjësisht traditën e këngës sonë dibrane, sigurisht se do jetë Dritan Jashari. Pas disa sukseseve me projektet muzikore, ai na vjen në këtë intervistë për të folur më shumë rreth figurës së tij dhe asaj çka ka punuar me bashkëpunëtorët e vyer...

Ku keni lindur dhe kur jeni ngjitur në skenë për herë të parë?

Jam i lindur më 1 tetor 1971 në fshatin Kovashicë të komunës së Maqellarës, me njerëz të mirë e punëtorë. Fillesat e mia nëpër skena janë që në klasë të pestë, d.m.th. 4 vitet e shkolles tetë vjeçare. Kam qenë me orkestrinën e çiftelisë në Shtëpinë e Pionierit "Tahsim Shehu" në qytetin e Peshkopisë, me të cilët kam marrë pjesë nëpër shumë festivale e koncerte.

Cilët artistë i kishit model për ta ndërtuar karrierën tuaj tashmë të suksesshme?

Si dibran që jam, gjithmonë më kanë pëlqyer këngëtarët tanë, si: Hazis Ndreu, Arif Vladi, Qerim Sula, Vëllezërit Sturçe, Skënder Cala, Haxhi e Agron Maqellara, etj., por shumë më kanë pëlqyer edhe këngëtarët nga Kosova: Esat Bicurri, Ismet Peja, Ilir Shaqiri, Shkëlzen Jetishi, Ramadan Krasniqi, e të tjerë, rrugën e të cilëve jam munduar ta ndjek me përkushtim.



Cilat janë këngët e para të repertoarit tuaj?

Këngët e para janë në orkestrinën e çiftelisë, nje repertor modest që u pasurua me ndryshimet dhe kalimin e kohës.

Me poetin Naim Plaku ishim bashkëqytetar. Fati e deshi që ne të bashkëpunonim këto vitet e fundit në Tiranë. Kënaqësi e veçantë dhe nder është për mua që pata fatin të kem në repertorin tim këngë me tekste të Naimit, si: "Krah për krah Dibra e Kosova", "Oda dibrane", "Lum për djemtë që rriti Dibra", "Cen Elezi shkamb i Korabit" etj.

"Fluturo shqipja mbi Korab" lirisht mund të quhet "kurora e karrierës tuaj". Na flisni pak rreth realizimit të saj!...

Vërtetë që kjo këngë është shumë e bukur për mua dhe për çdokënd që e don muzikën. Jam me fat që këndoj fjalët e poetit tonë të madh, dibranit Naim Plaku dhe muzikën me melos dibran të krijuar nga kompozitori i shkëlqyer Edmond Zhulali. Kjo këngë lindi tamam në momentin e duhur, si kujtesë për atë çka ka bërë Dibra dhe dibranët për atdheun, për pavarësinë e për lirinë. Për mua, do ngelet njëri nga bashkëpunimet më të përkryera...

I kujtoni dot lëvdatat e marra për këtë realizim?

"Fluturo shqipja mbi Korab" është një këngë që lëvdatat i ka të tepërta, por vërtetë e kanë pëlqyer shumica e publikut shqiptar dhe kërkohet vazhdimisht nëpër manifestime të ndryshme.

Njiheshit më herët me kompozitorin e shquar dibran, Naim Plakun?

Me poetin Naim Plaku ishim bashkëqytetar. Fati e deshi që ne të bashkëpunonim këto vitet e fundit në Tiranë. Kënaqësi e veçantë dhe nder është për mua që pata fatin të kem në repertorin tim këngë me tekste të Naimit, si: "Krah për krah Dibra e Kosova", "Oda dibrane", "Lum për djemtë që rriti Dibra", "Cen Elezi shkamb i Korabit" etj.

Ç'emocion ju përshkon kur i këndoni këngët e Naim Plakut dhe të Edmond Zhulalit?

Do kisha dashur akoma më tepër bashkëpunime me të madhin Naim Plaku, se vërtetë do ia vlente. Kur i këndoj tekstet e Naimit e kur e përcjell muzikën e Edmond Zhulalit, e ndjej veten të bekuar që bashkëpunova me këta artistë të pavdekshëm.

Mendoni se mund të krijohet edhe një himn tjetër dibran si "Dibra maja-maja"?

Ne gjithmonë jemi në kërkim të diçkaje të bukur. Me punë arrihet çdo gjë, ne vetëm duhet të punojmë për të krijuar, se patjetër që do arrihet edhe një sukses i ngjajshëm.

Ndërkohë, për ç'projekt jeni duke punuar?

Më së fundi, pas këngës "Gjeta Dibër n'Amerikë" dhe pas realizimit të një kënge me motive dasme me titull "Kësaj i thonë dasëm shqiptare" me tekst të Ramazan Çekës dhe muzikë gjithmonë të Edmond Zhulalit, po e shijoj suksesin e tyre. Por, jam edhe në kërkim të temave të reja për ndonjë projekt të radhës.

Dritan, ne ju falenderojmë për kohën që ndatë dhe ju urojmë sa më shumë suksese!

Pata kënaqësinë ta zhvillojmë këtë bashkëbisedim. Gjithashtu ju dëshiroj sa më shumë shëndet dhe suksese...

Intervistoi: **Arsim KOLARI**

KONTRIBUO PER GAZETEN

...është koha per t'u pafuar... merr kopjen tende

email: rrugaearberit@gmail.com

vetëm 600 lekë në vit

BOTIME M&B

www.facebook.com/ M&B - Botime dhe Studio Grafike
Për porosi: botimemb@gmail.com/Cel: 069 20 68 603
www.mbbotime.com / I gjeni te libraria M&B *(te Selvia),*
Adrion *(te Pallati i Kulturës),* Libraria Fleta XXI *(Peshkopi)*



FUNERAL

ARTAN GJYZEL HASANI

Roman

Botimet M&B
ISBN 978-9928-4458-6-5
Kopertina: Zaim Elezi
Faqe: 116
Çmimi: 500 lekë



SHTEK MË SHTEK
E SKUTË MË SKUTË

MUNIR SHEHU
Përgatiti për botim: Mirdash Shehu

Rrëfenja dhe këngë Dibre

Botimet M&B
ISBN 978-9928-4458-2-7
Faqe: 208
Çmimi: 700 lekë



FILOZOFIA
POPULLORE

XHAFER MARTINI

Botimet M&B, 2017
ISBN 978-9928-4458-3-4
Faqe 256
Çmimi: 1000 lekë



KALILA
DHE DIMNA

Përktheu:
SULEJMAN TOMÇINI

Fabula të vjetra
indo-persiane

Botimet M&B
ISBN 978-99943-968-3-2
Faqe: 212
Çmimi: 1000 lekë

Në arkivat britanike që mbajnë datën e 1 janarit të vitit 1914-të, nën një titull sa dhimbës dhe mjaft domethënës për kohën, thuhet se 30 mijë njerëz janë në rrezik për jetën e tyre. Thuhet se të gjithë këta njerëz janë në rrezikun e urisë dhe vdekjes nga mungesa e ushqimeve.

Kur **Aqif Pasha** kujdesej **për Gollobordën**

Dr. Fatmir TERZIU



Fakte të panjohura dalin përditë e më shumë në lidhjet e hershme të Elbasanit me një nga krahinat më në zë të Atdheut, Gollobordës. Në arkivat britanike që mbajnë datën e 1 janarit të vitit 1914-të, nën një titull sa dhimbës dhe mjaft domethënës për kohën, thuhet se 30 mijë njerëz janë në rrezik për jetën e tyre. Thuhet se të gjithë këta njerëz janë në rrezikun e urisë dhe vdekjes nga mungesa e ushqimeve.

Uilliam Uillard Houard nga Nju Jorku, që ishte i njohur për punën e tij ndihmëse për armenët e pushtuar nga turqit, gjithashtu dhe negociues i Kubës dhe viktimave të urraganit Galveston, kishte lënë Parisin në një rrugëtim të tij prej 700 kilometrash udhë në malet e Shqipërisë, që pikëtakojnë dhe Gollobordën mes Elbasanit dhe Dibrës. Houard pos këtij udhëtimi të parë, ndoshta të një amerikani me një mision në atë zonë malore, ka raportuar se një luftë civile ka qenë gati në shpërthim midis përkrahësve dhe forcave të Esad Pashë Toptanit dhe përkrahësve dhe forcave të Presidentit të Qeverisë së Përkohëshme të Shqipërisë, Ismail Qemal Beut.

Për këtë ai shpjegon se kishte parë me sytë e tij në zonën e Sebishtit, një fshat ky midis Klenjës dhe fshatrave të tjerë Steblevë, Trebisht, Ostren dhe Zabzun, fshatra të cilat ai i kishte shkelë me këmbët e veta për disa javë, kishte parë se mjaft njerëz të Esad Pashë Toptanit kishin hyrë në këto fshatra dhe po kërcënonin njerëzit. Sakaq Houard në datën 12 dhjetor 1913 ka qenë vetë dëshmitar i vizitës së fortë dhe mjaft të rëndësishme që kishte bërë në atë zonë, duke filluar me Sebishtin, vetë Aqif Pasha, Guvernatori i Elbasanit, i cili i kishte nën administrimin e tij të gjithë këto fshtra. Houard sqaron se Aqif Pasha ishte jo thjesht një Kryetar i Elbasanit, por ai kishte tërë autoritetin dhe forcën të menaxhonte territorin e tij shqiptar të Gollobordës, gjë që ai e konsideronte pjesë të zonës së tij qeverisëse. Gjithashtu, mes bisedëss së Houard dhe Aqif Pashës mësojmë se Golloborda dhe Gegëria, që ndahen nga Lumi Shkumbin, rrezikohen nga orekset bullgare dhe serbo-malazeze.

Tre ditë më vonë, pikërisht më 15 dhjetor 1913, Hourad thotë se ka qenë dëshmitar i një debati të ashpër mes dy forcave në konflikt, përkrahësve dhe forcave të Esad Pashë Toptanit dhe përkrahësve dhe forcave të Presidentit të Qeverisë së Përkohëshme të Shqipërisë, Ismail Qemal Beut, që përfaqësosheshin nga Aqif Pasha, në hyrje të Llangës, mbi Shkallë të Lunikut. Në këtë mision të forcave të Aqif Pashait u pa një ushtrim force nga përfaqësuesit e Esad Pashë Toptanit. Por vetëm dy ditë më pas më shumë se treqind vetë, të udhëhequr nga vetë Aqif Pasha kaluan këtë zonë dhe shkuan deri në Dibër të Madhe, ku morën në dorë të gjithë zonën e Gollobordës.

Më datën 19 dhjetor një mbledhje e rëndësishme është bërë në dalje të Trebishtit, në kufirin me Trebishta-Reka, ku janë caktuar dhe drejtuesit në atë zonë. Me një marrëveshje të plotë Golloborda që mbante vulën zyrtare të Elbasanit dhe mbështetjen ligjore të Aqif Pashës, kishte diktuar se ishte në kundërshtim me deklaratat dhe misionin e Esad Pashë Toptanit, që kishte synim mashtrimin me ndihmën bullgare dhe serbe për ato fshatra dygjuhëfolëse.

Më datën 21 dhjetor në një udhëtim të gjatë Houard është gjendur në zonën e Shkodrës, në një territor ku lakmitë e fqinjëve puqeshin me dëshirat dhe synimet e Esad Pashë Toptanit. Atje ai shënon se kishte tashmë me fakte se ishin mbi nëntë mijë refugjatë në Tiranë, pesë mijë në Shkodër, tre mijë në Elbasan dhe disa mijëra të tjerë nëpër fashtra, që tashmë kishin frikën dyfish, nga sllavët dhe nga forcat e Esad Pashë Toptanit.

Houard kishte takuar qindra refugjatë në vende të ndryshme. Më së shumti ata që linin Gollobordën dhe nuk pranonin të shkonin në territoret sllave, por me plot gojën e tyre dëshironin të ishin në territorin shqiptar të komanduar nga Ismail Qemal Beu. Mjaft prej tyre kërkonin me ngulm të takoheshin me Aqif Pashain. Houard thotë se Aqif Pasha ishte gati të shkrinte të gjithë pasurinë e tij për të ndihmuar këta njerëz, "vëllezërit e mi", sikurse ai ishte shprehur para tij.

Në shënimet e tij, tashmë të arkivuara, thuhet se ai kishte takuar pikërisht ata njerëz që kalonin malet drejt Elbasanit, për të marrë sadopak nga ndihma e Kryetarit Aqif Pasha, që në fakt ishte dhe mbeti i vetmi i atyre ditëve në ndihmë të asaj zone. Në Steblevë, në përpjetën malore që të shpie shkurt drejt Fushë Studnës, Houard kishte takuar një nga krerët e Trebishtit, që kishte grua nga Dibra e Madhe, dhe me të kishte biseduar gjatë. Ai i kishte thënë se fshatarët kishin rezerva ushqimesh, por ishin të pasigurtë, pasi hajdutë të ndryshëm, sidomos sllavë të ardhur nga fshatrat përreth bënin kërdinë, duke vjedhur ushqimet e tyre. Kjo të paktën ishte në realitet, pa harruara se ata kërcënoheshin dhe nga përkrahësit e Esad Pashë Toptanit.



Ekspedita e Houard ishte mbajtur gjallë nga një fisnik shqiptar në Zabzun, që i kishte hapur konakët e dy shtëpive të tij për të ndihmuar ata në nevojë. Ai nga ajo qëndresë në Zabzun, pa se shumica e fshatrave ishte bastisur dhe ata rrezikonin të mbeteshin pa ushqime. Me këtë rast ai kishte gjetur mbështetjen e Aqif pashës dhe disa tregëtarëve të tjerë nga fshtrat dhe qyteti i Elbasanit të dërgonin ushqime dhe veshmbathje në mjaft fshatra më në nevojë.

Gjatë kalimit të tij në një fshat të vogël, Vërvicë, që ndodhet mjaft afër Trebishtit dhe në kalim të lehtë për në Dibër të Madhe, dhe pse gjuha ishte mjaft e pastër me fqinjët, ku shumica flisnin dhe ishin shkolluar në gjuhën bullgare, kishte mësuar se dhe ata nuk pranonin të kishin influencë nga të tjerët, por nga Elbasani dhe nga forcat e Aqif Pashës. Arsyet ishin të thjeshta, dhe ai kishte mësuar se ata lidhjet i kishin të gjitha shqiptare, pavarëisht nga e folmja e tyre. Disa familje me ekonomi të mirë nga ky fshat kishin dhënë vullnetarisht ndihmë për disa gra të veja, disa jetimë dhe mjaft të tjerë kishin afruar ndihmë duke shkuar në rregjistrin e Kishës. Houard kishte asistuar vetë duke u ndarë ndihmat atyre që ishin më në nevojë.

Ai shënon dhe një fakt mjaft domethënës, të pranisë së hajdutëve të ndryshëm, dhe mjaft pasigurive që vinin nga të gjitha anët. Në udhëtimin e tij drejt Durrësit me avulltoren italiane "Molfetta" atij i ishte hapur dhe vjedhur edhe valixhja.

Ai thotë në shënimet e tij, se ka qenë dhe një dëshmitar i përleshjeve në kufi. Në Nëntor të vitit 1913-të ai shkruan se kishte parë me sytë e tij betejën në Vërnicë. Kishte parë pastaj betejat në kufirin me Malin e Zi dhe për këtë thotë se ai i shkruajti një ankesë dhe Kolonelit britanik Phillips, i cili ishe në atë kohë Guvernatori i Shkodrës. Në të njëjtën kohë ai i kërkoi Carit Nikolla telegrafisht që të tërhiqte trupat nga territoret shqiptare. Me këtë rast në shënimet e tij Hourad fajëson pesë fuqitë e mëdha të kohës për injorimin e fateve të këtij populli, sidomos të atyre që për një mijë e një arsye kishin fatin të kishin dygjuhësi e që ndodheshin nën një rrezik të madh të zhdukjes masive. Ai kërkon ndihma konkrete në të holla, ushqime dhe veshmbathje për shqiptarët në nevojë.

Duke u përqëndruar më së shumti në zonën e Gollobordës, në një zonë ku udhëheqja e Aqif Pashës kishte përcaktuar mjaft fate të mohuara, natyrisht ajo që duhet theksuar është se mjaft shqiptarë nga ajo trevë u vendosën nën mbështetjen e vetë Aqif Pashës në qytet dhe kështu lidhjet u forcuan akoma më shumë. Houard, i pa këto lidhje nga afër dhe shënoi me të madhe, se Golloborda ishte më mirë dhe dukej mjaft e sigurtë në lidhjen me Elbasanin. Aqif Pasha kishte në atë zonë dhe ata që vunë në rrezik me jetën e tyre dhe të familjeve të tyre pjesëmarrjen aktive në shpalljen e Pavarësisë dhe nënshkrimit e Atkit historik të saj.

Le të sqarojmë për lexuesit se Uilliam Uillard Houard (1860-1933) ishte pronar dhe redaktor i Uarren Ledger. Ai ishte një nga pesëmbëdhjetë korrespondentë të gazetave që u larguan nga Londra në dhjetor 1894, për të hetuar masakrat e armenëve në Turqinë lindore, madje ai ishte i vetmi që arriti, në rrezikun e jetës së tij, të depërtojë në brendësi të rajoneve të shkatërruara. Në vizitën e tij të dytë, ai shkoi si komisioner i ndihmës për të rregulluar shpërndarjen e fondeve të ndihmës. Qeveria turke e ndaloi atë të hyjë në vend dhe u detyrua të vinte një çmim në kokën e tij; kurdët e qëlluan atë, banditët e kapën, dhe shërbëtorë të tjerë të Sulltanit e bënin udhëtimin e tij të rrezikshëm.

Në një libër të vogël Houard flet nga njohuria e fituar nga gati një vit e gjysmë i vëzhgimit personal dhe hetimit të kujdesshëm në vendin e pikëlluar. Ai nuk është as armik, as misionar, dhe ai flet pa racë ose paragjykim fetar. Dëshmia e tij është dëshmi e një amerikani dhe njeriu të paanshëm të çështjeve që tani vjen drejtpërdrejt nga toka gjak e ngjyrosur, nga Armenia. Ky libër është i botuar në vitin 1895 dhe shënimet e mbajtura në Shqipëri prej tij janë mjaft domethënëse, sidomos kur sot "hale" dhe politika të ndryshme bëjnë dhe krijojnë etni dhe etnicitete pa kriter.

Ai shpjegon se kishte parë me sytë e tij në zonën e Sebishtit, një fshat ky midis Klenjës dhe fshatrave të tjerë Steblevë, Trebisht, Ostren dhe Zabzun, fshatra të cilat ai i kishte shkelë me këmbët e veta për disa javë, kishte parë se mjaft njerëz të Esad Pashë Toptanit kishin hyrë në këto fshatra dhe po kërcënonin njerëzit. Sakaq Houard në datën 12 dhjetor 1913 ka qenë vetë dëshmitar i vizitës së fortë dhe mjaft të rëndësishme që kishte bërë në atë zonë, duke filluar me Sebishtin, vetë Aqif Pasha, Guvernatori i Elbasanit, i cili i kishte nën administrimin e tij të gjithë këto fshtra.

arsim

Në të gjitha fshatrat e zonës zhvilluan mësimin 42 kurse të luftës kundër analfabetizmit, ku mësuan të lexojnë e të shkruajnë mbi 200 të rinj e të reja.

Shkolla e parë shqipe në Kala të Dodës, mbartëse e traditave shekullore të dijes e shkollimit

Nga **Beqir SHEHU**

(vijon nga numri i kaluar)

ZHVILLIMI I ARSIMIT E KULTURËS NË FSHATRAT E KALASË DODËS PAS ÇLIRIMIT TË VENDIT.

Masivizimi i shkollës dhe i arsimit në kushtet e Shqipërisë së prapambetur përbënte një nga objektivat themelore të politikës arsimore të udhëheqjes partiake dhe shtetërore në Shqipërinë e sapo çliruar.

Zgjedhja e sistemit socialist si model i zhvillimit të ardhshëm të Shqipërisë,përcaktoi edhe rolin e shkollës në këtë proçes si intitucioni më i rëndësishëm në përgatitjen e qytetarve të kësaj shoqërie. Reforma arsimore e vitit 1946 dhe një sërë urdhëresash e dekumentash partiake e shtetërore synonin dhe realizuan ristrukturimin e gjithë sistemit arsimor ekzistues për transformimin dhe ndërtimin e një shkolle cilësisht të ndryshme,ku shteti merrte përgjegjësitë e organizimit por edhe të kontrollit të plotë mbi këtë sistem, duke përcaktuar kuadrin ligjor,programet dhe planet mësimore,mënyrën e organizimit dhe financimit etj.

Vetëm pas shtatorit të vitit 1944 kur edhe në Kala të Dodës, erdhën udhëzimet e Konferencës Arsimore të 2 shtatorit 1944,që u mbajt në Gjirokastër dhe të Kongresit të Parë të Arsimtarve të Shqipërisë që u mbajtë në Korçë më 25-27 nëntor 1944, ku nënvizohej qartas karakteri masiv e popullor i Shkollës së Re Shqipe,filluan përpjekjet e organeve drejtuese të pushtetit vendor,që ishin Këshillat Nacional-Çlirimtare për hapjen e shkollave dhe për një punë të organizuar të luftës kundër analfabetizmit.

Në tetor të vitit 1944, në saj të një pune serioze të organeve të pushtetit vendor dhe të gadishmërisë të admirueshme të popullit u bë e mundur që të rihapet shkolla fillore në Ploshtan me mësues Qazim Kuqashi, Qamil Hoxha dhe Rifat Domi.Shkollën fillore të Ploshtanit e frekuentonin nxënësit e fshatrave Ploshtan,Vasije ,Ceren dhe Shullan.Ndërsa në dhjetor të vitit 1944 u hap shkolla fillore Radomirë e cila frekuentohej nga fëmijtë e pesë lagjeve të këtij fshati.

Nga dhjetori 1944 deri në qershor 1945 u hapën shkolla fillore edhe nëGështenjë-Kalis me mësues Mehdi Dacin, në Gjegje me mësues Qazim Zylfi Domin dhe në Fshat me mësues Ahmet Brikën. Në këto shkolla mësimi zhvillohej sipas kushteve të luftës. Ndërsa në vjeshtën e vitit 1945 filloi mësimi i rregullt për vitin kalendarik me udhëzime, programe e tekste mësimore duke e xhveshur punën mësimore në shkolla nga metodat e shkollimit partizan të zhvilluar gjatë luftës Nacionalçlirimtare.

Masivizimi i shkollës dhe transformimi i saj në një shkollë ku të mishëroheshin pikpamjet e lirisë e demokracisë me qëllim që ajo të konceptohej si shkollë socialiste u përcaktua me detyrat e Reformës Arsimore, të vitit 1946.

Një nga detyrat e rëndësishme që përcaktonte Raforma Arsimore e vitit 1946 ishte lufta kundër analfabetizmit me qëllim që të gjithë të rinjtë e të rejat nën moshën 40 vjeç të mësonin shkrimin e këndimin e gjuhës shqipe. Duke qenë një problem parsor i shtetit,si kudo në Shqipëri edhe në fshatrat e Kalasë Dodës,u zhvillua fushata kundra analfabetizmit me një përkushtim të paparë jo vetëm nga organet e Pushtetit Popullor por edhe nga pjesmarrja dhe dëshira e papërmbajtur e të rinjve dhe të rejave për të mësuar shkrimin e këndimin e gjuhës shqipe.Sipas të dhënave që na ofron studjuesi Isa Halili në librin "Kukësi në sofrën e arsimit kombëtar"mësojmë se edhe në fshatrat e Kalasë është zhvilluar një punë kolosale ku qindra të rinjë e të reja të moshës jo shkollore mësuan shkrim e këndim dhe kryerjen e disa veprimeve të thjeshta arithmetike në këto kurse.

Në të gjith fshatrat e zonës, zhvilluan mësimin 42 kurse të luftës kundër analfabetizmit, ku mësuan të lexojnë e të shkruajnë mbi 200 të rinjë e të reja.

Zbatimi i Reformës Arsimore edhe në fshatrat e Kalasë Dodësu konkretizua, duke filluar me hallkën bazë të sistemit arsimor-shkollën fillore. "Programi i Shkollës Fillore"më 1946,teksti i Abetares dhe tekstet e tjera u mirpritën,jo vetëm nga mësuesit,por edhe nga nxënës e prindër,të bindur se kjo punë po fillonte mbi bazën e traditës kombëtare të shkollës shqipe.

Në vitin shkollor 1948-1949, në 16 fshatrat e lokalitetit të Kalasë Dodës me qendër në Ploshtan,u vunë në fuksionim 12 Shkolla fillore në fshatrat: Ploshtan, Ceren, Radomirë, Shullan,Kalis,Vilë, Gjegje, Palushe, Bushtricë, Fshat, Buzmadhe e Çajë duke siguruar kushte për tërheqjen e të gjithë fëmijve të fshatrave të lokalitetit Kala e Dodës në arsimin e detyruar fillor.

Në vitin 1948, pranë shkollës fillore në Ploshtan, u hap edhe klasa e 5-të e shkollës shtatëvjeçare, e para në krahinë e cila do të bëhej edhe vatra e parë e përgatitjes së kuadit arsimor për shkollat fillore që do të hapeshin në vazhdimsi.Shkolla u hap në ndërtesën dy katshe të hotelit të vllezërve Rufat,Myslim e Sadik Maliki,të cilët e dhuruan për hapjen e shkollës pa asnjë shpërblim. Në klasën e pestë, të hapur për herë të parë, u rregjistruan 14 nxënës të ardhur edhe nga Bushtrica, Çaja e Kalisi. Nxënësit e parë të kësaj klase ishin:Xhemal Domi,Xhemal Cala,Axhem Sufa, Ramadan Gjorllaku, Ali Kovaçi, Nuri Skeja, Bajram Brika,Abdurrahman Tota,Ilmi Palushi, Xhafer Koka, Asllan Matraxhi e Qerim Lama. Drejtor i shkollës ishte Qazim Kuqashi nga Elbasani, e më pas Guljem Gjoni e Ekrem Kruja nga Shkodra dhe Halim Shehu nga Vlesha. Kuadri mësimor në fillim u plotsua me mësues të ardhur, kryesisht nga Shkodra, si Iljas Lumani, Bahri Mesi,Xhabir Topalli, Gabriel Prokola, Lezina Gjini,por edhe nga Kuksi,si: Qamil Hoxha, Enver Onuzi, Angjelina Kastrati, Ethem Dogjani e Halil Korbi;si dhe Gani Skuka prej Maqëllare.etj.Ndërsa mësuesi i vetëm i krahinës që jepte mësim në këtë shkollë ishte Malik Lika. Ardhja e mësuesve nga shkodra ndikoi dukshëm jo vetëm në rritjen e nivelit metodik e shkencor të mësimdhënjes por e ktheu shkollën edhe në një qendër kulturore e argëtimi për nxënësit dhe të gjithë të rinjve të fshatrave përrreth. Në vitin 1952,kur këta nxënës merrnin dëftesat e lirimit,klasa e pestë dhe e gjashtë ishin të plotmbushura me nxënës duke siguruar një vijimësi normale të shkollës parë shtatë vjeçare në krahinën e Kalasë Dodës.

Nuk mund të lëmë pa përmendur veprimin e mrekullueshëm të familjes së Ymer Sul Hidrit(Feratit) në Ploshtan dhe Sami Isa Vishës e Sheh Muratit në Ceren,si dhe Mehmet Madanës në Radomirë,që pranë dhomave të miqve në shtëpitë e tyre, paisën me shpenzimet e tyre dhomat ku banonin mesuesit,duke u siguruar edhe përgatitjen e ushqimin për çdo ditë ashtu siç hanin në familjet e tyre pa asnjë shpërblim. Këto familje ishin shtëpi të mëdha me një ekonomi të mirë e cila sigurohej kryesisht me mbarshtimin e dhenve.

Në vitin 1953,fshatrat e Kalasë Dodës: Radomira, Cereni,Ploshtani,Vasijet dhe Shullani me kërkesën e tyre kaluan në vartësi administrative të Qarkut Dibër.

Po në vitin 1953, për fshatrat që mbetën në varësi administrative të Qarkut Kukës,në vendin e quajtur Guri i Qyqes,në mes të fshatrave Bushtricë,Gjegje dhe Palush e Matraxh, u hap klasa e parë e pestë e shkollës shtatëvjeçare në godinën e re të ndërtuar në afërsi të godinës së lokalitetit, qendër administrative e fshatrave të krahinës Kala e Dodës që mbetën në varësi administrative të Qarkut Kukës.Drejtor i parë i shkollës shtatëvjeçare Bushtricë ishte Rifat Domi i cili ka dhënë një kontribut të vyer në zhvillimin e arsimit në krahinën e Kalasë Dodës.Ndërsa mësuesit e parë të shkollës shtatëvjeçare ishin Ali Shehu e Ali Domi,Lazam Koldashi,Abdurrahman Tota,Nezir Jata, Ilmi Palushi,e më pas Qerim Cena, Miftar Halili,e Hamit Bajraktari nga Bicaj si dhe mësueset e ardhura nga rrethet tjera si Violeta Xhakollari,Violeta Papandoni,Sanda Doraci,Merita Topulli e Shqiponja Çino ardhur nga Gjirokastra si dhe Dhurata Qinami etj.

Shtrirja e arsimit shtatëvjeçar në Kalis në vitin 1959 në Fshat më 1960, në Vilë më 1964 dhe në Radomir më1966,krijuan mundësi që pothuaj të gjithë fëmijtë e fshatrave që ishin jo më larg se 3 km të përfshiheshin në arsimin e detyruar shtatëvjeçar duke siguruar tërheqjen e mbi 80 % të nxënësve,në këtë hallkë të sistemit arsimor.

Duhet të vemë në dukje se shkollat shtatëvjeçare duke u ngritur pranë shkollave fillore ku frekuentimi ishte i detyruar edhe për vajza,tërheqja e tyre në arsimin e detyruar shtatëvjeçar nuk solli shumë probleme as për drejtorit e shkollave dhe as për organet e pushtetit në bazë.

Në vitin 1967 arsimi shtatëvjeçar u bë arsim tetëvjeçar i detyruar.Hapja e shkollave tetëvjeçare edhe në Çajë më 1968 në Buzmadhe më 1969 dhe në Gështenj-Kalisë më 1970 si dhe hapja e shkollave të ciklit ulët në fshatrat Tejs,Çernjevë, Shullanë e Vasije të Kalasë Dodës; që ishin kthyer në juridiksionin e Qarkut Diber,si dhe në Gurrë-Kalis në Mëhallën e Poshtme në Pralisht, në Vilë, në Shpat(Mëzhuzh) dhe Barruç, në Bushtricë në Livadhe të Braze, si dhe në Shkinak e Çajë të Epër,krijuan mundësi që fëmijtë e të gjitha fshatrave të Krahinës së Kalasë Dodës të përfshiheshin në arsimin e detyruar tetëvjeçar. Kështu edhe në krahinën e Kalasë Dodës, u realizua një nga objektivat më të rëndësishme të Reformës arsimore që ishte masivizimi i shkollës mbi kritere ligjore e drejtuar dhe organizuar nga Partia Shtet.

Vitet 1960 qenë të mbushura me ngjarje të mëdha në jetën ekonomike, shoqërore e politike të vendit tonë.Ndarja nga Bashkimi Sovjetik ,Kolektivizimi i bujqësisë edhe në fshatrat e malsisë,lëvizjet revolucionare si ajo kundër fesë e zakoneve prapanike e për emancipimin e gruas;sollën nevojën e riorganizimit të shkollës që nga themelet e saj.

Në analizën e këtyre problemeve të shkollës,organet drejtuese qendrore të partisë e pushtetit përcaktuan drejtimet e riorganizimit të shkollës me qëllim të lidhjes së saj me jetën,dhe në përgatitjen e kuadrit të nevojshëm për organizimin dhe drejtimin e jetës ekonomike dhe shoqërore në vend.

Zhvillimi i dijeve dhe kulturës edhe në fshatrat e krahinës së Kalasë Dodës, nuk mund të përceptohet pa kontributin e mësuesve e shkollës. Kultura dhe arsimi janë komplementare,e në këtë kuptim nuk mund të kuptohen pa njëra tjetrën.

Riorganizimi i përmbajtjes së punës mësimore edukative që do të synonte në lidhjen e shkollës me jetën,të teorisë me praktikën, dhe të forcimit të punës edukative me vendosjen e tre komponentëve mësim, punë prodhuese e kalitje fiziko-ushtarake në radhë të parë do të ishte detyrë e trupës mësimore të këtyre shkollave. Mobilizimi i mësuesve në të gjitha shkollat ,edhe pse në kushte shumë të vështira ,veçanërisht për ata mësues që nuk jepnin mësim në shkollat e katundeve të tyre e detyroheshin të udhtojnë edhe mbi 2 orë në borë e në shi vetëm për të shkuar pranë shkollës ku jepnin mësim,pa llogaritur kthimin për në shtëpi, që sa herë i zinte nata në rrugë, ata nuk u dorzuan kurrë para këtyre vështirsive,madje me një përkushtim të jashtëzakonshëm dhe me një sedër e ambicje nxitëse, garonin midis tyre për të arritur rezultate sa më të mira me klasën dhe nxënësit e tyre por edhe me shkollën e tyre

Në fshatrat e krahinës së Kalasë Dodës, si kudo në krahinat malore,ku institucionet e mirfillta të kuturës mungonin, mësimin e dijeve kulturore dhe zhvillimin e aktiviteteve kulturore e sportive e kanë organizuar,drejtuar dhe kryer mësuesit dhe nxënësit, në bashkëpunim me të rinjtë dhe të rejat e fshatrave, jo vetëm në ambjentet shkollore por edhë në fshat e natyrë sipas kushteve që kërkonte kryerja e saj.

Dijet kulturore për nxënësit jepeshin nëpërmjet, organizimit të rretheve të ndryshme që ngriheshin pranë shkollave si rrethet e natyralistëve dhe biologve,rrethet e mbledhësve të gojtarisë popullore dhe folklorit,rrethet letrarve të ri dhe të gjuhtarëve, rrethet e historianëve e arkologëve, rrethet sportive etj. Në këto rrethe jo vetëm që jepeshin dije teorike dhe praktike në fushat përkatse por formonin edhe shprehi loje e interpretimi si në aktivitete sportive ,në mesimin për të interpretuar në vegla muzikore,në kërcim vallesh popullore etj. Nga këto rrethe dolën instrumentist e valltarë deri virtuoz që shkëlqyen në aktivitet kulturore e sportive që zhvilloheshin në takime mes shkollash,në festivele e olimpiada por gjallëruan dhe ngritën nivelin e interpretimit edhe në dasma festa e aktivitete të tjera duke krijuar kënaqësi e emocione frymzuese te shikuesit.

Kontributi i drejtuesve dhe mësuesve të këtyre shkollave,vendas dhe të ardhur,për këtë periudhë kohe në zhvillimin e proçesit mësimor edukativ,ka qenë i jashtëzakonshëm.

Në shkollën tetvjeçare Ploshtan,pas viteve 1965 kanë drejtuar shkollën:Xhemal Cala,Beqir Shehu,Jahe Delia,Nezim Deda,Abaz Daci,Sulejman Istrefi,Rasim Deda,Shaqir Kovaçi,Shpëtim Brika,Isa Lita dhe Rushit Mena.

Kanë dhënë mësim në këtë shkollë, pas vitit 1965,përveç drejtorve që përmendëm,mësuesit,Servet Ferati,Shemsi Hysa,Ramiz Shehu,Subi Deda,Jahe Delia,Nezim Deda,Ismet Sinani,Shehat Palushi,Ibrahim Daci,

Shkolla 8 vjeçare Ploshtan kishte në varsi tre shkolla të ciklit të ulët:Shkollën e Ploshtanit,Vasije dhe Shullan.

Në Shkollën fillore të Ploshtanit kanë dhënë mësim këta mësues:Ramadan Gjorllku,Shaqir Kovaçi,Mirjana Kaziu,Fllanxa Ferati,Hatixhe Kadia, Jonuz Daci.

Në Shkollën Fillore Vasije:Maliq Lika,Eshref Përzhilla,Ali Lita,Zia Shehu,Luljeta Shehu.

Në Shkollën Fillore Shullan: Xhelal Abazi, Rrahim Lahi,Bedri Abazi,Sait Borishi.

Në vitin 1956,Shkolla 7 vjeçare Ploshtan kalon në fshatin Ceren me nxënës që vinin nga gjithë zona e Kalasë Dodës. Drejtor shkolle kanë qenë:Eqerem Kruja,Fehmi Xhepa,Ferit Hasani Shemsi Hysa, Miftar Halili, Iljaz Palushi. Shkolla 7 vjeçare qëndroi 10 vjet në Ceren,dhe në vitin 1965;klasat e larta të arsimit të detyrueshëm kalojnë përsëri në Ploshtan;dhe për fshatrat Ceren Radomir hapet Shkolla 8 vjeçare në Ujmirë me emrin Shkolla 8 vjeçare Radomirë.Në Shkollën 8 vjeçare Ceren kanë dhënë mësim,përveç drejtuesve që përmendëm më lart,Xhafer Martini, Naim Plaku,Veli Spata, Alush Cala, Sami Shehu,Gani Beqiri,

Në ciklin e ulët të kësaj shkolle kanë dhënë mësim,duke filluar që nga viti 1947 mësuesit Mehdi Daci, Ndoc Deda nga Shkodra, Basri Noka nga Novosej,Sali Domi, Cen Domi, Met Dogjani,dhe më pasAxhem Sufa,Faik Shehu,Bajram Çekiçi.

Në Shkollën 8 vjeçare Radomir pas vitit 1965 kur u hap kjo shkollë;kanë drejtuar Shkollën:Xhemal Domi,Miftar Halili,Bajram Ndreu, Murat Halili,Shezivar Koka,Rrahman Gjoka,Fidane Kadiu.Kanë dhëne mësim në këtë shkollë përveç drejtuesve,mësuesit:Fahri Hysa Gani Beqiri,Rifat Selmani,Jeshar Hoxha,Hajredin Madana,Pëllumb Elezi,Ismet Sinani Agim Çekiçi,Ethem Shehu,Jasim Mandrri,Manushaqe Sinani,Naim Çorja Rrahim Shehi,Idris Kadia Fidane Kadia..

(vijon në faqen 29)

Besmira Ahmati ka fituar Medaljen e Argjendtë dhe puna e saj vlerësohet e dyta jo në 100, por 448 punime.Ajo ka fuqinë e një zane. Ka shkuar në atdheun e lirisë SHBA, duke shpalosur mundin e djersën e saj.

profil/intervistë

Zambaku i Korabit

Nga **Metush SKEJA**

Besmira Ahmati ka personalit të fuqishëm në lulëzim. Natyra i ka dhënë diçka plus njerëzve të tjerë ose do të ishte mirë me thënë i ka dhënë shumë pluse.Ajo ka energjinë e mendjes, bukurinë e shtatit dhe sjelljen fisnike nga gjaku e vetja. Shkreptima e parë e talentit të saj u shfaq në konkursin ndërkombëtar në lëndën e fizikës për shkollat e mesme. Gjeneratat e reja nga gjithë globi u mblodhën në Hjuston të SHBA nga 3-7 maj 20012. Konkursi është zhvilluar mbi projektet më të mira teknologjike e shkencore. Janë përzgjedhur 448 punime. Besmira Ahmati në fazën përfundimtare ka fituar vendin e dytë. Konkursi ndërkombëtar futet te më të mirët e planetit.Kjo do të ishte ëndërr e guximshme.Është përballur me emocione të forta duke i vënë nën kontroll.Në përfundim të konkursit një kolegj amerikan i ka ofruar bursë prej 36 mijë dollar,si dhe disa universitete italiane.Besmira ka preferuar këtë të fundit. Organizatorët e konkursit,fituesit i kanë çuar në qendrën e NASA duke i shëtitur me avion sipër saj.Ngjason me udhëtim yjesh.

Besmira Ahmati ka lindur në Tiranë ,më 1995.Ka studiuar në kolegjin "Tugut Ozal".Ka qenë nxënës i vetërregulluar për të arritur një qellim.Më shumë se gjithëçka e ka motivuar suksesi i vet, aftësia për ti dalë mbanë detyrave duke marrë pjesë aktivisht në ndërtimin vetiak të njohurive.Vazhdimisht



I –SWEEP cilësohet nga më prestgjiozët. Juri të tilla janë gjykatësit më të mirë.

A mund të quhet Besmira Ahmati talent? Për këtë le ta krahasojmë me standartet e vendosura në shkallë globale."Origjinaliteti përcaktohet në mënyrë statistikore. Për të qenë origjinal një përgjigje duhet të jepet nga më pak se 5 njerëz në çdo 100 njerëz që i nënshtrohen testit". (Anita Woolfolk, Psikologji edukimi,Tiranë,2011,f.290). Besmira ka fituar Medaljen e Argjendtë dhe puna e saj vlerësohet e dyta jo në 100, por 448 punime. Ajo ka fuqinë e një zane. Ka shkuar në atdheun e lirisë SHBA duke shpalosur mundin e djersën e saj. Aftësia e saj ka krijuar punë të papërsëritshme dhe të dobishme për njerëzit. Produkti i punës së saj identifikohet i ri, që nuk e ka kryer askush më parë.Njerëz të tillë kanë organizëm të veçantë të trurit. Arsimimi ka qenë adekuat në përputhje me periudhat sensitive të zhvillimit,me momentet kohore ku individi ka qenë i gatshëm për përvoja të caktuara.Ajo ka ndryshim befasues zhvillimi nga një periudhë sensitive në tjetrën.Po cili është raporti mes aftësive të lindura përkundër aftësive të fituara?.Ky diskutim është i mbyllur."Psikologët pohojnë se sjelljet përcaktohen 100% nga biologjia dhë 100% nga mjedisi.Ato nuk mund të ndahen".(Anita Woolfok, Psikologjia edukimit,Tiranë,2011,f.27)

Për moshë e saj të re mos ndoshta kemi thënë para kohe talent.Historia e njerzive mendjendritur ka treguar se të gjithë në mosha të reja kanë bërë zbulimet e shpikjet më të mëdha.Pjesëmarrja në konkurse ndërkombëtare kërkon njohuri të gjëra,organizim e motivim të brenshëm.

Udhëtimin nga Tirana në Hjuston unë do ta quaja udhëtim siziftian.Mjedisi sfidues. Shumë pikëpyetje e kanë shoqëruar,Si do të paraqitem?A do të kem sukses apo do të dështojë,a do të merret në konsideratë projekti im?Le pastaj të ketë cilësinë të e ka zgjeruar mendjen e vet duke u dhënë kuptim informacineve që ka marrë.Titulli i shkrimit në mënyrë të figurshme, Besmirën e kemi quajtur zambak,si organizëm i rrallë.Në mënyrë të pafigurshme ne vendin tonë rritet vetëm një llojë zambaku.Ky është zambaku shqiptar.Ai gjendet edhe në Korab.Disa mendojnë se zambaku i Korabit është llojë më vete. Po sa do të dëshiroja unë që në olimpiada e konkurse ndërkombëtare vendi ynë të zinte përherë vendet e para.

Mjedisi familjar ku lindur edhe është edukuar Besmira ka qenë nxitës.Prindërit e saj janë nga Radomira,rrëzë Korabit.Stili i prindërimit ka qenë në nivele të larta të ngohtësisë e kontrollit. Prindër me autoritet.I kanë dhënë shumë dashuri e shumë kontroll,i kanë shpjeguar arsyet e rregullave dhe vendimet i kanë marrë në mënyrë demokratike.Nuk kanë qenë të rreptë e ndeshkues. E kanë ndihmuar vajzën e vet.Çdo shqetësim ja kanë zgjidhur.Pas shkollës mësme Besmirës i është ofruar bursë dhe ka studiuar në Universitetin" Bucconi "në Milano, Itali dega shkenca ekonomike e financë.Më ,16nëntor 2016 ka përfunduar bachelor.Rektori i universitetit Andrea Sironi është personalitet në shkencë, i cili ka firmosur diplomën së bashku me shefin ekzekutiv Bruno Pavesi.Në vitin 2026-2017 ka punuar në bankën evropiane të investimeve me qendër në Luksemburg.Pranimi është bërë me konkurs.Por nuk është mjaftuar me kaq. Njerzit inteligjent shkollohen sa më shumë. Sipas Sternberg inteligjenca si proces ka të bëjë me suksesin që individi arrin në jetë,në përputhje me kontekstet kulturore.

Tani Besmira studion ciklin mastër, në Rotterdam Holandë,në Erasmus University,dega financë-bankë. Erasmusi është rilindas.Ai ka qenë një përfaqësues i madh i shpirtit të Rilindjes Europiane. Të studiosh këtu është fat.Nëse do të përdorja një cilësor në dialektin e veriut për të përcaktuar Besmirën do të thoja sipakkundshoqe.

Pëllum Kaloshi

i riu premtues në botën e aktrimit



Dibra është një nga dashuritë e mia, si gjithë dibranët. Aty u linda dhe u rrita dhe u bëra ky që jam. Sa herë kam mundësi shkoj në Dibër dhe çdo herë që shkoj, e them me krenari që jam dibran.

Pëllum Kaloshi është një aktor i ri dibran, i lindur në Sinë dhe është shumë i kërkuar nga regjisorë vendas dhe të huaj. Ai nuk ka studiuar akademinë e arteve, por spikat në rolet dhe në lojën e tij amatoreske. Edhe pse i ri dhe pa ndonjë eksperiencë madhore, Pëllumi ka luajtur në 2014 në filmin me regji të Fatmir Koçit që u bë shumë i shikuar "Pit Stop Mafia". Aktualisht është në mes të një projekti të madh që pritet të bëjë bujë në kinematë shqiptare. Sipas tij, veç aktrimit biznesi është një tjetër fushë ku ka dhënë frytet e tij. Ai merret me biznesin e tregtimit të makinave dhe së shpejti ai dëshiron të bëjë një film me tematikë pikërisht makinat. Kaloshi ka një miqësi të mirë me shumë kolegë me peshë në kastin e aktorëve të njohur shqiptarë, që sipas tij edhe vetë e sheh veten në vend të tyre pas disa vitesh. Ai shprehet optimist dhe njëkohësisht shumë krenar që është nga i njëti vend me Skënderbeun. "Ndihem krenar që jam dibran" - thekson Kaloshi për gazetën tonë.

Pëllum, ti je një zë i ri dhe premtues në botën e aktrimit në Shqipëri. Na thuaj diçka më shumë për veten tuaj?

Përshëndetje të gjithë lexuesve të "Rrugës së Arbërit" dhe ju që bëni me të vërtetë një punë të mirë për Dibrën. Unë kam lindur në një fshat të Dibrës që quhet Sinë e Poshtme. Si çdo i ri kërkova një jetë më të mirë duke u larguar nga fshati, sepse dihet tashmë jeta në fshat dhe në Dibër. U largova jashtë Shqipërisë dhe që në atë kohë nuk jam kthyer të jetoj në Sinë, por jetoj në Tiranë për të ndjekur më mirë ëndrrën time.

Si ka qenë fëmijëria juaj?

Fëmijëria në fshat ka qenë me të vërtetë e bukur, duke shijuar çdo çast dhe çdo ditë të fëmijërisë tonë. Duke marrë parasysh mungesat ekonomike, vështirësitë na kanë bërë më të ndryshur dhe më të mbyllur si zonë, duke pasur parasysh dhe kushtet gjeografike. Edhe sot atje në Dibër kushtet lënë për të dëshiruar , jo më në kohën time, ku ka qenë shumë më e vështirë.

Si u gjende në fushën e aktrimit?

Eh, në fakt në fushën e aktrimit jam gjendur me të vërtetë krejt rastësisht. Para 3 viteve unë isha pjesë e filmit "PIP STOP MAFIA" me regji të Fatmir Koçit, gjë e cila zbuloi për mua një pasion që në fëmijëri e kam pasur. Pasioni për aktrimin. Aktualisht unë jam pjesë e kastit të filmit më të ri aksion shqipëtar që titullohet "Dashuria s'mjafton", me regji të Drilon Hoxhës me një kast të njohur aktorësh dhe natyrisht aktorë të rinj.



Vizitoni shpesh Dibrën?

Normalisht që Dibra është një nga dashuritë e mia, si gjithë dibranët. Aty u linda dhe u rrita dhe u bëra ky që jam. Sa herë kam mundësi shkoj në Dibër dhe çdo herë që shkoj, e them me krenari që jam dibran.

Kush janë pasionet e tjera të tuat dhe kush është Pëllumi në jetën e përditshme?

Pasionet e mia janë të shumta. Makinat e bukura dhe të shpejta janë një pasion me të vërtetë i madh tek unë. Aktrimi dhe futbolli janë pasionet e tjera të cilat bëjnë diferencën nga nga pasionet tjera. Unë kam një jetë të thjeshtë. Jetoj në Tiranë dhe jetoj pa familjen dhe duhet të llogaritet që jetoj vetëm dhe bëj çdo punë të shtëpisë. (qesh) Mua më duhet të gatuaj, të laj, të fshij. Nuk e kam problem për asgjë, madje shpesh nxjerr foto në rrjete sociale me fshesë në dorë. Ahahahha "Voc për shpaj mo|"

Ke dikë që do të falenderoje?

Familja është kryesorja që dua ta falenderoj, sepse më ka mbështetur dhe më ka dhënë forcë për të vazhduar këtë pasion. Regjisorin dhe aktorin Drilon Hoxha, që më ka dhënë me të vërtetë një ndihmë mjaft të madhe. Ne kemi pasur bashkëpunime dhe do të kemi në vazhdim për të sjellë punë të reja dhe akoma më të bukura. Unë po ashtu dua t'u them të rinjve që të punojnë fort dhe të jenë të zotët e vetes së tyre. Ndiqni shkollën dhe pasionet tuaja, sepse në qoftë se nuk i ndiqni sot, më vonë nuk do të mundeni.

Intervistoi: **Samet Zagradi**

portret

Nuk jam nga ata që e kuptojnë dhe zbërthejnë mirë pikturën, por këto vepra të Bajram Matës më emocionuan shumë, jo vetëm se janë vepra cilësore, por, ndoshta, dhe nga fakti qe unë pata fatin që ta njoh këtë njeri të talentuar në kohët e këqija për të.

Portrete njerëzish, siç i kam njohur unë...

Piktori dibran Bajram Mata

Nga **Petro MEJDI**
ish-mësues në Ostren, Zalldardhë





Është e njohur ndihmesa që i ka dhënë Dibra në fushën e letërsisë dhe arteve kulturës kombëtare. Në letërsi njihet ndihmesa e Haki Stërmillit, Inajet Shehut, Arian Kadiut, Xhafer Martinit etj. Dibra i ka dhënë muzikës shqiptare kompozitorin e njohur Muharem Xhediku, autorin e sa e sa këngëve dhe sidomos tangove të tij të mrekullueshme. Janë të njohur këngëtarët e muzikës popullore si Aziz Ndreu, Liri Rasha, Caje Poleshi, Qerim Sula, Shaban Dervishi, Abdyl Sturçja, Melita Shehu etj. Një sërë aktorësh të teatrit dhe filmit kanë dalë nga trevat e Dibrës si, Drita Agolli, Esma Agolli, Bexhet Nelku, Behar Mera. Skënder Cala etj. E ndjeshme është ndihmesa e piktorëve dibranë në zhvillimin e arteve figurative. Veprat Bajram Matës, Duro Karaibrahimit, Zaim Elezit etj., janë paraqitur në Ekspozita Kombëtare dhe janë vlerësuar dhe me çmime. Dibran është në origjinë dhe piktori i njohur Nexhmedin Zajmi, autori i veprës "Bisedë nga Lufta Nacional-Çlirimtare" etj.

Por unë dua të shkruaj sot për njërin nga piktorët dibranë, Bajram Mata, ndoshta nga më të talentuarit e brezit të tij, por dhe më fatkeqit. Me studime në Bashkimin Sovjetik (ndoshta, të papërfunduara). Talenti i tij ra në sy dhe atje. Kur shumica e të kthyerve u mbajtën në Tiranë, midis tyre edhe më pak të talentuar , ai u emërua në Peshkopi. Kjo, ndoshta, ndikoi më vonë dhe në ecurinë e veprës së tij, por dhe fatit të tij si njeri. Krijimet e tij tërhoqën vëmendjen e kritikës së specializuar të arteve figurative. Në Galerinë e Arteve Figurative në Tiranë, në ekspozitën me vepra nga epoka e realizmit socialist në pikturë, janë ekspozuar 3-4 vepra retrospektive të tij. Nuk mbaj mënd titujt, por këto vepra të tij janë nga ato të cilat kritika e kohës i quajti "të gabuara dhe me elemente moderniste". Një e tillë është kompozimi "Kooperativistet". Në mes të një parcele të mbjellë me misër tre gra zerqanase dhe bulqizake, që individualizohen si të tilla me veshjen karakteristike të këtyre zonave, po i gëzohen prodhimit të mbarë të misrit, i cili është gati sa dyfishi i grave në gjatësi dhe aq të dendura bimët sa gratë nuk shohin as dritë dhe as rrugën se si do dalin prej parcelës. Censura e ndaloi atëhere veprën me pretekstin se aty ka prodhim, por nuk ka perspektivë për njeriun. Misri na dilka mbi njeriun që e rrit atë! Me këndvështrimin e sotëm, kompozimi tingëllon i freskët dhe se ka fiksuar në telajo një aspekt të jetës së socializmit. Edhe dy veprat e tjera, sidomos ajo me tre portrete vajzash të reja, me një pozicion që më shumë të jep përshtypjen se duan të fluturojnë, se sa të punojnë. Nuk jam nga ata që e kuptojnë dhe zbërthejnë mirë pikturën, por këto vepra të Bajram Matës më emocionuan shumë, jo vetëm se janë vepra cilësore, por, ndoshta, dhe nga fakti qe unë pata fatin që ta njoh këtë njeri të talentuar në kohët e këqija për të.

Bajram Mata, ndoshta nga më të talentuarit e brezit të tij, por dhe më fatkeqi. Me studime në Bashkimin Sovjetik (ndoshta, të papërfunduara). Talenti i tij ra në sy dhe atje. Kur shumica e të kthyerve u mbajtën në Tiranë, midis tyre edhe më pak të talentuar, ai u emërua në Peshkopi. Kjo, ndoshta, ndikoi më vonë dhe në ecurinë e veprës së tij, por dhe fatit të tij si njeri. Krijimet e tij tërhoqën vëmendjen e kritikës së specializuar të arteve figurative.

Dhe ja si ndodhi: Atë ditë ndodhesha në Peshkopi, ndoshta në ndonjë seminar nga ata që organizonte shpesh kabineti pedagogjik. Po haja darkë te "Turizmi". Më afrohet në tavolinë, dhe pa më marrë leje, një burrë , moshën e të cilit nuk mund ta përcaktoje dot, me trup mbi mesatar, i zeshkët, i bëshëm dhe me flokë të shpupurishura. Këtë skenë që po zhvillohej në tavolinën time e ndiqte me kujdes kamerier Ceni, nja nga kamerierët më të famshëm dhe me emër, jo vetëm në Dibër por edhe më tej. Më afrohet dhe më thotë ngadalë: "Jepi një dopio, se hik vetë ai!" Ashtu dhe bëra... Me të porsaardhurin rishtas në tavolinën time, i cili nuk ishte askush tjetër, veç piktori Bajram Mata. Nuk mund të bisedohej, ndoshta, nga që unë nuk e njihja dhe dëgjuar më parë. Nga befasia, nuk i krijova atmosferë të tillë që të mund të futej në bisedë. Më vonë mësova se ishte shumë i muhabetit, sidomos për pikturën, të cilën e njihte mirë dhe teorikisht, por dhe për letërsinë. Mësova se kishte një familje të shkëlqyer, të cilën e ka përshkruar shumë bukur, me të gjitha dritë - hijet që mund të ketë një familje artistësh, shkrimtarja Sadie Agolli, në një tregim të gjatë, gati një novelëz, të botuar pas vdekjes së piktorit, në revistën "NËNTORI".

...Isha transferuar nga Ostreni, zonë nga e cila kishte origjinën Bajram Mata, në Zalldardhë. Një ditë, aty nga ora 10, shoh të zbresin nga një autobus me shofer Bilalin, burrin e shkurtër me mustaqe , i cili e kishte të veten rrugën Peshkopi -Kukës, një turmë njerëzish. Më thirri dikush në emër dhe pashë se ishte piktori i njohur, Duro Karaibrahimi. Dukej i lodhur dhe një trishtim i kishte mbuluar fytyrën. Pa arritur që ta pyes, se për ku po udhëtonte, më thotë me një zë të pikëlluar:

-Po çojmë Bajramin në Kukës!

Atëhere vura re se, bashkë me autobusin, ishte dhe një "Zuk" i mbuluar me një mushama të dalë boje. Aty, në atë lloj automobili, që kur ecte të mbyste me tym, ishte në arkivol Bajram Mata!

-Po pse në Kukës?! -arrita t'i them Duros, me një zë ku dallohej keqardhja për një njeri të njohur dhe të talentuar.

-Aty ka vëllanë, - më thotë Duroja.

Kur autobusi me "Zukun" humbën në kthesat e Gjallicës mua se si m`u mblodh një lëmsh në fyt. Kështu mbaroi jeta e një piktori të talentuar. Dhe ishte vetëm 43 vjeç!

Kishte lindur në Lejçan të Gollobordës në vitin 1940. Dhe ngjarja që po rrëfej po ndodhte në vitin 1983!

Viti 2017 la pas gjurmë të pashlyeshme kujtese me arritjet fantastike në sport të djemve dhe vajzave tona të talentuar

Sportistët kampionë me origjinë dibrane

Nga **DEFRIM METHASANI**

Janë të shumtë sportistët, origjina e të cilëve i takon Dibrës, por në këtë shkrim, por sjell vetëm pesë prej tyre, ata më të suksesshmit, që kanë përfaqësuar ngjyrat e flamurit kombëtar në arenën ndërkombëtare edhe këtë vit.

Interesant është fakti, që sportistë të niveleve të tilla botërore nuk i takojnë vetëm futbollit, por edhe sporteve të tjera, si atletika, boksi, etj. Vërtet mburremi me emra të tillë, si: Armando Sadiku, Luiza Gega, Ferit Keta, Qazim Laçi apo Marko Alia. Ndoshta pakkush e din, që të gjithë këta emra kaq të afirmuar, janë në genin e tyre nga Dibra dhe fshatrat e saj, por që të gjithë përfaqësojnë Shqipërinë në ekipet tona kombëtare.

Si mund të ndihesh ndryshe, përveçse krenar, me golat e Sadikut në kombëtaren shqiptare të futbollit, medaljet e Luiza Gegës, fluturës kuq e zi të pistës, grushtet e fuqishme të përbindëshit në ring Ferit Keta , lojën virtuoze të mesfushorit të ekipit përfaqësues U-21 Qazim Laçi apo pritjet akrobatike të portierit të talentuar të të rinjve të Lacios dhe kombëtares së të rinjve të Shqipërisë, Marko Alia.

Për **Armando Sadikun**, shpeshherë rrjetet sociale kanë spekuluar, duke i vënë etiketime të zonave të ndryshme të Shqipërisë. Por e vërteta është krejt ndryshe, madje roli im si gazetar sportiv, më ka dërguar shpeshherë në shtëpinë e tij në Elbasan, atje ku vite më parë, familja është larguar nga fshati Trebisht për një jetë më të mirë, është sistemuar fillimisht në Vlorë e më pas në Elbasan. Babai i tij Durimi, flet me superlativa për origjinën e tij dhe fshatin e madh dhe të bukur të Trebishtit në zonën e Gollobordës. Goli i tij në finalet e Kampionatit Europian në qershor 2016 në Francë ka mbetur në kujtesën e të gjithëve, ashtu si 10 golat e tjerë në shërbim të kësaj skuadre që përfaqëson kombin. Sadiku ka shënuar edhe shtatë gola me Legia e Vrashavës, skuadrën që luan tashmë në kampionatin polak, duke qenë nga futbollistët më të lakuar të vitit 2017.

Po kaq e suksesshme është edhe **Luiza Gega**, atletja e shkëlqyer, e cila arriti të ngjitej deri në postin e nënkampiones së Europës një vit më parë, duke zënë vendin e dytë në Kampionatin Europian të Amsterdamit. Por garat e saj të 1500 dhe 3000 metrave janë elektrizuese dhe në fund mbështjellja me flamurin tonë kombëtar, dhuron një emocion të rrallë. Maratona ndërkombëtare e zhvilluar



Armando Sadiku



Luiza Gega

muajin tetor në Tiranë në 21 km, pati emrin e kësaj kampionie, e cila dhuron gjithnjë rezultate të bukura në sportin mbretëreshë. Luiza Gega është nga fshati Okshtun, por kur ishte vetëm 5 vjeç, familja e saj erdhi në periferi të Durrësit për një jetë më të mirë. Aktualisht Luiza Gega jeton në Tiranë dhe ka deklaruar se, nëse do të bëhet Rruga e Arbërit, do ta përshkojë me vrap...

Por a mund të harrohen këtë vit ndeshjet e boksit nga djaloshi kampion **Ferit Keta**?! Dy tituj kampion brenda vitit, shënojnë një sukses të jashtëzakonshëm të tij, si Kampion Europe muajin korrik në kikboks dhe duke u shpallur kampion Gjermanie në boksin profesionist në muajin nëntor po në Mynih. Të dyja ndeshjet që u transmetuan edhe në RTSH, dhuruan emocione të pafund, veçmas kur boksieri nga fshati Koçaj i Bulqizës, vendos qeleshen dhe flamurin, pasi vendos edhe gjerdanin e fituesit, ndërsa ndeshjet i ka fituar me nokaut. Për këtë ka një meritë të padiskutueshme edhe tri herë kampioni i Botës Ismail Keta dhe vëllai i tij, Gjetan Keta - tri herë kampion europe në boks.

Ndoshta jo në të tilla nivele, por një realitet i bukur ndërkombëtar është edhe futbollisti i talentuar **Qazim Laçi**, mesfushori i ekipit tonë përfaqësues U -21 që ka luajtur në Greqi dhe Qipro, ndërsa këtë sezon luan në Ajacio në ligën e dytë franceze. Në këtë kampionat ai ka shënuar tre gola dhe skuadra e tij është pretendente për ligën e parë të futbollit në Francë. Loja e tij vlerësohet për grintën, forcën e karakterit dhe luftën sportive. Ai vjen nga ekipet e moshave të





Qazim Laçi

> Janë pesë, por jam i bindur se emra të tjerë të shquar janë edhe në sporte apo shtete të tjera. Ndaj me këtë rast ne hapim edhe rubrikën më të re: "Sportistë të shquar me origjinë dibrane", ku do të botojmë gjatë vitit 2018 të gjitha arritjet e tyre.

Olimpiakosit në Athinë dhe është cilësuar si një prej shqiptareve më të talentuar në futbollin helen. Duke parë ndeshjet e tij me ekipin Shpresa, De Biazi, kur ishte trajner i kombëtares e kishte konsideruar këtë lojtar si të ardhmen e ekipit tonë kombëtar. Qazim Laçi është nga fshati Brest i Poshtëm në Kastriot dhe familja e tij ka emigruar pas viteve 90 –të në Greqi.

Marko Alia është emri më i ri në këtë prezantim të sportistëve me origjinë dibrane, por që janë të suksesshëm në arenën ndërkombëtare. Ai këtë vit, është shpallur edhe si portieri më i mirë i moshës në zonën e veriut në Itali. Ai luan me të rinjtë e Lacios dhe pas Strakoshës, është emri i dyte më premtues në portën e kësaj skuadre. Falë meritave të tilla ai është ofruar në kombëtaren e moshës U-17, ku Shqipëria fitoi edhe një turne ndërkombëtar në pranverën e këtij viti në Romë. Marko Alia është me origjinë nga fshati Fushë-Alie në Dibër, por prindërit e tij kanë emigruar pas viteve 90-të nga Dibra në Itali.

Këta janë disa prej atyre sportistëve të famshëm dhe të shquar, që edhe në vitin 2017 lanë pas gjurmë kujtese dhe rezultate fantastike në arenën ndërkombëtare. Janë pesë, por jam i bindur se emra të tjerë të shquar janë edhe në sporte apo shtete të tjera. Ndaj me këtë rast ne hapim edhe rubrikën më të re: "Sportistë të shquar me origjinë dibrane", ku do të botojmë gjatë vitit 2018 të gjitha arritjet e tyre.

Dibra, si në të gjitha fushat e jetës, edhe në sport ka genin e saj, emrat dhe kontributin e madh të saj. Urojmë dhe shpresojmë që edhe viti që vjen 2018, të afirmojë të tillë emra të suksesshëm, duke ngritur akoma më lart vendin e origjinës sonë, Dibrës, me të cilën mburremi gjithnjë.

cyan magenta yelloë black



www.rrugaearberit.com

Na ndiqni *online*, falë ndihmës së z. Agim Deva, të cilin e falenderojmë për ndihmën dhe përkushtimin.

Informacioni për faqen online: **info@rrugaearberit.com**

Informacioni për versionin e printuar: **rrugaearberit@gmail.com**

Përdor KONTAKT PAGE për pyetje dhe sygjerime.

Shtyp butonin **"NDIHMO EDHE TI"** që gjendet në faqen e parë në versionin online për tu abonuar dhe kontribuar në botimin e gazetës, ose kontakto me redaksinë. Çdo kontribut bëhet publik.

Çdo lloje kontributi shkon në masën 100% në llogarinë e gazetës në Tiranë/Shqiperi në mënyrë të sigurtë përmes PayPal.

Ky website është një kontribut në shërbim të botimit të gazetës "Rruga e Arbërit", lobimit për ndërtimin e rrugës me të njëjtin emër, që do lidhë Tiranën me pjesën tjetër të Ballkanit në Lindje të Shqipërisë, si dhe zhvillimin e Dibrës dhe krahinave përreth.



Më e mira e Dibrës në Tiranë...

Rr.Nacionale Dajt, Surrel,
1005 Surrel, Tiranë, Albania
Cel: **068 400 0449**



Çmime shumë të mira për tirazhe 20-100 kopje

printime dixhitale

me ngjyra dhe bardh e zi

shpejtësi | cilësi | çmime të favorshme

libra | broshura | revista | fletëpalosje

katalogë | kalendarë | postera | ftesa etj.

duke filluar nga 1 kopje e vetme

për informacion: mbbotime@gmail.com / Cel. 069 20 68 603

Kritikë letrare rreth vëllimit me poezi "Dy pëllëmbë qiell" të poetit Islam Çenga

Atdheu jam unë

Nga **Sakip CAMI**

Lexova me nje frymë vëllimin e pestë poetik të poetit Islam Çenga. Kemi nevojë të lexojmëpoezi të tillë që tingëllon ëmbël, një poezi njerëzore me taban kombëtar e dashuri universale.

Islamin e njoh dhe e kam lexuar që herët. Ai ka shkruar që në gjimnaz dhe ka botuar në faqet e shtypit lokal e në gazetën "Zëri i Rinisë". Më pas e vazhdoi rrugën e poezisë në Universitetin e Shkodrës. Pastaj ishte poezia ajo që nuk e lëshonte atë. Në qytetin e Bulqizës një grup shokësh krijues rrinim së bashku unë, Islami, Hajriu, Simoni, Halili, Xhelili, Azemi etj dhe diskutonim për artin dhe letërsinë. Në qytetin e ftohtë minator funksiononte një kinoklub letrar ku bëheshin konkurse letraro-artistike, viheshin në skenë drama, bëheshin festivale e jepeshin koncerte.

Pra Islami nuk është poet i rastësishëm. Ai është një poet që i përket sojit të poetëve. Kush nuk e ka lexuar, të paktën ta lexojë tani. Ai ka shkruar pesë vëllime dhe nuk është hallakatur në gjini të tjera të letërsisë.

Në kopertinën e librit nuk ka asgjë të kërkuar por të bie në sy portreti i poetit me fytyrën rrumbullake e engjëllore, me ballin e gjërë dhe sytë e menduar, pikturuar me dashuri nga një shok i tij, piktori Zaim Elezi.

Libri hapet me poezinë me titull:"Përëndeshës" që kuptohet lehtë që ja kushton gruas së tij, një poezi brilante që do të dëshiroja ta citoja të plotë:

Ti je përëndeshë e bukurisë/Ta kam thënë mot për mot/Po ta them edhe sot/Dy fëmijë si drita më ke falur/ Pleqërinë ka kohë që ma ke ndalur/ Shkurt, më dhe ato që desha/ Ç'mund të bëjë më tepër përëndesha ?!

Poezia e I.Çengës është poezi e dalë nga shpirti, poezi komunikuese me qiellin dhe me retë, me natyrën dhe me njerëzit, me vendlindjen dhe me gjithçka që e rrethon.

Në poezinë "Njerëzit e qytetit tim" shkruan: " Kur pragun shkel, qyteti im/ Më bëhet sy, më bëhet frymë, fëmijë më bëhet/ Dhe lojë... dhe gunë/ Dhe nuk më lë të plakem asnjë ditë/ Asnjë thinjë të më shtohet në gunë/ Le të jetë janar apo gusht/ Le të jetë e hënë apo e shtunë.

Por mbiemrin e poezisë së Islam Çengës e mban poezia: " I lindur jam në fshat" . Ai deklaron me dinjitet:" Kam lindur në fshat/ Në odën e poshtme me dritare nga jugu/ Kërthizën ma preu nëna Mude/ Dhe e hodhi gjithë bekime në përroin e fshatit/ Përroi i fshatit e përcolli në Drin/ E drini në det/ Atje kërthiza ime e kriposur ende fle në djepin e perlave/ Dhe në shilarsen e valëve ende luhatet/ Në odën e poshtme për së pari kam qarë/ E më thirrën me emrin mysliman të gjyshit/ Dhe gjyshi emrin e gjyshit të tij kishte marrë... A ka më bukur se sa ky pohim, se sa kjo thirrje për vazhdimësi të popullit e të kombit ?!

Një nga poezitë e vëllimit mban titullin:"Atdheu jam unë" dhe kjo është kredoja e poetit. Unë do të dëshiroja që ta shkruaja të plotë për lexuesin. Iu afrova Atdheut / E qënia u shëndrrua në Myzeqe/ E kryet në Korab/ E sytë në Jon/ E mollëzat Zagori'/ E krahët Çamëri/E shtati në Kosovë/ E balli në Ulqin/ E malli Trebeshinë/ E ëndrra në Janinë/ E fjala në Moravë/ Ë zëri në Strugë/ e Dashuria në Bunë/ ... Si skifter fluturova drejt qiellit blu/ E që atëherë / Atdheu jam unë.

Poezitë kushtuar fëmijëve të tij, bashkëshortes, babait dhe nënës janë pa dyshim poezitë më të arrira të vëllimit sepse janë poezi të ndiera, pa sforcim, por me ndjenjë. Kështu mund të përmendim poezitë "Babait, në pritje të 90 vjetorit të lindjes", "Nëna", "për ty", "mbulomë me frymën tënde", "Më thotë vajza", "Duke pritur të bëhem baba", "Dikur e shkruar për gjyshin", "Bisedë me tim bir" etj. NëpoezinëNëna" poeti shkruan:" Dhe dielli, hëna, deti, lumi, stinët/ Dhe burimi, gjethi, vala, shpirti, zemra/Mirësia e dashuria/ Si ti e mira/ S'kanë fjalë...

Një vend të veçantë në këtë vëllim zenë edhe pejsazhet e natyrës dhe të stinëve të vitit. Këto pejsazhe do t'i kishte zili edhe piktori mëi mirë, ndërsa lexuesi futet në përfytyrim dhe mediton në ditët e pranverës dhe të vjeshtës.Në poezinë "Trill në fillim vjeshte" poeti shkruan: "Prish gardhin e verës vjeshta/ Si hamshor hingëllon në luginë/Në male dimri kërcet dhëmbët/ Gjyshja nga sepeti nxjerr sarginë/Blirët e qytetit lëshojnë gjethet/ I fshin fshesarja pa përtim/ Por lëri, e dashur, në çast, këto gjethe/Tokës së dashur t'i bëhen qylim//

Poezia fillon me një metaforë të bukur "prish gardhin e verës vjeshta" dhe vijon me një krahasim" Si hamshor hingëllon në luginë" e përsëri vijon me një metaforë tjetër "në male dimri kërcet dhëmbët" dhe poezia mbyllet me



thirrjen e përzemërt qytetare që poeti i bën fshesares:"Por lëri, e dashur, në çast këto gjethe tokës së dashur t'i bëhen qilim". Nuk ka më bukur.

Nëkëtë vëllim ka edhe poezi përkushtuese që poeti ua fal shokëve të tij, piktorit Z.Elezi, ushtarakut A.Prençi, nxënësit të tij, kompozitorit P.Tomçini me të cilin është rritur etj. Por Islami nuk shkruan poezi përkushtuese për deputetë apo ministra e aq më tepër për presidentë e kryeministra, por vetëm për njerëzit e thjeshtë e të mirë. Në nokturnin numër 6, kushtuar kompozitorit Tomçini lexuesi sjell ndër mend tërë këngët epike dhe lirike dibrane të kompozitorit Tomçini me tekst të N.Plakut, ato këngë që siç thotë poeti, kompozitori i mblodhi në piano dhe tastierë e bëri shpirtin. Përsëri me një metaforë të bukur mbyllet ky nokturn nga më të bukurit. Dhe metafora, krahasimi, shembëlltyra e pejsazhi e përshkojnë poezinë e tij fillim e mbarim. Dhe kur lexon poezi të tillë, sot në këtë dyndje të madhe poetësh e poezish pa tharm, mrekullohesh dhe natyrshëm e bën pyetjen:"Kur do të vlerësohen poetët e vërtetë?!"

Një vend të rëndësishëm në këtë vëllim zë cikli dhe poezia bazë e tij "Vdekatari". Poeti jep mesazhin e rëndësishëm për kohën se jemi të vdekshëm të gjithë, të pasur dhe të varfër, njerëz të thjeshtë apo ministra, prandaj vini gishtin kokës. Çdo gjë paguhet në këtë botë. Bëni mirë që të gjeni mirë. Do të sugjeroja që ky vëllim poetik t'u shpërndahej deputetëve të pozitës dhe të opozitës, ministrave dhe pushtetarëve, bisnesmenëve dhe të pasurve. E di që nuk e lexojnë, por ndoshta në ndonjë moment pauze e lexojnë ndër rreshta:" Jam vdekatar. Mirësinë e dua/ Dhe dashurinë e kam të shtrenjtë/E dashur, a s'më thua/ Se ç'shteg për mua qenka i drejtë?/ Ti më thua se filani është i zoti/ Se ka ngjitur goxha të përpjetë /Por unë vdekatar paskam qëlluar/ Dhe ndershmërinë e kam të shenjtë/....Ç'qëllova unë ... e ç'ë pastaj !?/Le të ishte ndonjë tjetër? Një hajn, mashtrues, vrasës me nam/ President, ministra apo Mbretër!/

Një kujdes i veçantë nga autori , nga redaktori N. Zoto dhe nga botimet M & B është bërë për gjuhën letrare dhe për pasurimin e saj. Në vëllim nuk gjen fjalë të huaja të huazuara e të kërkuara. Ndonjë krahinizëm është futur për të zbukuruar gjuhën dhe për të bërë dallimin se autori është nga një vend i bukur i Shqipërisë, rrëzëKorabit dhe buzë Drinit, se është rritur nën hijen dhe me aromën e blirëve të qytetit më të bukur verilindor, Peshkopisë.

Fatkeqësisht kritika letrare nuk është më institucion si dikur, por mendoj se ky libër duhet të jetë objekt i saj në të ardhmen.

Islam Cenga është një **"istikam"** në poezinë shqipe!

Sapo u ktheva nga Minneapolis, ku për rreth 20 ditë isha mysafir i ish drejtorit të gazetës "Studenti i Bujqësisë" dhe mikut tim të mirë, Shefqet Meko. Ai më kërkoi diçka nga Shqipëria dhe unë mendova t'i dërgoj këtë buqetë me poezi të poetit, mësuesit tim Islam Çenga, i sigurt që do të kishte në dorë një copëz Shqipëri. Ndërkohë që me Shefqetin bëmë një udhëtim shumë të gjatë me makinë në zemër të Amerikës, jo rrallë dëgjonte komunikimin tim me ish mësuesin dhe mikun tim, i cili kishte një problem shëndetësorë në atë kohë. Sot gjej rastin të sjell impresionin e parë të Shefqet Mekos për këtë libër që merr rrugën e botimit...

Ahmet Prençi

I dashur Met!

Kam mbushur një gotë nga uiski që ti nuk e shijove fare kur ndodheshe këtu, dhe si një meze-pashoqe po "përtyp" babëzitshëm vargjet e Profesorit tënd dhe po aq edhe i imi! (Dy maçokët e mi po kacafyten dhe unë u bërtas dhe ata ikin në dhomën bosh, ku për disa net të paharrueshme ishte dhoma jote...)

Tani po kuptoj saktësisht kur çdo mëngjes, kur zgjoheshim hoteleve të atij turi mbresëlënës, thoshe dhe pyesje: "Si do jetë profesori?!" Tani që një nga një si cironka Poradeci përtyp vargjet magjike, sikur vij dhe unë e ju gjej aty... Te Dibra e Madhe apo tek e Vogla, s'ka rëndësi, ju sërish jeni aty pranë e pranë njëri-tjetrit! Por unë jam kaq larg! Në këtë ikje të largët, në këtë ikje të kërkuar, duket se profesori ka gdhendur vargje edhe për mua!...

Jam elektrizuar në faqet e para! Dhe pyes: Ku ka qenë ky "Lasgush dibran" deri dje?! Nuk di, edhe pse sapo kam kaluar një moment shokues nën këtë "qiell kaq të madh", poezitë sikur më platitin një moment të trazuar, që shyqyr Zotit nuk ishte fatal....

Mësuesi yt, që ti ke pasur fat, por po aq fatlum është edhe ai poet që rrethohet nga bota juaj mirënjohëse, duke përfshirë edhe diplomatin! Tani shoh se sa mjeshtërisht ke "vjedhur" nga mësuesi yt! Islam Cenga është një "istikam" në poezinë shqipe! Ndihem fajtor që nuk munda ta njoh dhe nuk munda të isha qoftë edhe në një poezi botues dhe redaktor tek "gazeta më e vogël" ku unë isha "më i madhi". Poezia për qiellin, për qytetin, për kostumet, për babain, për "ikanakët" apo ajo "kërthiza e kripur në oqean" të shokojnë ...

Po ne, pse rrojmë kur nuk "qëndisim" një poezi të tillë?! Po ato "cironkat" që sjellin erën deri në Minneapolis?! Jam i dehur nga era e cironkave të vendit tim, që aq bukur i përshkruan poeti.

Vijoj t'i lexoj, por nuk munda të heshtja dhe po dërgoj "reagimin e parë", para se "presidiumi t'i mbyllë diskutimet"... Këto janë poezi perla dhe besoj se autori ka zënë vend në podiumin e meritуar, me kostum ose pa kostum!

Faleminderit që ndave këtë buqetë shpirtërore me mua! Uroj shëndet të plotë për Profesorin e mikut tim!

Të përqafoj mik, miqësisht,
Shefqet Meko,
Minneapolis USA

TATËPJETË

Po zbres.
Arrita në majë e po zbres tani teposhtë
ku më thyhen gjunjët.
I trembem zemrës dhe e shtrëngoj si zog në grusht.
I trembem diellit që djeg si prush.

Një lëndinë,
një lis,
një lule kukureku,
një shelg,
një lumë.
Më duken ambulanca
në teposhtën e ngushtë.

Po zbres
e pres të bëhem fëmijë
që ka frikë prej lugatit...

recensë

Proza e Bucit nuk u ndahet vlerave. Ato mbeten të shenjta, konkurruese e, mbi të gjitha, njerëzore.

Dritë jete - *një libër nga Mevlud Buci*

Nga **QAZIM SHEHU**

Mevlud Buci,poet,publicist,analis,fabulist,gjurmues i pareshtur i shpirtit kolektiv popullor përmes fjalës së mençur,autor i 25 librave të zhanreve dhe fuqive estetike në rritje,vjen së fundmi me librin e ri,të strukturuar dhe konturuar në kapituj të ndryshëm,duke marrë në fokus,njerëz,vlera,të cilat ,duhet thënë, në mendjen dhe penën e tij, gjejnë një rrezatim të ri.Kjo së pari,sepse pena e Bucit zhdërvjellohet dhe lëviz në këtë zhdërvjelltësi përmes intonimit të sinqertë,duke u ndalur në bukuritë e shpirtit njerëzor,bukuri që gjendet më së shumti në rrjedhat e thjeshta të jetës njerëzore ,jo tek postet ministrore.

Shumë here, ky autor,me satirën e tij ka stigmatizuar elitën politike të korruptuar,përmes vargjeve plot nerv e të qëlluara.Kujtojmë vargjet:Ju nuk e njihni politikanin Sadush,ai kërcen si gështenja në prush";ose:Celulari i deputetit,porsi varka në mes të detit" e të tjera fabula dhe poezi satirike plot nerv e patos kundërshtues të së keqes.Duhet thënë se kur vjen puna për të folur për njerëzit e thjeshtë ose për të evidentuarar atë të thjeshtën, satira e tij tërhiqet dhe vendin ia lë lirizmit ,shpirtbutësisë,respektit dhe dashurisë për vlerën që gjendet tek njerëzit e thjeshtë,punëtorët,mjekët,intelektualët,te k ata që çdo ditë përpiqen të gjejnë dhe të tejçojnë ato tipare që mbartin e rrezatojnë mirësi,besnikëri,humanizëm,të vërtetën,larg shtirjes dhe manipulimit,larg kapardisjes dhe tamtameve idioteske që gjenden me shumicë tek elitat e korruptuara shqiptare.

Mevlud Buci e sendërton frymëzimin e tij në fjalë të rrokshme dhe të shkruara me nervin e përkushtimit dhe dashurisë njerëzore,pikërisht për këta njerëz,të cilët ndër dekada,mote, dhe në rrjedhën e një kohe të heshtur, e kanë gdhendur profilin e tyre,larg zhurmave mediatike dhe qasjeve reklamuese,po puna e tyre është e madhe,sepse ajo është bazamenti i vërtetë i kombit,shoqërisë,është e qëndrueshme ,sepse në të gjendet mundi dhe sakrifica në përkushtim të jetës,të njerëzve,duke ruajtur dashurinë për dijen ,respektin për të parët,duke kërkuar shtigje të reja të naltësimit të vetvetes në kohrat e shkuara ato që janë e do të vijnë. Kështu ai do të evidentojë doktorKurt Kurtin nga familja Kurti e Xibrit të Matit,një personaitet i dashur për njerëzit,pinjoll i një familje me emër,po edhe me tetë pjesëtarë të kësaj familje që ndoqën dijen e mjekësisë dhe u bënë njerëz të nevojshëm për komunitetin. Evidentimi i vlerave të këtij mjeku është një çast i këndshëm ku lexuesi ndalet të mendojë për gjithë figurat e atyre mjekëve të nderuar që bënë"Betimin e Hipokratit" dhe rikthyen në jetë me mendjen dhe përkushtimin e tyre sa e sa jetë njerëzore.Duke shkruar për figurën e tij ,Buci u bën një nderim të gjithë mjekëve të përkushtuar të cilët, pa u legjendarizuar,krijuan aureolën e humanizmit në kohë të trazuara e më të qeta duke merituar dashurinë dhe mirënjohjen njerëzore.Buci si një hulumtues i shpirtit njerëzor,i vlerave të tij dhe i vlerave profesionale të njerëzve,si gjurmues i palodhur i tyre,e tejshtrin vështrimin,i jep gjeografi kombëtare,duke na sjellë njerëz të trevave të ndryshme me të cilët ai ka kontaktuar,ka folur dhe ka krijuar miqësi e afrimitet.Kështu spikat shkrimi për Hasan Buçpapajn nga Markaj i Krasniqes së Tropojës dhe vështrimi hidhet në Rrogozhinë,ku flitet për familjen Skuqi,një familje me emër në këtë trevë të Shqipërisë së Mesme.Si vizatues i palodhur i portretit të njerëzve ,vemë re se ai nuk i shikon ato vetëm në spikatjen e një njohjeje rastësore,as me qëllim- prezantimin e tyre përmes rastësisë,po si njerëz që vijnë nga një histori fisi,nga një suazë kohe ,që mbjellin personalitetin e vet në truallin e begatë të komunikimit dhe mirënjohjes njerëzore.



Kështu në libër do të ndeshim shkrime plot pathos dhe ndjenjë si për:Jashar Delishin që nderon Selishtën;Enver Kaloshin,martir të demokracisë,Latif Mihën ; për Osman ,Xhemal e Latif Mihën dhe djemtë,për për Kalorësin e Lirisë, Selim Brahjen e Saukut e dhjetra portrete të tjerë,të njohur e të panjohur,më shumë të panjohur,po që pena e Bucit i nxjerr në dritë me thjeshtësi dhe kreativitet.Gazetaria e sotme,një gazetari skupesh,ku një topmodele ka më rëndësi për shkak të ekspozesë së trupit sesa një vajzë e thjeshtë që punon në një fasoneri,e ka harruar pikërisht këtë vajzë të thjeshtë,shtypjen dhe shfrytëzimin mizor të saj ,kur paguhet fare pak.Në këtë mënyrë kjo lloj gazetarie që rend drejt tregut të parasë dhe fitimit,ia ka shitur shpirtin djallit dhe i shërben asgjësë.Buci na mëson se duhet ndalur tek këta njerëz,tek e vërteta që ata mbajnë në supe dhe kush është pikërisht kjo, ai mirë na e shpjegon duke na dhënë histori,episode,duke rreshtuar dhjetra e dhjetra emra ,të cilët renditen në kolektivitetin anonim të korit të jetës ,po që në penën e gazetarit marrin një profilizim ndryshe.Kjo lloj gazetarie shkëlqen nga thyerja e paragjykimeve dhe tabuve dhe i afrohet së vërtetës,asaj që zbret në kontaktet dhe vlerat njerëzore,vlera që dinë të çmohen vetëm nga bartësit e tyre ,dhe jo nga ata njerëz që tërhiqen nga vlerat e përkohshme të bujës dhe të vetreklamës bezdisëse.Në këtë kuptim ,Buci bëhet interpret i së thjeshtës ,i domosdosë që e tejshkon në fijet e një arsyetimi të natyrshëm,larg të menduarit steriotip, po duke krijuar të menduarit e vet.Kështu ,në aktin shkrimor, ai është i pangjashëm,jo vetëm se epitetet i gjen me shumicë dhe ato zbërthejnë në sinoniominë e tyre një dallgëzim të shpirtit dhe të afrimit,po se përmes tyre zbulohen detaje dhe të dhëna interesante.Kjo ,se Buci është gazetar me laps në dorë,po edhe i kontakteve të gjalla,kontakte që vijnë nga shkëmbimi i një cigareje,nga një ftesë,nga një fjalë e mençur apo një kujtesë e largët.Është impresionuese kjo,madje një tregues i qartë se gazetaria dhe publicistika e tij ngarkohet tejdukshëm dhe dukshëm me poetikën e jetës që buron nga karakteri dhe suksesi në jetë i protagonistëve. Vetë fakti që në libër gjejmë një shumësi emrash sa të rëndësishëm aq edhe dytësorë apo tretësorë,tregon se vëmendja e gazetarit nuk është kalimtare,përkundrazi ajo thellohet nga përkushtimi dhe dashamirësia për ta njohur njeriun,për ta mbajtur mend e për të mësuar prej tij.

Si krijues aktiv,punëtor i fjalës dhe kërkues i saj,hulumtues po edhe zbatues në kontekste

I dashuruar me vlerat njerëzore, përsërisim: jo ministrore, po edhe me vlerat e tabanit të lashtë, të shpirtit të popullit,(kujtojmë veprat e mëparshme: Fjalori Frazeologjik i Dibrës,sidomos), Buci zotëron një përgatitje në manovrën e fjalës që e bën origjinal,të kulluet,diskret dhe që dallohet nga tonaliteti i vibrimit bucian... Dhe kështu kemi një libër që shpalos një botë të tërë,krijon një mozaik tematik të ngrohtë,thellon dijet për jetën dhe frymëzon dashuri për njerëzit...

të gjera të tematikës dhe botëkrijimit,Buci nuk harron që fjalën ta rendisë në radhuan e një mendmi të hapur pa komplekse,dhe kjo është nga veçoritë origjinale të stilit të tij në aspektin vlerësues të stilit sipas frymës që përcjell.Aq shumë i afrohet personazhit rel ,sa çdo shkrim ai e shoqëron me një vjershë hyrëse që Buci e quan baladë,po baladës i merr vetëm fillesën e fjalës,(balare:vallëzoj) sepse ai duket sikur do të vallëzojë me imazhet e fjalës njeri.Poezia e tij përkushtuese i ngjet rapsodisë, po edhe një himni duke zbërthyer shpirtin e njeriut, vlerat e tij.Qenësia e vlerave duket se është kryetipar i kërkimit dhe rendjes ndaj tyre,dhe, sapo ato zbulohen ,Buci nxiton gjithnjë brenda temperamentit të stilit të tij shpërthyes që këto vlera t`i gdhendë shpejt e shpejt, sepse sikur do të na kumtojnë e ato nuk janë aq shumë se shumë e më shumë vlera kanë njerëzit e tjerë dhe ata që u ngjajnë atyre.Kështu ai krijon tipologjinë e ngjashmërisë së sojit njerëzor,një tipologji që gdhendet dhe skalitt mbi të,të mirën,të bukurën,mbi besën dhe përkushtimin,mbi gjithë atë traditë të vjetër që nuk mund të thuret e të kujtohet pa sjellë ndërmend njerëz të tjerë e të tjerë,dhe kështu duket se krijohet simfonia e shpirtit njerëzor,një uverturë e gjallë e këtij shpirti që kumbon në zemrat e bashkëkohësve dhe do kumbojë pafundësisht.Baladat e tij,po i quajmë të tilla ,nxjern në pah të mirën,të bukurën,atdheun fisin,kohën dhe kuptimin e saj ,portretin fizik dhe moral të protagonistëve,gjithë atë begati të njeriut që nuk mund të kuptohet ndryshe si e thjeshta dhe e vërteta.Kjo e tjheshtë dhe e vërtetë nuk do ishte ndonjë vlerë ,sikur do të na thotë Buci,nëse jeta nuk do sofistikohej kot së koti,pa pikën e kuptimit,nëse nuk do rrihej aty po të kalohej në krahun e panatyrshëm të mashtrimit dhe verbimit të të tjerëve përmes mashtrimit.Dhe sa herë vendoset pikërisht ky raport i përmbysur qëllimshëm,e thjeshta dhe e vërteta sillet si nevojë për të parë veten dhe për të ecur përpara,dhe kjo buron si një kumt nëntekstual në publicistikën e Bucit.

Proza e Bucit nuk u ndahet vlerave. Ato mbeten të shenjta, konkuruese e, mbi të gjitha, njerëzore. Zëri i studiuesit mbetet një trumbetë që gjëmon në këto kohë traumatike kur vlerat asgjësohen nga paraja,heshtja, indiferenca ,çorientimi i pamenduar dhe klithja e ekzistencës përmes të fiktit social.Ndaj poeti i ngjet një maratonomaku që rend e s`ndalet për qëmtimin e këtyre vlerave, vënien e tyre në spikamë.Ai këto vlera i heton që nga lashtësia e historia e mëvonët(për epikën budiane shkruan një poemë duke u ndalur tek Budi ,Gur i Bardhë e më pas në zemër të Arbrit).Për Hafiz Ibrahim Dalliun,fetarin,eruditin dhe atdhetarin e përkushtuar;për të ardhur në balada të tjera të bukura me rima buçitëse e ritme energjike,ku zëri i poetit gjëmon dhe derdh vrulle ndjenjash e mendimesh të zjarta e me pastërti shpirti.Shkruan baladë për Hidër e Hysen Mihën,Osman,Xhemal, Latif Miha dhe djemtë,për të cilësuarin prej tij: Kalorës të Skënderbeut ,Jusuf Selim Brahja,baba i të shquarit Selim Brahja, për miq e shokë,njerëz të thjeshtë e njerëz të artit.Edhe në balada ai nuk i ndahet fuqisë së tij portretizuese emancipuese.

Janë interesante reçensat e Mevlud Bucit për autorë ,dukuri apo qasje të ndryshme ndaj letërsisë.Si një kulturolog,njeri me një përvojë të gjatë në lëmë të kulturës dhe aktshkrimit,po më së shumit i dalluar për tiparin e tij pasionant në afrimin e pëlqimit ndaj krijimtarisë së shokëve,ai dallon nga ai zhgan letrarësh që zgjedhin heshtjen në vend të shqiptimit dhe prononcimit.Artikujt e tij kritikë ,dallohen për "bluarjen'e materialit,"copëzimin'e tij analitik dhe shoshitjen e informacionit,duke ia dhënë lexuesit vlerat e autorëve që Buci merr në konsideratë.Buci nuk është nga ata që nuk shikon traun tek vetja për të shikuar qimen tek të tjerët,përkundrzai ai poetët e tjerë i mirëpret dhe i '"pajis"me cilësi që ai mendon se i meritojnë,u jep çertifikatë mirënjohje nga që nuk e kanë marrë dot në gjendjen civile të egos.Kështu Bajram Canametin e quan Çajupin matjan,Hamdi Hysukën, Hajne të Matit,ndërsa Basir Bushkashin Esenin.Kjo vjen se ai mbështetet tek tipologjia e krijimtarisë së tyre,po edhe nga dëshira e dashuria ndaj krijuesve të zëshëm,që dallon dhe të prek për mungesën e egos,cilësi kjo e krijuesve të vërtetë.Dallojnë recensat për këta poetë,po edhe për librin e Shaqir Skarës"Dritëhijet e një poeti" që i kushtohet Bardit dhe poetit Naim Plaku,i cili ka shkruar tekste që janë bërë hite këngësh kombëtare.

I dashuruar me vlerat njerëzore,përsërisim: jo ministrore, po edhe me vlerat e tabanit të lashtë,të shpirtit të popullit,(kujtojmë veprat e mëparshme: Fjalori Frazeologjik i Dibrës,sidomos),Buci zotëron një përgatitje në manovrën e fjalës që e bën origjinal,të kulluet,diskret dhe që dallohet nga tonaliteti i vibrimit bucian.Kështu me të drejtë ndjejmë jo vetëm peshën drithëruese të fjalë përmes ndjesisë së saj,po edhe përhapjen rrezatuese të saj përmes forcës përshkruese dhe zgjeruese në përcaktimin e tablove që shpalosen nga një njohje dhe një kujdes regjistrues ndaj fakteve- detaje.Kuptohet ,se ai nuk shkruan exkatedra,po shkrimi i tij buron përmes palodhshmërisë për ta regjistruar shkruar e mbajtur mend fjalën e mençur,sepse fjala humbet vetëm nga mendjet indiferente,po kurrësesi nga pasionantët dhe dashamirësit e saj.Dhe kështu kemi një libër që shpalos një botë të tërë,krijon një mozaik tematik të ngrohtë,thellon dijet për jetën dhe frymëzon dashuri për njerëzit në këtë kohë të materializmit shterp.Personazhet realë,kanë qenë me fat që ndodhen në penën e Bucit,po edhe autori ka po të njëjtin fat, sepse prej tyre ka mundur të frymëzohet e të mësojë. Është një ndihmesë e ndërsjelltë,kurrësesi përjashtuese,po krejtësisht e motivuar si në një gjetje fati. Libridallohet pikërisht për këtë,po nuk mund të ndalet vetëm këtu.Ai ka pangjashmëritë tematike dhe shumësi arketipale që na sjellin parafytyra dhe sendërtime të këndshme,duke krijuar kështu një aureolë të shpirtit njerëzor dhe të lavdisë së tij përmes vlerash, por edhepërmes penës dinjitoze të një gazetari,shkrimtari,poeti,kulturolgu,studiuesi,gjurmuesi të palodhur,këmbëngulës dhe dinjitoz në paraqitjen e vlerave që vërtetë e meritojnë,po është pena e Bucit që këtë meritë e skalit me art e rrjedhshmëri të vrullshme e të hollë...

Reçensë mbi librin "Dibra nga Antikiteti në Monarki", të studiuesit Moisi Murra

recensë

Dibra nga Antikiteti në Monarki, një memuar historik **i shkruar me dashuri dhe përkushtim**

Nga prof. dr. **Adem Bunguri**

Në cilësine e redaktorit të librit, më duhet të them dy fjalë të përmbledhura për një vepër të rëndësishme historike, që sot e kemi në dorë, falë punës me përkushtim të autorit, kolegut tonë të nderuar z. Moisi Murra.

Që në periudhën gjeometrike të hershme II (800-750 para Kr.), të njohur edhe si koha homerike, kur lindi shkrimi (rreth 750 para Kr.), botimi i një libri ka qenë gjithnjë një ngjarje e gëzueshme dhe njëherësh e rëndësishme. E gëzueshme për faktin se pas një pune të gjatë, të mundimshme e shpesh herë rraskapitëse, autori ka arritur t'i paraqes lexuesit substratin e kërkimeve dhe përvojës së tij të gjatë në fushën përkatëse të studimit. E rëndësishme, pasi kjo eksperiencë e çmuar, që pak njerëz arrijnë ta fitojnë, memorizohet dhe u transmetohet brezave më të rinj në fushën përkatëse të dijes. Në këtë kontekst, mund të thuhet, se monografia e studiuesit të spikatur të historisë z. Moisi Murra *"Dibra nga Antikiteti në Monarki"* (Tiranë 2017), ia ka arritur plotësisht qëllimit. Pas një pune të gjatë e sistematike rreth 30 vjeçare, në terren, në arkiva dhe në kabinet, është sistemuar dhe klasifikuar një material i pasur dhe i larmishëm historik, me shtrirje kohore shumë të gjërë, i cili i serviret i gatshëm në tavolinë e të nxënit çdo studiuesi të Historisë së Dibrës në veçanti dhe të Shqipërisë në përgjithësi. Mund të thuhet pa frikë teprimi se ajo është vepra studimore më e rëndësishme e autorit, dhe si e tillë mund të quhet lirisht si vepra e jetës së tij. Me një dashuri të madhe për Dibrën dhe historinë e saj të ndritur, me një përkushtim të rrallë dhe skrupulozitet të veçantë, Moisi Murra ka arritur të paraqesë në mënyrë sintetike historinë e Dibrës përgjatë një periudhe shumë të gjatë kohore, mbi 2000 vjeçare, vepër që nga sot do të jetë në duar të çdo dibrani, kudo ku ai jeton, në Shqipëri, FYROM apo SHBA.

Prej më shumë se 35 vjetësh, Moisi Murra është përfshirë në radhën e studiuesëve serioz të Historisë së Dibrës dhe të Shqipërisë dhe është padyshim një nga përfaqësuesit më të spikatur të studiesëve dibranë të kësaj fushe.

Monografia është mjaft voluminoze dhe dëshmon për punën sistematike dhe pasionante të autorit. Me një vëllim prej 711 faqesh, dhe e paraprirë nga parafjala e autorit (11-13) monografia përbëhet nga 4 kapituj ose krerë kryesorë. Kreu I, i emërtuar "Dibra" (15-130), Kreu II, i emërtuar "Lufta e dibranëve kundër pushtimit osman 1444-1912" (132- 335), Kreu III, i emërtuar ""Luftrat e dibranëve kundër pushtuesëve serb, bullgarë dhe austro-hungarez, 1912-1921" (336-602); Kreu IV, i emërtuar "Të rënë në luftrat për liri e pavarëssi, 1844-1921" (603-650). Monografia është e pajisur gjithashtu nga "Kalendari Historik" (651-672), "Fotografi dibranësh të shquar "(673-675), "Fjalorthi mbi emërtimet arabo-osmane që ndeshen në Dibër" (676-678),"Bibliografia" (679-683), "Indeksi i emrave gjeografik" (684-710) për t'u përmbyllur me "Falenderim"-in e autorit për Sponsorët dhe kontribuesit e tjerë. (711).

Monografia e autorit Moisi Murra vjen pas dy botimeve të mëparshme historike mbi Dibrën: *"Lufta e Dibrës e vitit 1920"* (Tiranë 2002) shkruar nga Prof. dr. Bajram Xhafa dhe "*Historia e Dibrës*"(Tiranë 2012) shkruar nga Prof. K. Frashëri. Monografia që po promovojmë sot ka origjinalitetin dhe veçantitë e saj. Edhe pse në një fjalë të shkurtër prezantuese për një vepër të tillë voluminoze, është e vështirë të ceket e gjithë gama e optikës së gjërë të autorit, gjithësesi, qoftë edhe për të krijuar një mendim të përgjithshëm mbi këtë monografi, do të mjaftonte të përmendim shumë shkurt disa nga problemet kryesore të trajtuara sipas kapitujve.



Pas një pune të gjatë e sistematike rreth 30 vjeçare, në terren, në arkiva dhe në kabinet, është sistemuar dhe klasifikuar një material i pasur dhe i larmishëm historik, me shtrirje kohore shumë të gjërë, i cili i serviret i gatshëm në tavolinë e të nxënit çdo studiuesi të Historisë së Dibrës në veçanti dhe të Shqipërisë në përgjithësi. Mund të thuhet pa frikë teprimi se ajo është vepra studimore më e rëndësishme e autorit, dhe si e tillë mund të quhet lirisht si vepra e jetës së tij.

Kreu I, i emërtuar "Dibra" me një vëllim prej 115 faqesh (15-130) përbëhet nga 19 sythe, që merren me sqarime çështjesh të ndryshme, si pjesë e tërësores. Kapitulli fillon me përcaktimet gjeografike dhe hapsinore të Dibrës, merret me gjeografinë antike dhe trajton shkurt historinë antike të trevës. Çështjet më të rëndësishme që preken janë banorët penestë të Dibrës, lokalizimi i qyteteve peneste të Uskanës, Oaeneas, Draudakut dhe 14 qytezave peneste, etimiologjia e emrit "Dibër" etj. Të dhëna interesante paraqiten tek sythi "Oraniku-Shehëri i Dibrës"(22-29), ku përveç identifikimit të Oranikut me truallin e qytetit të vjetër të Dibrës, jepen edhe fiset që banonin Dibrën në vitin 1912 (sipas H. Sharofit).

Në sythin "Peshkopia"(30-32) autori mbështet pikëpamjen e shprehur edhe nga studiuesë të tjerë mbi etimiologjinë e emrit të qytetit nga episkopata e Stefaniakës dhe jepen njoftime të panjohura ose pak të njohura mbi zhvillimin e qytetit nga viti 1864, kur Peshkopia bëhet qendër e Kazasë së Dibrës së Poshtme, në vitin 1873 kur vendoset lidhja telefonike me qytetin e Dibrës, si dhe zhvillimi i saj në vitet 1912-1920, shumë pak ose aspak i njohur nga lexuesit etj.

Tek sythi "Albanopolisi i Ptolemeut-Jabllanica e Dibrës"(33-42) autori bën një diskurs të gjatë për të argumentuar hipotezën e propozuar nga V. Kurmaku dhe të mbrojtur nga M. Murra, mbi lokalizimin e këtij qyteti ilir në Jabllanicë, duke sjellë si argument edhe një stelë mbivarrore me mbishkrim të emrit "Albanopolis" në fshatin Gornje Sonje të Shkupit, të publikuar nga arkeologu N. Vuliç në vitin 1930, përkundrejt hipotezës së J. G.v. Hahn, K. Praschniker-A. Schober, S. Islami dhe E. Çabej, që këtë qytet e lokalizojnë në rrënojat e qytetit antik në Zgërdhesh të Krujës, në prapatokën e Dyrrahut.

Në sythin "Principatat e Dibrës"(43-64) trajtohen në mënyrë të përmbledhur tre principatat e trevës dibrane, përkatësisht, "Principata e Gopajve"(44-50), "Principata e Kastriotëve"(50-55), dhe "Principata e Moisiut të Dibrës (Moisi Golem Arianiti) (56-64). Në kreun I trajtohen gjithashtu çështjet "Organizimi administrativ dhe shoqëror i Dibrës në vitet 1431-1920"(65-78), "Emërtimet Dibër e Epërme-Dibër e Poshtme"(78-86), "Nandë Malet e Dibrës"(87-97) "Topalltia"(98-100), Oxhaqet e Dibrës: Hoxholli, Xhilaga, Hysenagolli, Karahasani" (101-114), "Bejlerët dhe agallarët e Dibrës"(115-122), dhe "Islamizimi i Dibrës"(122-130)

Kreu II, i emërtuar "Luftrat e dibranëve kundër pushtimit osman 1444-1912"(131-335) përbën një nga krerët kryesor të monografisë dhe përbëhet nga 30 sytha. Risi në këtë kapitull përbën përpjekja e autorit për lokalizimin dhe identifikimin e vendbetejave të Skënderbeut në Dibër. Kështu ritrajtohen me të dhëna të plotësuara "Beteja e Torviollit"(133-136), "Otoneta"(137), fortesa e Tornaçit(138-139), Fusha e Rrethasit (139-141) Sfetigradi (141-146), "Fusha e Talminares"(146-147), "Fusha e Meçadit (147-149), "Fusha e Valkalit (Valikardhës)"(149-153). Një vend të rëndësishëm zë trajtimi i çështjeve të tilla si "Kryengritjet popullore antiosmane në Dibër" (156-162), "Dibranët dhe Ali Pashë Tepelena"(162-166), Kryengritjet populore kundërsmane në Dibër 1833-1839"(167-173), "Lufta e Gjoricës 5-10 nëntor 1844, lufta kundër reformave të Tanzimatit" (174-197), "Salë Markja kundër Hysni Pashës-1855" (197-212), "Lufta e bulqizakëve-1860"(212-215), "Qëndresa dibrane në vitet 1866-1868" (216-218), "Lufta e Lam Dacit kundër Demir Pashës, 1872" (218-220), "Fshati Brest i Dibrës së Poshtme hyn në Nandë Malet e Dibrës", 1872" (220-22), "Dibra në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 1878-1881" (223-246) etj.

Një vëmendje e posaçme i kushtohet përpjekjeve të dibranëve për autonomi në sythet "Lëvizja e Dibranëve për autonomi, 1894-1889" (268-271), "Besëlidhja e Dibrës, shkurt 1889" (271-282), "Kongresi i Dibrës, 23-29 korrik 1909" (288-300) dhe luftës së tyre për shkëputje të plotë nga Turqia në sythet "Në prag të pavarësimit të Shqipërisë" (302-318) dhe "Kryengritja e përgjithshme kundërosmane e vitit 1912 në Dibër" (318-336), duke nxjerr në pah rolin e parisë feudale dibrane në këtë event të rëndësishëm të Historisë së Shqipërisë.

Kreu III, i emërtuar "Luftrat e dibranëve kundër pushtuesëve serb, bullgarë dhe austro-hungarez, 1912-1921" (336-602) përbëhet nga 19 sytha. Është një nga krerët kryesorë të monografisë, me trajtime që zënë 256 faqe ose 36.4 % të vëllimit të përgjithshëm të saj. Për problematikën e gjërë, luftën heroike të dibranëve, masakrat çnjerëzore të pushtuesëve serbë, kujtesën historike dhe rrjedhojat e kësaj lufte të pabarabrtë, kundër një pushtuesi të egër dhe sadist, ky kapitull merr të gjithë vëmendjen e autorit dhe të lexuesit.

Autori ka dhënë qartë që në sythin e parë *"Politika zyrtare serbe dhe operacionet ushtarake për aneksimin e viseve të Shqipërisë Verilindore"*(336-347) qëllimet strategjike të Serbisë dhe përkrahjen e saj nga Fuqitë e Mëdha të Europës në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (17.12.1912-12. 08. 1913). Pasi jepet programi shovinist serb i përmbledhur në "Naçertanian" e I. Garaśanin dhe planet e Serbisë për kufirin strategjik të tyre, "për dalje tokësore në Durrës dhe Adriatik" dhe në mos u arriftë kjo, atëhere "Serbia të shtrihet deri në Drinin e Zi", kërkesë e mbrojtur me forcë nga përfaqësuesi i Rusisë. Lidhur me çështjen e Shqipërisë, diplomacia europiane shfaqi haptazi orientimin e saj prosllav në Ballkan, përveç Austro-Hungarisë, që vazhdonte të mbështeste parimin etnik në caktimin e kufijve të shtetit shqiptar. Moisi Murra ka sjellë në vëmendjen e lexuesit dy projektet kryesore të kufijve të Shqipërisë, atë austro-hungarez, që ishte për një Shqipëri natyrale dhe atë rus, që përkrahte Serbinë, telegramet djallzore të Pashiçit dërguar E. Grey (28.11. 1912), apo komandantit të forcave serbe në Shkup(19.12.1912) si dhe deklaratën e kreut të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, E. Grey, ditën e mbylljes së punimeve të kësaj Konference (12 gusht 1913), e cila shpesh herë edhe harrohet: *"Unë e di fare mirë,se kur gjithçka do të bëhet e njohur, kjo zgjidhje në shumë pika do të jap shkas për kritika të forta nga kushdo që e njeh vendin dhe që e gjykon çështjen nga pikëpamja e ngushtë lokale. Duhet të mos harrojmë se gjatë përpjekjeve për të gjetur një zgjidhje të tillë, qëllimi kryesor ka qenë që të ruhet marrëveshja midis fuqive të mëdha dhe, në qoftëse vendimi mbi Shqipërinë e ka*

aktivitet

“Dibra nga Antikiteti në Monarki”, është një monografi që plotëson një boshllëk të ndjeshëm një njohjen më të mirë e më të plotë të historisë së ndritur të trevës tonë dhe renditet si një vepër e çmuar historike që na ka munguar.



Më datë 2 dhjetor 2017, shoqata “Gryka e Vogël” organizoi në Muzeun Historik Kombëtar promovimin e librit “Dibra nga Antikiteti në Monarki” të historianit Moisi Murra. Në këtë veprimtari, që u moderua me profesionalizëm nga Dr. Shpëtim Cami, folën prof.dr. Adem Bunguri dhe prof. dr. Bajram Xhafa, të cilët evidentuan jo vetëm vlerat historike dhe dokumentare të librit, por edhe rolin që ka luajtur kjo krahinë në historinë shqiptare.
Autori i librit, Moisi Murra, falenderoi pjesëmarrësit dhe organizatorët e kësaj veprimtarie dhe vuri në dukje edhe pjesë të tjera të kësaj historie pas periudhës së monarkisë, të cilat janë gati për botim, por kanë nevojë për mbështetjen financiare për botimin e tyre.
Në foto (nga e majta në të djathtë): Dr. Shpëtim Cami , Prof. dr. Edlira Haxhiymeri, Prof. dr. Bajram Xhafa, autori i librit Moisi Murra dhe Prof. dr. Adem Bunguri.

siguruar këtë, atëherë, ai ka bërë punën më të rëndësishme në dobi të paqes në Evropë”.

Të tradhëtuar nga Porta e Lartë dhe të ndodhur krejtësisht të vetëm dhe të zbuluar para agresionit të hordhive serbe, dibranët bënë një rezistencë të jashtëzakonshme gjatë luftrave ballkanike për mbrojtjen e tokave të të parëve, madje ata gjatë Kryengritjes së shtatorit 1913, i përzunë serbët deri përtej Shkupit dhe malit të Karadakut.

Një vemendje të veçantë, autori i kushton kontributit të dibranëve në luftrat mbrojtëse jashtë hapësirës dibrane. Kjo është trajtuar në sythet e mëposhtëm: “Dibranët në mbrojtje të Shkodrës dhe të Lezhës, 8 tetor 1912-25 prill 1913” (347-356) dëshmon kontributin e dibranëve në këtë luftë kundër pushtuesit serbo-malazezë. Me vërtetësi historike përshkruhet Beteja e Bërdicës, që është regjistruar si “beteja më e përgjakshme në luftimet për mbrojtjen e Shkodrës”. Në këtë betejë morën pjesë 2000 dibranë, të cilët zunë rob 276 serbë, 7 prej të cilëve oficerë. Gjatë gjithë luftimeve për mbrojtjen e Shkodrës, u vranë 300 dibranë, 120 prej të cilëve vetëm në Bërdicë dhe 40 të tjerë në Han të Hotit, ku edhe sot janë “Varret e Dibranëve”.

Ky kontribut është trajtuar edhe në sythet “Dibranët në mbrojtje të Lumës 14-17 nëntor 1912”(357-365), ku flitet për betejën e famshme të Kolesjanit, që autori me të drejtë e krahason me betejën e Termopileve, “Dibranët në mbrojtje të Manastirit, nëntor 1912” (365-369), “Lufta në Grykën e Radikës, dhjetor 1912” (370-375) etj.

Një vëmendje të veçantë autori i kushton kontributit të dibranëve në luftrat mbrojtëse jashtë hapësirës dibrane. Kjo është trajtuar në sythet e mëposhtëm: “Dibranët në mbrojtje të Shkodrës dhe të Lezhës, 8 tetor 1912-25 prill 1913” (347-356) dëshmon kontributin e dibranëve në këtë luftë kundër pushtuesit serbo-malazezë. Me vërtetësi historike përshkruhet Beteja e Bërdicës, që është regjistruar si “beteja më e përgjakshme në luftimet për mbrojtjen e Shkodrës”.

Një vend të veçantë zë trajtimi i sythit “Kryengritja antiserbe, shtator 1913” (386-411), një nga epopetë më heroike të dibranëve, dhe po ashtu edhe “Masakrat serbe të vitit 1913” (412-434).

Në këtë kapitull trajtohen edhe çështjet “Veprimtaria tradhtare e Arif Hiqimetit”(435-440), “Esat Pashë Toptani dhe dibranët “(441-456), “Lufta e Kaushit (Trojak), 2 dhjetor 1915” (456-4650, “Ndërhyrja ushtarake bullgare në Dibër gjatë Luftës së Parë Botërore” (465-473), “Koha e Nemces mos ardhtë kurrë”(474-483).

Vëmendje të veçantë autori i kushton edhe fazës finale të luftës me serbët në sythet “Ripushtimi serb i Dibrës dhe qëndresa dibrane 1918-1920” (484-493),”Kuvendi i Arrasit dhe kryengritja e përgjithshme kundërserbe, 15 giusht 1920” (494-532), “Lufta e Lan-Lurës, tetor-dhjetor 1921” (533-556).

Gjithashtu, ai është po kaq i vëmendshëm edhe përndriçimin e përpjekjeve të dibranëve gjatë Rilindjes Kombëtare për arsimin shqip, çështje e trajtuar në sythin “Lufta e dibranëve për shkolla e shkrim shqip 1878-1921” (557-585). Kapitulli mbyllet me përpjekjet e tyre për demokratizimin e vendit, të pasqyruara në sythet “Lufta e dibranëve për demokratizimin e vendit në vitet 1922-1925. Lëvizja e marsit 1922” (586-593) dhe “Dibranët në mbështetje dhe në mbrojtje të qeverisë sl Fan Nolit, qershor-dhjetor 1924” (593-602).

Kreu IV, i emërtuar “Të rënë në luftrat për liri e pavarësi, 1844-1921” (603-650) përbëhet nga 12 sytha. Në këtë kapitull bëhet një bilanc i dibranëve të rënë në luftrat mbrojtëse dhe të shpallur dëshmorë me vendim nr. 72, datë 23.05. 1988 të Këshillit Popullor të Rrethit Dibër. Numri i tyre është 388, të klasifikuar sipas periudhave në disa nëngrupe si p.sh “Të rënë në luftë kundër ushtrive osmane, 1844-1912(603-605 (58 dëshmorë), “Të rënë në luftë kundër ushtrive serbo-malazeze në Shkodër e Lezhë, 1912-1913” (605-606) (25 dëshmorë), “Të rënë në luftë kundër ushtrive serbe e greke në Manastir e Follorinë, 1912-1913 (606-607) (25 dëshmorë), “Të rënë në luftë kundër ushtrive serbe në Kolosian 1912” (607) (12 dëshmorë), “Të rënë në luftë kundër ushtrive serbe në kryengritjen e Grykës së Vogël” (608) (25 dëshmorë), “Të rënë në luftë kundër ushtrive serbe gjatë kryengritjes së shtatorit 1913 (609-612) (100 dëshmorë), “Luftëtarë të rënë dëshmorëtë atdheut gjatë viteve 1914-1917(612) (5 dëshmorë), “Të vrarë nga austro-hungarezët”(612-614) (73 dëshmorë), “Të rënë në luftë gjatë pushtimit bullgar, 1916 (615) (9 dëshmorë), “Të rënë në luftë ose të pushkatuar nga serbët 1915-1918” (615-616) (22 dëshmorë) dhe “Të rënë në luftë kundër ushtrive serbe 1920-1921” (616-617) (34 dëshmorë).

Me mjaft interes paraqitet sythi “Luftëtarë dhe udhëheqës të kryengritjeve popullore dibrane” (618-650), ku jepen CV e 54 udhëheqësve kryesorë dibranë të luftrave popullore, nga Iliaz Pashë Qoku (Dibra), deri tek Elez Isufi, Sufë Xhelili, Ibrahim Gjoçi e Dine Dema. Po kështu mjaft i vlefshëm është edhe “Kalendari Historik (shek. V para Kr-qershor 2009) (651-672), që i sjell të gjithëve në kujtesë momentet më të shënuara të historisë tonë, nga periudha antike deri në kohët moderne.

Monografia plotësohet edhe me fotografitë e 42 dibranëve të shquar, duke filluar nga rilindasit Seit Najdeni, Josif Bageri, Haxhi Vehbi Dibra e Nikollë Kaçorri, drejtuesit dhe luftëtarët e Luftës Nacional-Çlirimtare, Haxhi Lleshi, Ismail Strazimiri, Faik Shehu, Gjok Doçi, Dali Ndreu etj, shkrimtarët përparimtarë Haki Stërmilli dhe Haki Sharofi deri tek studiuesit Vahid Kurmaku, Munir Shehu, Lutfi Turkeshi dhe Hazis Ndreu etj.

Në mbyllje, duhet të themi, pa frikë teprimi, se me këtë monografi, autori ka shënuar disa arritje të rëndësishme për historinë e Dibrës.

• Autori ka meritën se e ka trajtuar Dibrën si një etnitet gjeo-hapsinor dhe etno-kulturor, pavarësisht ndarjes dhe masakrimit të saj nga Konferenca e Londrës e vitit 1913.

• Ai ka realizuar një porosi të moçme të çdo brezi që i zhvilloi luftrat e shumta për mbrojtjen e Dibrës. Me një gjetje interesante dhe të besueshme, ai na përcjell thirjen heroike të atyre që i bënë këto luftra mbrojtëse, të brezit të gjyshërve tanë, mbi nevojën për të shkruar, për t’i hedhur në letër dhe për t’i dëshmuar brezave më të rinj heroizmin masiv dibran në mbrojtje të Dibrës dhe jo vetëm. Porosia e babait të tij dhe të gjithë atyre që u përleshën me dushmanin, *”Biri im, shkruaj një libër për luftrat e dibranëve kundër pushtuesëve të huaj!”*, është një detyrim dhe një borxh moral që brezi më i ri i historianëve ka ndaj historisë. Nevoja për të shkruar dhe rishkruar historinë tonë me objektivitet shkencor, është një kërkesë jo vetëm e nevojshme por edhe e domosdoshme.

• Si idhtar i parimit latin *“verba volant, scripta manent”,* ai i beson dijet njerëzore nuk do të kishin vlerë në se ato nuk u transmetohen brezave më të rinj.

• Me këtë monografi, Dibra ka tashmë një memuar historik, të shkruar me dashuri dhe përkushtim, që i kushtohet historisë së vjetër dhe të re të Dibrës, me të cilën dibranët ndjehen më të plotësuar.

• Monografia përveç vlerave historike e kulturore ka edhe vlera të shumta patriotike e atdhetare, për edukimin e brezave të rinj, me vlerat më të mira të të parëve tanë, që më shumë se çdo gjë e deshën vendin dhe atdheun e tyre.

• Falë punës studimore të studiuesëve dibranë, përfshirë edhe kontributin e spikatur të z. Moisi Murra, në Historinë zyrtare të Shqipërisë, kohët e fundit janë korrigjuar disa pasaktësia.

• Njohës i shkëlqyer i terrenit, autori ka sjellë argumente të reja të pathëna më parë në mbrojtje të hipotezave të ngritura prej tij, siç është hipoteza mbi lokalizimin e Albanopolisit në Jabllanicë, hipoteza mbi lokalizimin e fushës së Torviollit në fushën e Kastriotit dhe të Volezës, ato mbi lokalizimin e disa vendbetejave të Skënderbeut në Dibër etj.

• Autori ka sjellë dëshmi të shumta arkivore dhe dokumentare, mbi pjesëmarrjen e dibranëve në luftrat mbrojtëse jo vetëm në Dibër, por në të gjitha krahinat e Shqipërisë natyrale. Kudo të shkosh në hapësirën e Shqipërisë etnike (Kalis, Kolosjan, Prizren, Zhurr, Dibër, Shkodër, Lezhë, Manastir, Ohër, Shkup, Karadak, Kotor, Nish), do të gjeshë varre dibranësh të rënë në luftrat mbrojtëse, madje edhe jashtë kësaj hapësire (Follorinë, Selanik, Bullgari).

• Monografia është e pajisur me një aparat të pasur shkencor, me dokumenta të shumta arkivore dhe literaturë të gjërë e të plotë, të pasqyruar në 1625 fussnota.

• Monografia është pajisur me aparat të pasur ilustrativ, fotografi, falsmile dokumentesh, skica, planimetri dhe portrete të dëshmorëve dhe heronjëve të luftës popullore, cilësia e të cilëve në ndonjë rast, mund të kishte qenë edhe më e mirë.

• Monografia është shkruar me gjuhë të pastër e të zgjedhur, duke shmangur fjalët e huaja, me stil të rrjedhshëm e të kuptueshëm, që përbën padyshim një nga vlerat e monografisë.

• Me informacionin e pasur dhe të larmishëm historik që sjell, me analizën dhe diskursin historik për ngjarje dhe luftra të rëndësishme çlirimtare, “*Dibra nga Antikiteti në Monarki”,* është një monografi që plotëson një boshllëk të ndjeshëm një njohjen më të mirë e më të plotë të historisë së ndritur të trevës tonë dhe renditet si një vepër e çmuar historike që na ka munguar.

Duke e përgëzuar përzemërsisht autorin për botimin e kësaj monografie, i urojmë kolegut dhe mikut tonë të hershëm dhe të vyer, shërim të shpejtë dhe shëndet të mirë, jetë të gjatë e të frytshme, në të mirë të tij dhe të familjes së tij dhe në të mirë të studimeve historike të Dibrës, që pret prej tij edhe studime të tjera komplekse e të thelluara, si monografia që po promovojmë sot. Ne shpresojmë të mblidhemi përsëri në promovimin e vëllimit të dytë të Historisë së Dibrës, që autori e ka në proçes, të titulluar “*Dibra nga Monarkia në Demokraci*”.

Halil Rama promovon librin
"NË PANTEONIN E VLERAVE"

Personalitete të letërsisë, artit e kulturës vlerësojnë librin e publicistit të njohur

Nga **Eduard DUKAJ**

Libri i Halil Ramës "Në panteonin e vlerave", i cili u promovua të premten më 22 Dhjetor 2017, në sallën e Akademisë së Shkencave, në praninë e qindra krijuesve, nga Tirana, Prishtina, Dibra e Kukësi, u vlerësua si një befasi në botimet e viteve të fundit. Gjatë prezantimit të një analize të mirëfilltë të këtij botimi, dr.Fejzulla Gjabri vlerësoi kontributin e këtij autori në pasurimin e letërsisë dokumentare. Kjo sipas tij për faktin se "Në panteonin e vlerave" është një libër racional, emocional, dokumentar, arkivor që sjell risi në fushën e gjerë të shkronjëshkrimit shqip.



Libri "Në panteonin e vlerave" është bazuar në një treshe magjike dhe mistike. Janë disa kapituj që të ngrejnë pak nga pak në një Panteon, që ti e sheh jo me një zili egërshane, por me një respekt të madh për ata që ai të vë përpara me të gjithë sfidat e suprizat e tyre. Është një libër që duhet të jetë në duart e gazetarëve më të rinj për të parë një përvojë mjaft të vyer ...

Ndërsa studjuesi Behar Gjoka, ndër personalitetet më në zë të kritikës sonë letrare, ndër tëtjera tha se H.Rama në këtë "Paneton" na rreshton vlera të shumta të qytetarisë dibrane dhe më gjerë, të asaj mbarëkombëtare.

Në këtë manifestim të gjerë kulturor, të moderuar me mjeshtri arstistike nga muzikologu, studjuesi e publicist i mirënjohur Shaqir Rexhvelaj, vëmendje të veçantë ngjalli fjala e gjeneralit 99-vjeçar, Rrahman Parllaku. Si një enciklopedi e gjallë dhe memorie historike e kombit, gjenerali legjendë në kufirin e dy kohëve që përballoi me stoicizëm luftën antifashiste dhe inkuizicionin në burgjet komuniste, vlerësoi karakterin objektiv në letërsinë e H.Ramës. "Gjatë 20 vite bashkëpunimi me Halilin, si kryeredaktor i gazetës "Veterani", të dy kemi mësuar shumë nga nëjri-tjetri: unë në të rrëfyerin e saktë të ngjarjeve e personazheve dhe ai në përshkrimin brilant të tyre. Dhe këtë e ka bërë jo vetëm me këtë libër, por dhe me 11 botime tjera, monografike në harkun kohor të dy dekadave të fundit",-theksoi gjeneral Parllaku.

Në këtë linjë e vlerësoi krijimtarinë e këtij autori edhe nënkryetari i Bashkisë Tiranë, piktori dhe kritiku i mirënjohur i artit, Abaz Hado. Ai u shpreh ndër të tjera për produktivitetin dhe cilësinë në krijimtarinë e H.Ramës, të shprehura këto edhe në përditshmërinë e tij si specialist në një Drejtori të rëndësishme të Bashkisë së Tiranës.

Mjaftë mbresëlënëse qe në këtë promovim fjala e poetit dhe prozatorit të shquar Shefki Karadaku.Duke përveçuar dy figurat emblematike, gjeneral Parllaku dhe Teodor Laço, si një nga personalitetet më në zë të letrave shqipe që janë në qendër të "Panteonit", z.Karadaku vlerësoi veçanërisht analizën letrare që autori H.Rama i bën krijimtarisë poetike të panjohur të Laços, të botuar për herë të parë para një viti në gazetën prestigjioze "NACIONAL", nën kujdesin e veçantë të kryeredaktorit të saj, poetit të talentuar Mujë Buçpapaj. Ndërkohë sipas z.Karadaku, me vlera të rralla në këtë botim është fletorja e rrallë e gjeneral Parllakut me shenimet per 96 librat që ai ka lexuar gjatë 17 viteve të vuajtjes së dënimit në burgjet e Burrelit e Tiranës

Pikërisht në këtë vështrim e vlerësoi librin "Në panteonin e vlerave" edhe prozatori Andon Andoni. Sipas tij, dimensioni i librit nuk mbetet thjeshtë në vlerësime të botimeve letrare të disa autorëve, por përmes tyre H.Rama ka nxjerrë vetë heronjtë: fillimisht nga vendlindja e tij, Muhurri i Dibrës, gjeneralët e Skëndërbeut, Nikollë e Dhimiër Berisha, (referuar romanit të Naim Berishës "Të jetosh në paqe") dhe më tej, bushatlinjtë e Shkodrës, Familjen Guxholli të Pogradecit, ish presidentin e vrarë në mënyrë misterioze, Omer Nishani, heroin dibran të rezistencës antifashiste Ahmet Cami, e dhjetra personazhe të tjera, të profilizuara mjeshtërisht "Në panteonin e vlerave".

Një përshëndetje të ngrohtë dhe miqësore bëri në këtë promovim edhe akademiku kosovar Zija Mulhaxha, njëherësh kryetar i Shoqatës të Veteranëve të LANÇ të Kosovës.

Dhe siç është shprehur redaktori Namik Selmani, Libri "Në panteonin e vlerave" është bazuar në një treshe magjike dhe mistike. Janë disa kapituj që të ngrejnë pak nga pak në një Panteon, që ti e sheh jo me një zili egërshane, por me një respekt të madh për ata që ai të vë përpara me të gjithë sfidat e suprizat e tyre. Është një libër që duhet të jetë në duart e gazetarëve më të rinj për të parë një përvojë mjaft të vyer profesionale të këtij gazetari mjaft profesionist.

Është një vlerë për historinë e Dibrës e atë kombëtare në tërësi, që mund të ushqente mjaft muze të saj, atë të luftës, të arsimit, të teatrit, të ushtrisë, të shkencës, etj.

Është një model i bukur gjuhësor, para të cilit mësuesët e gjuhës të shihnin modelin e mirë të shkrimit të gjuhës amtare.

Dhe këto nuk janë pak që edhe vetë libri, ashtu si personazhet e tij, të vihet në Panteonin e kulturës së shkruar shqiptare të viteve të fundit.

"Shpirti rri zgjuar"
i Astrit Gjunkshit

Nga **Çerçiz LOLOÇI**

Libri i dytë i Astrit Gjunkshit "Shpirti rri zgjuar", nën siglën e botimeve "Nacional" është vijim i përmbledhjes së parë poetike "Botët brenda shqirtit" publikuar një vit më parë. Megjithatë ky nuk është pikëtakimi i parë i autorit me librin, pasi ai ka sjellë në shqip një kolanë botimesh të rëndësishme si "Ajzenhaueri, ushtaraku, presidenti", "Kolin Pauell, udhëtimi im amerikan", "Sfidat e jetës" dhe "FBI, e kaluara e turbullt dhe ardhmja e pasigurt" apo botime të tjera në shqip dhe anglisht për integrimin, sigurinë dhe diplomacinë.



Motive që kanë qenë të pranishme në librin e parë janë rimarrë edhe në të dytin, por këtë herë ato vijnë më të shtjelluara artistikisht dhe me detaje që mbahen mend. Shpirti poetik i Gjunkshit shkon sa penelit të fjalës, vjeshtës së diellit, etydeve për Dibrën, Gjirokastrën e Durrësin, në krijimtarinë e Agollit dhe shtëpinë e Kadresë, ndërsa vjershëron portrete të aktorëve të mëdhenj të Teatrit Kombëtar si Sulejman Pitarka, Margarita Xhepa, Tinka Kurti, Robert Ndrenika apo shkruan për mësuesin Remzi Spahiun, regjizorin Xhelil Aliu, studiuesit Robert Bisha, etj

Përmbledhje e re poetike është konceptuar në pesë cikle ku spikasin "Pema e dashurisë", "Portret i pamundur", "Gravitet i atdheut" dhe "Puthja e jetës".

Cikli i dytë që përbën edhe pjesën më kryesore të librit me 20 poezi është një mozaik këndvështrimesh e gjetjesh për dashurinë që autori herë e sheh si energjia më e pastër, herë si të gdhendur përbrenda, si ujë burimi, si aromë dasme, si trazim flokësh. Akoma më tej brenda këtij cikli ravijëzohen të tjera pamje të dashurisë tek një buzëqeshje, frerët e pasionit, tingujt e zemrës, zanat e Dibrës apo puthja e nënës. Pikërisht poezia për nënën krijon atë atmosferë të ndarjes nga një njeri i afërt ku autori shprehet:

Vetëm një moment hezitoi i biri,
me të shoqen shpejt shkëmbeu një vështrim
e kjo s'hezitoi aspak, të vazhdojë e nxiti
nëna puthi në buzë të birin dhe sytë mbylli në amshim.

Cikli i tretë zgjerohet me të tjera motive ku spikasin krijimet poetike për një portret të pamundur, pemën e urrejtjes, stërnipat e Darvinit, e bukura me rroba grisur, besnikëria, mozaik miqsh apo dorashkat, gjiri i shoqërisë, zhgënjim, robër dhe pema e pasurisë.

Në ciklin e katër të titulluar "Graviteti i Atdheut" autori apelon për një bashkim mbarëshqiptar duke ruajtur traditat më të mira të qëndresës, mikpritjes, të referencave kombëtare. Këtu muza e poetit shkon sa te krahasimi mes Skënderbeut e Hamza Kastriotit, te shqiponja, te dy Dibrat që rrahin në një zemër, te arbëreshët, sfida e kufijve, urtësia popullore, identiteti, muzetë, flamurmbajtësit, etj.

Cikli i pestë i titulluar "Puthja e jetës" fokusohet në gjendje që kanë të bëjnë me jetën njerëzore dhe autori të fton të zbulosh të tjera emocione nëpërmjet dijes, të bukurës së thjeshtë, mësimet e jetës apo zgjidhja e dilemave.

Ashtu si në ciklet e mëparshëm edhe në këto krijime Gjunkshi bën përpjeke për të dhënë një mesazh, për të shpërndarë një kumt, për të reaguar ndaj veseve e ceneve njerëzore, por edhe për të gëzuar pas një udhëtimi, pas një kremtim fundviti apo pas ndodhi të tjera të zakonshme që marrin tjetër kuptim nën vargjet poetike.

Autori në parathënien e kësaj përmbledhje thotë se "Shpirti që rri zgjuar pulson në të gjithë librin. Ai pasqyron ndjeshmërinë time si qytetar dhe si krijues për tema që zenë një vend shumë të rëndësishëm në përceptimin për botën, për jetën, për shoqërinë në përgjithësi dhe për aktualitetin, në veçanti. Mesazhi që përpiqem të sjell qartë në çdo poezi është se jeta duhet përjetuar me gjithë shpirt, me gjithë dashurinë njerëzore për të mirën dhe virtutet, të cilat mund të fitojnë vetëm pëmes përpjekjeve të vazhdueshme për të ndryshuar veten, shoqërinë dhe botën në drejtim të progresit. Duke qenë thellësisht realist në përshkrimin poetik të subjektit, kam qëndruar larg pesimizmit, duke parë dritën në fund të tunelit edhe kur duket se ajo është shumë larg".

Astrit Gjunkshi shkruan ashtu siç e ndjen, siç e përjeton realitetin dhe pothuaj në të gjitha krijimet përpiqet të gjejë rimën duke ruajtur formën klasike të vjershërimit dhe duke mos u tunduar për të shkruar në mënyrë tjetër. Duke uruar botimet 'Nacional' të poetit të njohur Mujo Buçpapaj për botimin e përmbledhjes së dytë të autorit Astrit Gjunkshi shpresojmë që në të ardhmen të sjellë krijime akoma më të bukura dhe më mbresëlënëse.

(www.alb-spirit.com)

recensë

**Meditime për një hero të maleve të Dibrës
në 74 vjetorin e rënies**

Në gjurmë të historisë të Dibrës dhe Bulqizës

Prof. Asoc. Dr. **Bernard ZOTAJ**



Sakip Cami me librin "Ngjarje dhe figura të shquara historike të komunitetit të bashkisë së Bulqizës", ka shkruar se Dibra, në gjirin e vet ka mbështjellë me mjegullat e kohës ngjarje, bëma, si dhe njerëz të shquar që ende nxjerrin krye e dritësojnë me vlerat e tyre të rralla. Në këtë sfond shfaqet para syve Bulqiza, një vendbanim ky, i cili qëndron bri shkëmbinjve dhe maleve të Dibrës, si një pushkë e varur në krahët e lirisë e atdhedashurisë.

Nëpërmjet analizës së ngjarjeve historike të ndodhura në Dibër dhe Bulqizë, kjo është një histori e mirëfilltë, si dhe një përpjekje për t'u transmetuar brezave se jetojmë në këto troje ku ka luftuar Skënderbeu. Në në këto troje ku ka lindur, jetuar dhe kanë luftuar Zaharia Gropa dhe Vlladan Gjurica, prijësa të Skënderbeut, si dhe në këto troje e kala shekullore janë thyer hordhitë osmane të komanduara nga Hajredin Pasha. Autori ju bën një analizë këngëve sipas variantit të vjetër, ku për kangën kushtuar luftës kundër Hajredin Pashës, i ka bërë një përshkrim dhe analizë gjithë ngjarjes historike që ka lënë gjurmë në kujtesën popullore.

Nëpërmjët këngëve popullore të zonës së Dibrës dhe Bulqizës shpaloset qëndresa heroike e mbrojtjes së trojeve etnike shqiptare në shekuj. Nëpërmjet atdhetarve dhe patriotve, ata na vijnë si kreshnikë të Dibrës dhe Bulqizës.

Ndaj dhe udhëtimi historik në Bulqizë, natyrshëm rigjallëron këngët popullore me hapësirat e tyre homerike mbi supet e të cilave kalërojnë figura të mëdha të historisë. Autori në libër ka përmendur dhe shkruar për shumë fise dhe figura historike, të cilët të zbritur nga fshatrat e Zogjajt dhe Bllacës dhe vendosur në Dibër të Madhe, ku shquhen fiset Daci, Markja, Lleshi, Dema, Cami, Rusi etj., të cilët i kanë bërë nder dhe i kanë shtuar vlerat këtyre krahinave se ata kanë luftuar me pushkë, por dhe për dije, për shkollë dhe për dritën e diturisë.

Prijësat dibranë e bulqizakë bënë emër dhe shkruan histori duke qenë zot në trojet e tyre, duke ngelur legjendarë, e duke përcjellur nga brezi në brez, trimëritë, kuvendet, luftërat dhe këngët. Ata ishin legjendarë dhe si legjendarë ngelën në historinë e Dibrës dhe të Bulqizës. Prijësa dhe udhëheqës popullorë si Sheh Mustafa Zerqani, Sheh Fejzë Bulqiza, Hoxhë Hasan Moglica, Hoxhë Hazis Lila, Mehmet Duriçi etj., realizuan me intuitën e tyre, vizionin madhor se nuk ka fe pa atdhe, si dhe nuk ka atdhe pa gjuhën tonë të bukur shqipe.

Figura të fuqishme patriotike dhe atdhetare si Mersim Dema, Hazis Xheka, Dalip Karaj, Mehmet Duriçi, Feta e Dan Cami meritojnë vlerësim nga brezat, sepse të gjithë bashkë dhe veç e veç luftuan për çështjen kombëtare shqiptare.

Në kujtesën e Sakip Camit kanë mbetur të gjalla këngët dhe vajtimet për trimërinë e Hazis Demës dhe Kurt e Mete Demës nga Homeshi. Mustafa Jakimin nga Shtushaj autori e bie si një hero të vërtetë që lufton edhe me një këmbë dhe pse i plagosur. Nëpërmjet këngëve popullore vjen dhe Salë Markja, një udhëheqës i vërtetë popullor. Sali Aga siç e thëriste populli, me dy kulla një në Zogje dhe një në Bofmollë të Dibrës ishte një gur xhevahiri në gjerdanin e madh të historisë së bashku me Sali Demirin e Çidhnës. Nga kënga del roli organizator i Sheh Mustafës nga Zerqani, por njëkohësisht shfaqet gadishmëria e Llan Kaloshit nga Dibra e Poshtme për të luftuar së bashku me trimat e tij. Në mjaft beteja legjendare ka shembuj të mirëfilltë heroizmi dhe patriotizmi të shfaqur prej Ahmet Lokës nga Sopoti i Grykës së Madhe, si dhe të trimave Rizvan Alla dhe Fasli Malja, ku shquhen për luftë burrërore ballë për ballë me turqit.

Sakip Cami është një lis i ardhur prej maleve të Dibrës, i cili me fjalën e tij të urtë e fisnike, përherë ka mbjellë miqësi në jetën e Dibrës, Bulqizës dhe në Tiranë. Gjurmët e tij të çojnë në trimërinë dhe të fisnikërinë e Camajt, në gjithë Dibrën, për bëmat dhe përpjekjet e tyre do të mbeten shekullorë në kulturën shpirtërore dhe historinë shqiptare.

Sakip Cami përbën një vlerë intelektuale e njerëzore në Dibër dhe në Bulqizë, njeri me vullnet të hekurt, me përkushtim dhe me botë të pasur shpirtërore, ai e ka lartësuar emrin e tij, dhe është bërë shembull i njeriut të kohës.

Ndaj dhe libri është i gjetur dhe i ardhur në kohë, për të dëshmuar këtë histori të shkruar me gjak nga populli heroik i Dibrës dhe i Bulqizës në shekuj. Libri dhe historia brenda tij i bëjnë nder jo vetëm këtyre krahinave, por dhe historisë tonë kombëtare. Ai mendoj se do të jetë pjesë e historisë në veprimtarinë historike dhe patriotike të zonave të Dibrës dhe të Bulqizës, për një njohje më të detajuar për luftëtarët e lirisë dhe të pavarësisë.

Një bisedë me **Nin Rajtën** për **Gjokë Doçin**

Nga **Abdurahim ASHIKU**

Ai, Nin Rajta, shoku dhe miku im, nuk më ndahesh me letrat e tij, të shkruara me dorë e elektronike, edhe pse ishim njëmijë kilometra larg. Ka qenë ndër pak miq të mi që në momentet më të vështira të jetës sime më rrinte pranë, më shoqëronte mbrëmjeve nën kurorën e blirëve, Bulevardit të Blireve, pa u frikësuar se të nesërmen do ta pushonin nga puna duke i heq të vetmen kafshatë që rridhte nga paga mjerane e mësuesit.

Po përcjell bisedën me Të në një ditë të shënuar për shpirtin e tij poetik e atdhetar, bisedë që lidhej me 20 nëntorin 1943, rënien e birit të Lurës Gjokë Doçi në operacionin e dimrit 1943 në Symizë të Mallakastrës në një betejë të madhe kundër nazistëve gjermanë dhe shërbëtorëve të tij. Dhe një shkrim të tij botuar në gazetën lokale "Ushtima e maleve" më 24 nëntor 1984...

* * *

Në kohën që ti lexoje shkrimin tim unë lexoja tregimin tënd. Më ngjalle emocione ashtu siç më ngjalle mall e respekt një muaj më parë për shokun tonë MuharremSkana që iku i ri.

Po të dërgoj dy fotografi për Gjokë Doçin, një të vjetër që duhet ta kem bërë në vitet '70-të dhe një të vitit të kaluar. E para do t'i shkonte tregimit tënd. E dyta është simbol i një kujtese me gjithë mend për tu admiruar. Është fotografia e lapidarit të Gjokë Doçit në fshatin Symizë të Mallakastrës, aty ku ra më 20 nëntor 1943. Mallakastriotët, siç e sheh edhe në foto e kanë ruajtur të paprekur lapidarin, madje rreth e qark tij nuk e kanë punuar tokën duke e lënë atë të virgjër si në kohën kur ai ka derdhur atje gjakun. Për mua është nderi më i madh që i bëhet Gjokë Doçit. Nuk e di në se busti i tij është në këmbë në Fushë Lurë apo është rrëzuar.

Bashkë me fotografitë po të dërgoj edhe një libër me poezi të mbesës sime, libër që ta besoj ty për të bërë recenzencën duke u futur si pjesë e librit. Nuk e di në se i ke dhënë mësim Enkelejdës apo jo, Megjithatë bëj një meditim për të në parathënie. Librin nuk ia kam dërguar ende Bujarit.

Përshëndetje dhe gëzime.

A. Ashiku

3 janar 2011

* * *

Duro, faleminderit për urimin!

Me emocionoi fotoja e lapidarit të Gjoke Doçit ne Symizë, dhe interpretimi yt dinjitozpërngastrën e tokëslënë pa punuar, e cila flet aq shumë për mirënjohjen e atyre njerëzve karshi Gjokës, sepse të them tëdrejtënnjë deheroizem absurd dhe aspak i motivuar ka pushtuar mendjet tona.

Lidhur me Librin e mbesës, sot sapo e printova (pasi e kam me të lehtë ta lexoj nëletër). Me bëri përshtypje spontaniteti i ndjenjave të asaj vajze, i cili vjen tek lexuesi



deri diku si një produkt i naivitetit, brishtësisë apo nënvetëdijes së saj. Dhe duhet ta dish fort mirë Duro se poezia që gjeneron prej këtyre rrethanave është plot finesë, e bukur dhe mjaft domethënëse. Por për hir të sëvërtetës dhe raporteve që kemi bashkë mund të them se poezitë lypset qe t'i kalojë në dorë një redaktor mjaft i kujdesshëm, për të bërë një botim dinjitoz.

Të them të drejtën unë nuk kam gjendje të mirë shëndetësore, se do të merresha me shumëkënaqësi dhe me shumë përgjegjësi me poezinë e Enkeledes, sepse brenda poezive është libri i saj!!!

Ndërsa përsa i përketparathëniesunë e kam nisur dhe po punoj për të. Dhe do ta nis sapo ta përfundoj, në shenjë respekti ndaj jush dhe mbesës suaj.

Me mall,

Nini

* * *

NË BALLË TË SULMIT

Është e drejtë të thuash, se ndaj jetës së heronjve tanë, që ranë për atdhe, (me gjithë përpjekjet sado këmbëngulëse për të njohur ata); mbeteshin gjithnjë borxhlinj, jo vetëm për shtrirjen e veprimtarisë



revolucionare në kohë, por, kryesorja, dhënia sa më e plotë e tyre ku të spikasë karakteri i tyre i fortë i formuar me cilësitë dhe virtytet më të mira të popullit tonë. E tillë është edhe jeta e Heroit të Popullit Gjokë Doçi, malësorit jetim nga Lura që nuk mbeti jetim pasi nënë i doli PKSH (sot PPSH).

Si shumë njerëz të asaj kohe të shtresave të varfra që përfaqësuan revolucionin socialist për hir të së vërtetës të ardhmes, edhe Gjoka fillimet e veta revolucionare i ka në rininë e parë. Këtu një rol të rëndësishëm luajtën shokët e tij si VasilShanto, NazmiRushiti (Heronj të Popullit); si dhe Shkodra me atë mjedis ku zinte revolta e masës së thjeshtë kundër shtypjes dhe shfrytëzimit, kundër të huajit që kishte pushtuar vendin.

Në Shkodër, malësorin nga Lura e sollën për t'u përgatitur si klerik i ardhshëm. Ai, jo vetëm që braktisi rrugën e zgjedhur nga njerëzit e fesë me qëllime të ulëta demagogjike, por në kontakt në kontakt me literaturën komuniste e lartëson veten dhe, në mënyrë krejt të ndërgjegjshme, përcakton në jetën e tij pozicionin që do të zerë në anën e revolucionit popullor.

Djaloshi me fytyrë tërheqëse e sy të zgjuar, gjatë kohës së shkollës së mesme në Shkodër do të bjerë në sy për veprimtarinë e tij të pasur revolucionare. Në këtë kohë do të shkojë disa herë në Lurë, në vendlindjen e tij të dashur, ku dhe atje frymëzon malësorët.

Qëndrimi i Gjokës në Shkodër bëhet i pamundur, sepse bie në sy të armikut. Partia e transferon në Elbasan. Këtu nisi përsëri punën si marangoz, herë si mekanik, herë në punishten e pijeve freskuese dhe, krahas këtyre punëve, udhëheq njësitin gueril të qytetit. Aksionet kundër fashizmit pasojnë njëri tjetrin. Edhe në Elbasan ai gjen ndër shokët urrejtjen urrejtjen e madhe kundër fashizmit. Bashkë me Siri Kodrën (dëshmor) e shokë të tjerë udhëheq demonstratën e bukës.

Në vitin 1942 merr pjesë në çetën partizane të Dumresë. Fillimi i vitit të ardhshëm do të jetë një gëzim i veçantë për Heroin. Partia do ta pranojë në radhët e saj. Tani Gjoka nuk do të ishte më jetim. Për atë mendonte një nënë e madhe që do ta shoqëronte gjatë udhëve të jetës. Dhe këtë kujdes, që heroi kishte ndjerë edhe përpara Gjoka do t'ia shpërblente në përleshje dhëmb për dhëmb me fashistët.

Aksioni i shtatorit 1943, siç tregojnë shokët e tij të luftës, qe një fitore e thellë mbi fashistët. Gjoka udhëhoqi 25 partizanë të cilët u futën në qytet dhe goditën armikun. Nga ana e gjermanëve mbetën të vrarë mbi 80 forca.

Për trimërinë dhe aftësinë e tij, me krijimin e Brigadës së Parë Sulmuesi Gjoka u caktua si kuadër deri në komandant të batalionit të 4-t.

... 20 Nëntor 1943. Në një përpjekje të rreptë për jetë a vdekje në mbrojtje të brigadës që kalonte lumin Vjosa, bie Gjoka, për të mbetur përjetësisht i gjallë në zemrën e popullit. Se populli ka një vend të veçantë për ata që jetën ia kushtojnë atdheut.

Jeta e Gjokës!...me mjerim, por jo e shkurtër, e gjatë pa mbarim. E tillë është jeta e Heronjve. Ata në rrugën që nisi Partia ishin të parët dhe mbetën ngaherë të rinj, krenarë për brezat.

Ka vite që Lura çmallet me birin e saj të derdhur në bronc. Njerëz të moshave të ndryshme përkulen me nderim para bustit të tij në qendër të Lurës. Heroi me vështrim të tretur nga Nezhda sikur i grish për vigjilencë, për të qëndruar të patundur në llogoret e socializmit.

Nin Rajta

Ushtima e maleve, 24 nëntor 1984

Në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878-1881), lëvizjen më të madhe politike të shqiptarëve gjatë Rilindjes, Dibra përbënte epiqendrën e saj nga drejtoheshin sytë e dy skajeve të Shqipërisë: Toskërisë në jug dhe Gegërisë e Kosovës në veri, si në aspektin politik dhe në atë ushtarak.

Figura dibranësh - *pishtarë të Rilindjes:*

Nga Prof. dr. **Bajram XHAFA**

SAIT NAJDENI (HOXHË VOKA) (1864 – 1903) – NJË PISHËTAR I RILINDJES

Na mblodhi sot këtu në Tiranë me 7 qershor 2017 Shoqata "Bashkimi Dibran", me rastin e përvjetorit të krijimit të saj, për të nderuar kujtimin dhe veprën e disa prej rilindësve dibranë të brezit të dytë të periudhës së Rilindjes, që me veprimtarinë e tyre kombëtare rrezatuan në etapën e fundit të saj dhe, disa edhe në periudhën e Pavarësisë (1912-1939). Bëhet fjalë për Sahit Najdenin, Josif Bagerin, Jashar Erebarën, Hafiz Sherif Langun, Izet Dibrën (Shatku), Abdurrahman Dibrën, etj.

Në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878-1881), lëvizjen më të madhe politike të shqiptarëve gjatë Rilindjes, Dibra përbënte epiqendrën e saj nga drejtoheshin sytë e dy skajeve të Shqipërisë: Toskërisë në jug dhe Gegërisë e Kosovës në veri, si në aspektin politik dhe në atë ushtarak. Konsulli i Austrisë në Manastir August Kral i shkruante Vienës: "Sytë e gjithë shqiptarëve janë drejtuar nga Dibra, dhe në të vërtetë këtu gjendet pika e gravitetit të situatës së Shqipërisë". Mbase kjo është arsyeja pse këtu u ngul me tërë forcën thika e ftohtë e diplomacisë në Konferencën e Ambasadorëve për caktimin e kufijve në Londër më 1912-1913.

Nga veprimtarët e brezitë të dytë të Rilindjes, personaliteti më i përkushtuar për çështjen kombëtare, sidomos për shkollën shqipe, ai që me vetëdije të plotë u u flijua, u tret e u shkri si qiriri, në kuptimin e plotë të fjalës ishte dibrani **Sahit Islam Najdeni**. Lindi në Dibër të Madhe më 1864 (mbiemri Najdeni do të thotë "të gjetur", vendas, "autochthonous"), njohur ndryshe si Hoxhë Voka (Vokrri) i Dibrës. Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes (fillore, plotore - ruzhdije) prej së ciliës doli më 1882, në moshën 18 vjeçare. Studimet e larta teologjike i vazhdoi në Edërne, por pas një viti i vazhdoi në Stamboll. Këtu ra në kontakt me figura të shquara kombëtare si Naim e Sami Frashëri, Ismail Qemali e patriotë të tjerë.

Sapo mbaroi studimet më 1888, Saiti, me ca abetare që mori në Stambol, u kthye në Dibër me dëshirën e zjarrtë të hapë aty shkollën e parë shqipe. Në bodrumet e dyqaneve, të Xhamisë së re dhe në shtëpitë e fshehta të qytetit formoi grupet e nxënësve. Ndër nxënësit e parë përmenden Selim, Dalip, Ymer dhe Riza Rusi, Shaban Pepa, Daut e Hajredin Varvarica, Zenepe Çoku, Aziz Menzelxhiu, Vehbi Xhidri, Hasan Ballanca, Hafiz Sherif Palikuqi, Hafiz Muhameti, Sheh Latifi, Sefedin, Qazim e Hysni Najdeni, Razie Pregja[1] etj. Shkolla nuk mbet pa u zbuluar dhe Saiti largohet në Stamboll, shkruan Isamil Strazimiri në "Kujtime historike mbi lëvizjen kombëtare në qarkun e Dibrës". Nxënësit e parë të Hoxhë Vokës u bënë prisat e lëvizjes kombëtare.

Hapja e shkollave shqipe u bë obsesion për Hoxhë Vokën. Më 1893 Hoxha kthehet përsëri në Dibër për të hap shkolla shqipe. Në Gollobardë angazhoi Hoxhë Muglicën nga Okshtuni. Shkollat u hapën në Maqellarë, Homesh (1894), Dohoshisht, Brezhdan etj.

Sait Najdeni ishte iluminist dhe misionar i vërtetë e çështjes kombëtare. Bashkë me shokun e vet Ibrahim Mitrovica më 1895 niset me mision të veçantë në Stamboll dhe Edërne por aty u kapën nga policia dhe u futën në burg, ku u mbajtën 15 muaj. Menduan ta thyenin vullnetin e Hoxhës, por ai sapo doli nga burgu vazhdoi një aktivitet patriotik edhe më të madh. Atë e gjejmë në



Manastir, në Dibër, në Shkup, Mitrovicë etj. mes mëmëdhetarëve duke shpërndarë libra shqip e duke i nxitur të mësonin të shkruanin gjuhën kombëtare. Shkoi për t'u takuar edhe me patriotë të kolonive shqiptare në Rumani, Bullgari, Libi (Tripoli), në Itali (San Demetrio Korone), në Brindisi, Bari, Napoli e Romë.

Nga mundimet e shumta e sidomos nga qëndrimi në qelinë e gurtë, të ftohët e të lagësht të burgut, Saiti u sëmur rëndë nga tuberkulozi. Eshtë shumë prekëse biseda me të jatin i cili, kur e sheh ashtu të zbetë e të tharë dhe me gjunjë të këputur, e këshillon të heqë dorë dhe të kujdeset për shëndetin. "Shëndeti yt i keq po më tremb, i thotë i ati. Ty s'po due me të pa të vdekur para mejet. Prandaj dëshiroj të qetësohesh, të të kthehet fuqia e shëndeti...". Saiti iu përgjigj: "Sakrificat qi ke ba ti për mue nuk më përkasim mue por Shqipërisë, e cila ka nevojë për sakrificat e të gjithë kombit. Pushka, plumbi, burgu, litari e të tjera mundime s'janë gja për ne. Po shkon Shqipnia, babë, po shkon nderi i shqiptarit e shqiptari rrin në gjumë e s'e din se çështja qendron deri në këtë shkallë.. *Ç'vleftë ka jeta ime, kur asht tue vdekë i tanë një komb*!"[2] (nënvizimi im).

Sakrificat e vetëmohimi i tij për shkollën shqipe dhe çështjen shqiptare në përgjithësi ishte në kufijtë e shenjtërisë. Fenë e vuri në shërbim të kombit, të shkollës dhe shkrimit shqip. "Feja myslimane urdhëron dhe detyron çdo mysliman me dashtë atdheun" thoshte Hoxha Voka i Dibrës. "Shqehtë, bullgarët e grekët duen me e copëtue Shqipninë midis tyne" dhe "ne rrimë në gjumë" thotë Hoxha. Për këtë qëllim shkroi edhe librin "FE-RRËFENJËSEJA E MYSLIMANËVET", shtypur në Sofje, ndë Shtypëshkronjë Shqipe "MBROTHËSIA", 1900.

Në vitin 1900, bashkë me patriotë të tjerë, Sait Najdeni hapi për të tretën herë shkollën shqipe në qytetin e Dibrës së Madhe, siç ishin hapë në Prizren, në Gjakovë, në Pejë. Por edhe kësaj here ajo nuk pati jetë të gjatë. Sait Najdeni botoi në Sofje edhe një "Abetare e gjuhës shqipe" ndë të folë gegërisht", prej 16 faqesh (1900). Vokacioni kombëtar i Hoxhë Vokës përbën një elegji më vete.

Vdiq në qytetin e lindjes më 21 nëntor 1903 në moshën 39 vjeçare. Në çastet e fundit të jetës la amanet familjes: "Në vorrin tem mos më veni gurë deri sa të lirohet Shqipëria dhe kur të fitohet liria, më veni gurë, tue m'i shkrue shqip. Në këto gurë të ngrini edhe flamurin e kombit, të cilin unë për fat të keq s'un po e shof për së gjalli, po munde barem ta kem afër". Nuk mund të themi nëse duhet të dëshpërohemi që Hoxha i përkushtuar nuk e mbërriti ta shohë ditën e madhe të Flamurit apo të ndjehemi me shpirt të lehtësuar që nuk e pa thikën që iu ngul aq kriminalisht Dibrës së tij vetëm dhjetë vjet më pas (1913) duke e shkëputur nga trungu i shtetit shqiptar të sapo krijuar.

Sait Najdeni, ky pionier i arsimit kombëtar, mik dhe bashkëpunëtor i respektuar i vëllezërve Frashëri, i Ismail Qemalit, Rexhep pashë Matit, Dervish Himës, Hamdi Ohrit, Seremedin Seit Toptanit, Kristo Luarasit, Shahin Kolonjës, Josif Bagerit, P. N. Luarasit, Nikolla Naços e shumë patriotëve të tjerë shqiptarë, mbeti një figure e shquar, e dashur dhe e nderuar e gjithë kombit shqiptar. Po e mbyllim vetëm me fjalët e Nikolla Naços në "Shqiptari" të Bukureshtit. "Me të keqe të madhe mësuam vdekjen e atdhetarit tënë Said Dibranit një shqiptari të vërtetë , një të madhi ushtar të palodhur të Shqipërisë"[3]. Sait Najdeni - një jetë misionari kombëtar, një jetë martiri.

JOSIF BAGERI (1870 – 1914)

Kur Shqipëria ishte e plotë, e bashkuar, integrale, nën Perandorinë Osmane e në bashkëjetesë me të, shqiptarët ortodoksë të Dibrës dhe gjithë Shqipërisë Lindore (sot e quajtur Maqedoni Perëndimore) qanin e qesnin si të gjithë shqiptarët për Shqipërinë; njëlloj punonin e jetonin, gëzonin dhe mjeronin, luteshin, luftonin e vdisnin për Shqipërinë. Josif Bageri nga Nistrova e Rekës së Epërme (të Dibrës) ishte njëri nga këta. Si shumica e burrave të Rekës së Epërme shkoi për punë në Bullgari, në Sofje. Atje zuri malli për Nistrovën dhe Rekën, për Dibrën dhe Shqipërinë e tij, ndaj mësoi të shkruajë në gjuhën shqipe. Punonte si këpucëtar, por studioi si autodidakt sa, jo vetëm shkruante poezi e prozë në shqip, por edhe të drejtonte e botonte gazeta, ndonjë libër dhe bën pjesë edhe në shoqëri. U përfshi në veprimtarinë atdhetare shqiptare sa u bë një rilindas i shquar.

Më 1 janar 1993 ishte ndër themeluesit e shoqërisë shqiptare të Sofjes "Dëshira". Ishte propagandues dinjitoz dhe i flaktë i çështjes kombëtare shqiptare. Në shkrimet e tij në shtypin e kohës u bënte thirrje shqiptarëve për të njohur historinë e popullit të vet, për t'u bashkuar pa dallim feje dhe për të përballuar edhe me armë çdo synim shovinist. E shihte të gjallë rrezikun: Shqipëria rrezikohej në ekzistencën e saj.

Pati krijimtari letraro-artistike e publicistike me nota të theksuara atdhetare-politike. Në "Thirrjen" që u publikua në gazetën "Shpresa e Shqypnisë", që botonte vetë Bageri u drejtohej vëllezërve të vet shqiptarë duke vënë në dukje vuajtjet që kishin pësuar vëllezërit e tij shqiptarë nën robërinë osmane. U kujtonte Naum Veqilharxhin Vaso Pashën, Kostandin Kristoforidhin, vëllezërit Frashëri, Jani Vreton e sa e sa të tjerë që e "shndritën kombin tonë para Evropës në dituri e gjuhë të vet". Në vitet 1909-1911 drejtoi gazetën "Shqypja e Shqypnisë" ku u bënte jehonë luftave të çetës trime të Çerçiz Topullit. Botoi edhe një përmbledhje me poezi nën titullin "Kopësht malësori". Pati miqësi dhe korrespondencë me intelektualë rekas Anastas Albanski, Llazar Siljani e Thoma Sergji dhe me dibranët Sait Najdeni, Dervish Hima, Jashar Erebara etj.

Në vitin 1914 vjen në Durrës për të nxjerrë gazetën "Ushtima e Krujës", por nuk gjeti përkrahje. Trazirat që filluan më pas e dëshpëruan shumë e detyruan të kthehej prapë në mërgim, ku vdiq pa pak kohësh në varfëri të plotë në Prishtinë, duke lënë gruan dhe fëmijët. Vlerësuar me Urdhërin "Për veprimtari patriotike" klasi II, Tiranë, 25. 11. 1962.

Pas shkëputjes brutale të territoreve të Shqipërisë Lindore, shqiptarët ortodoksë të atyre viseve u përthithën me agresion etnik. Ortodoksët shqiptarë u bënë "homogjenë", u sllavizuan. Sot pas 100 vjetësh në Maqedoni nuk ka më Josif Bagera.

Dibra nxorri edhe shumë e shumë atdhetarë e luftëtarë të tjerë të dorës së parë për çështjen shqiptare, për kombin, për atdheun, për pavarësinë, për shtetësinë.

Rilindja kombëtare u mbyll me Pavarësinë, pavarësi që më shumë erdhi nga ultimatumi i rrufeshëm i ngjarjeve (shpreje e Hanato) kur dhe çështja shqiptare u shtrua për zgjidhje para Evropës dhe u vendos zyrtarisht në tryezat e diplomacisë së Fuqive. Nën zjarrin e Luftërave Ballkanike dhe të Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 1912-1913 doli me ngurrim e shtërzim shteti shqiptar.

Për kombin shqiptar ato qenë katastrofat më të mëdha në historinë e tyre 3000 vjeçare. Me një bilanc tragjik mbi një çerek milioni shqiptarë të vrarë e të masakruar nga një genocid i pashembullt deri në këtë kohë në historinë evropiane, të kryer nga ushtritë ballkanase në një luftë që shqiptarët as e kishin shpallur e as e kishin humbur dhe me një copëtim mizor nga Fuqitë e Mëdha duke ua dhënë trojet shqiptare armiqve të tyre historikë e kombëtar, shqiptarët do të përjetonin tragjedinë më të madhe historike e kombëtare. Pikërisht në këtë sfond historik u shpall edhe Pavarësia e Shqipërisë. Në vorbullën e këtij cikloni apokaliptik u pështjellua edhe fati i Dibrës.

Kur Serbia shtetërore dhe "jo shtetërore" (në kuadër të Aleancës Ballkanike) në tetor 1912 ndërmori agresionin ushtarak kundër Shqipërisë, për pushtimin dhe aneksimin e saj, Dibra e Madhe, alias Sheheri i Dibrës, qendra administrative krahinës, qendra e vetme qytetare, ekonomike, kulturore e shpirtërore, me famë në historinë e shqiptarëve, si e gjithë Shqipëria iu nënshtrua masakrave, gjenocidit dhe spastrimeve etnike. Krimeve të luftës iu bashkëshoqërua krimi politik i Fuqive të Mëdha evropiane, si projekte të hartuara me kohë, kur, pas copëtimit skandaloz, qyteti i Dibrës, n(d)ë kërthizë të Shqipërisë, truri dhe zemra e Dy Dibrave: Topalltisë dhe Malësisë dhe e gjithë vendit, "i*u muar Shqipërisë me vijën kufitare të vitit 1913, siç nxirret me thikë sythi një patateje*", shkruan Rouz Uajlder Lein (shkrimtare amerikane) në fillim të viteve 20 të shek. XX në librin "Majat e Shalës" ("Rilindja", Prishtinë, 1997, f. 185).

Nën zjarrin dhe hekurin e soldateskës serbe gjatë Luftës së Parë Ballkanike (tetor 1912-30 maj 1913 u bë shkulja e parë e dibranëve nga Dibra e tyre që, me djepet e leckat në krah morën rrugën e huhaxhirllëkut drejt Tiranës dhe viseve të tjera në brendësi të vendit. Brenda një dhjetëvjeçari Dibra u dogj edhe dy herë të tjera nga serbi: më 1915 dhe më 1818. Kjo e fundit zgjati deri në dhjetor 1921.

Në Tiranë dibranët, sheherlinjtë, jo "Tigrat e Dibrës", siç i quan Miss Durhami ato të maleve që mbeten me pushkë në krah, por sheherlinjtë e Dibrës, erdhën dhe u vendosën në mënyrë kompakte, më së shumti në atë që është e njohur si Rruga e Dibrës. U pritën mirë nga vendasit, tironsit, si vëllezër në fatkeqësi, nga familjet e mëdha duke filluar nga Toptanët, po ashtu nga njerëzit e

cyan magenta yelloë black

Një tjetër personalitet nga dora e dibranëve sheherlinj që kontribuan në shtetndërtimin dhe kombformimin e Shqipërisë është Izet Shatku (Dibra) (1877-1964).

Sahit Najdeni, Josif Bageri, Jashar Erebara, Hafiz Sherif Langu, Izet Dibra (Shatku)





thjeshtë. Në arealin e ri sheherlinjtë dibranë shpalosën një kulturë jetese me nivel të lartë, integritet, shembull qytetarie. Sheherlinjtë kishin çfarë të ofronin; vinin nga një qytet që mbante nofkën "Stambolli i Vogël". Ishin klas. Shpejt u integruan në hallet e Shqipërisë së pavarur. Pas 1912-s shqiptarët u vunë para detyrave të reja, atë të ngritjes së shtetit të pavarur.

Dibranët e Tiranës u bënë faktor i qenësishëm dhe shumë i rëndësishëm i këtij procesi historik të shtetndërtimit dhe kombformimit.. Dy nga përfaqësuesit e këtij komuniteti, elitë e kulturës dhe e formimit intelektual ishin përfaqësues të Dibrës në Kuvendin Kombëtar që shpalli Pavarësisë: **Haxhi Vehbi Dibra (Agolli)** dhe **Hafiz Sherif Langu** të cilët kryen shërbime shumë të vyera. I pari u shndërrua në shtyllë dhe ikonë për ngritjen e institucioneve të shtetit të ri shqiptar, pushtetit laik dhe fetar. Figura e tij është trajtuar gjërësisht. Hafiz Sherif Langu (1877-1956) mësimet e para i mori në qytetin e lindjes, Dibër. Shpejt u lidh me atdhetarët vendës Sait Najdeni, Kadri Fishta, Shaqir Daci etj. Merr pjesë në kuvendin e madh të Dibrës të 27 shkurtit 1899. Me shtysën e prindërve dhe të gjyshit Selim bej Rusi vazhdoi studimet për teologji në Stamboll. Mes rilindësve të shquar si Ibrahim Temo, Dervish Hima etj. atje Sherifi u afirmua më tej me idealin kombëtar. Mori pjesë në formimin në dhjetor 1908 të klubit "Bashkimi" të Dibrës sëbashku me pjesën më aktive të patriotëve dibranë: Kadri Fisha, Riza Rusi, Eqrem Cami, Ibrahim Xhidri, Abdullah Tërshana dhe Ibrahim Jegeni. Më 1910 të gjitha këto i shtypi me dajak Shevqet Dërguti i cili Sherifin e cilësoi "Prift latin". Me këmbënguljen e dibranëve, pasi u dha leje për shkollë shqipe, ata unanimisht caktuan Hafiz Sherifin si mësues. Në fund të qershorit 1912, sëbabashku me Eqrem Camin, Ismail Strazimirin, Tajar Tetovën Dan Camin, Sheh Sulën e Zerqanit etj morën pjesë në kryengritje. Për atdhetarizmin e tij të flaktë e të kultivuar, e delegojnë përfaqësues të tyre në Kuvendin e Vlorës.

Me okupimin serb te viseve të Dibrës dhe Elbasanit, niset nga Vlora me mision për të organizuar qëndresë, ku autoritetet serbe e arrestojnë. Me ndihmën e Aqif Pashës, në krye të një komisioni të përbërë nga Tajar Tetova, Haki Ismail Peqini, Ahmet Dakli ndërmerr disa herë misione për ngritjen e pushtetit lokal. Në këto misione bashkëpunoi me Dan Camin, Hoxhë Muglicën, Hoxhë Kurt Ballën etj. Nga fundi i vitit 1913 deri më 1917 kryen detyrën e kadiut (gjyqtarit) në viset e Dibrës që i mbeten Shqipërisë.

Në vitet 1920-39 jetoi në qytetin e Dibrës ku kreu detyrën e imamit dhe në disa raste, të kadiut. Më 1941 vjen në Tiranë, pak kohë si kryetar i komunitetit Mysliman shqiptar. Si nacionalist që aspiroi dhe punoi për Shqipërinë etnike, pas ardhjes së komunistëve në pushtet dënohet me 10 vjet burgim. Lirohet me 1950 dhe vdes në mars 1956.

Jashar Erebara (1875-1953), jeta e të cilit është mbushur me ngjarje tragjike, si vetë jeta e popullit dhe kombit tonë. U bë gazetar me emër, i shtyrë mbase jo aq nga talenti i lindur, sa nga dhimbja dhe zjarri i dashurisë për atdheun. Me origjinë nga Podujeva, lindur më 1875 (mbase në Mostar të Bosnjës, ku shërbente i ati, Sadik Fejzullahu, përfshirë nga vala e muhaxhirllëkut mysliman të Luftës e të Pasluftës së 1877-1878-s dhe përfundon në Dibër, ku së pari i vdes i ati, i përndjekur në male, më pas e ëma dhe e motra nga tuberkulozi të mbetura rrugëve të muhaxhirllëkut, së fundi vëllai, që humbi në kurbet drejt Turqisë e që nuk iu dëgjua më zëri, as emri. Fati e shpuri Jasharin, këtë fëmijë të mbetur midis katër rrugëve në familjen dibrane Erebara (të Sejfulla Erebarës), prej së cilës në shenjë respekti mbajti mbiemrin. Pastaj sa andej-këndej: nga Dibra në Manastir, nga Manastiri në Stamboll e më 1891 në Elbasan.

Formimin e parë shpirtëror e arsimor – kulturor, shpirtëror e politik e mori në Dibër. Pati për mësues Sait Najdenin në Dibër dhe Nikolla Naçon në Bukuresht, bashkënxënës Dervish Himën, Asdrenin, Kristo Luarasin dhe bashkëpunëtorë Ibrahim Temon e Jani Vreton. Më 1902, sëbashku me Ismail Qemalin, Dervish Himën merr pjesë në Kongresin e xhonturqve në Paris. Eshtë njëri nga firmatarët e kartës drejtuar Sulltanit për të drejtat e kombit shqiptar.

Veprimtar i shquar i Rilindjes Kombëtare, publicist, diplomat, burrë shteti i spikatur që e shtrin aktivitetin nga fundi i shek. XIX – gjysma e parë e shek. XX. Eshtë bashkautor i shumë protestave dhe thirrjeve drejtuar fuqive të mëdha për mbrojtjen e çështjes shqiptare. U ropat nëpër kryeqytetet e Evropës e të Ballkanit për 27 vjet me radhë, me bukë e pa bukë, me strehë e pa strehë, por i paepur. Vështirësitë ekonomike nuk qenë gjë përpara ndjekjeve, internimeve dhe burgosjeve. Vraponin veprimtarët shqiptarë nga njëri kryeqytet i Evropës në tjetrin për çështjen shqiptare, zëvendësonin njeri tjetrin. Kur qëllonte që politikanët e Evropës t'i takonin për së dyti veprimtarët shqiptarë, i pyesnin me habi: "akoma nuk ju kanë vrarë?".

Më 1902-1906 nxjerr në Beograd gazetën "Albania". Pas shpalljes së Hyrrietit (korrik 1908) dërgohet në Kumanovë ku krijoi Klubin shqiptar dhe hapi një shkollë në gjuhën shqipe. Më 1911-1912 është në Shkup, ku nxjerr gazetën "Shkupi", e para gazetë në gjuhën shqipe në trevat e Kosovës e të Shqipërisë Lindore. Më 1913 vjen në Vlorë, ku bën pjesë në administratën qeveritare. Më 1914 në Durrës dhe 1914-1915 në Vjenë ku bashkë me të tjerë boton organin "Biblioteka Zëri Shqipërisë". Ndiqet nga bullgarët dhe internohet 18 muaj në Karlovo. Ishte ndër themeluesit e Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës".

Pjesëmarrës në të gjitha ngjarjet që sollën Pavarësinë, ngritjen dhe konsolidimin e shtetit shqiptar duke filluar me Bukureshtin, Beogradin, Vjenën, Parisin, Sofjen, Shkupin, Vlorën e 1912-s, Durrësin e 1914-s, Tiranën e 1920-s e të 1924-s. Më në fund i ra "rehat" trupi por jo shpirti vetëm më 1925, kur Shqipëria "u la të jetojë". Nga viti 1923 u zgjodh vazhdimisht në organet ligjvënëse deri në 1939, vit pas të cilit, ashtu si Shqipëria, edhe jeta e tij mori tatëpjetën.

Patriotizmi i tij të mahnit për shkallën e sakrificave. Asdreni në një letër që i dërgonte, shkruante: Gjithmonë kur jam duke folur me një mik ose atdhetar për mundimet dhe përpjekjet e kohës kur luftonim për një rilindje të atdheut, kujtoj vazhdimisht edhe emrin tënd. Ndërsa Mihal Grameno i shkruante: "shërbimet që i ke sjellë kombit s'kanë shembull"I ra trupi rehat (por jo shpirti) vepëm me Triumfin e Legalitetit pas dhjetorit 1924, deri më 1939, ashtu se dhe vetë shtetit shqiptar kur e lanë të marrë frymë vetëm përkohësisht.

Një tjetër personalitet nga dora e dibranëve sheherlinj që kontribuan në shtetndërtimin dhe kombformimin e Shqipërisë është **Izet Shatku (Dibra) (1877-1964)**. Shkollimin e filloi në Shehër të Dibrës së Madhe, e vazhdoi në Manastir dhe e mbylli në Stamboll më 1898 për Drejtësi-Administratë. Filloi punën si jurist në dikasteret e Perandorisë, avokat publik, pastaj nënprefekt e prefekt në Soroviç e në Korana, guvernator rajoni në Allasonjë, Kërçovë dhe Çall për disa vite. Veprimtar i çështjes kombëtare shqiptare.

Agresioni ushtarak serb më 1912-1913 e shkuli edhe atë nga trualli dhe qyteti i tij historik. Për mallin e vendlindjes, krenarinë e qytetit e kujtimin e të afërmve të vrarë gjatë gjenocidit e "pastrimit" etnik, përdori emrin e qytetit të tij të dashur dhe të krahinë me histori krenare "Dibra" si llagap në ushtrimin e funksioneve politike, por edhe si një apelacion irredentist. U lidh me krahun nacionalist dhe mbështeti Kongresin e Lushnjës më 1920 dhe qeverinë që doli prej tij. Gjatë viteve 1920-1924 shërbeu si n/prefekt i Tiranës (me kompetencat e prefektit) dhe komisar i bashkisë Tiranë; prefekt i Durrësit dhe më pas i Beratit. Në zgjedhjet e dhjetorit 1923 për Asamblenë Kushtetuese zgjidhet si përfaqësues i prefekturës së Dibrës si asamblist. 1925-1926 prefekt i Elbasanit, 1927-1928 prefekt i Tiranës dhe njëkohësisht komisar i bashkisë Tiranë. Më 1928-1929, prefekt në prefekturën e Shkodrës dhe 1919-1930 kryetar bashkie në Shkodër. Nga qershori i vitit 1930-dhjetor 1932 ministër i Punëve Botore në qeverinë e Pandeli Evangjelit. Në zgjedhjet parlamentare 1932-1936 del deputet për qarkun e Elbasanit, kurse në zgjedhjet që pasuan, që qenë të fundit të shtetit kombëtar shqiptar të pavarur doli deputet për prefekturën Durrës-Tiranë.

Nga shtatori i vitit 1937 deri në prill 1939 ka qenë d rejtor i Departamentit për Emigracionin që merrej me kujdesin e sistemimin e shqiptarëve të ardhur nga trevat shqiptare të Kosovës, Malit të Zi, Shqipërisë Lindore e të Çamërisë, të Diasporës, për ngritjen e strehave e vendbanimev të reja për ta nga shteti shqiptar i Mbretërisë në zonat Fier, Lushnjë, Durrës, Tiranë etj. Sistemimi i muhaxhirëve shqiptarë të dëbuar nga trojet e tyre për shkak të politikës shoviniste të spastrimeve etnike të fqinjëve sllavo-grekë të Shqipërisë ishte një problem madhor me karakter politik kombëtar dhe humanitar.

Siç shihet nga kjo kurrikul, Izet Dibrës vazhdimisht i janë besuar detyra të larta e me përgjegjësi duke gëzuar kështu staturën e shtetarit në niveleve më të larta në administratën e kursyer e mjaft efiçente të shtetit të parë e të fundit (deri tani) kombëtar shqiptar. Gjithmonë në pikat kyçe të administratës kur po ngrihej shteti i parë i Shqipërisë së pavarur, shteti juridik në kuptimin e plotë të fjalë pa asnjë shtojcë e artificë ieologjike e propagandistike.

Ka qenë reformator i një sërë dikasteresh të administratës shqiptare me staf teknik të diplomuar në universitetet evropiane. Pjesëmarrës në të gjitha diskutimet e projektet për konstruktimin e Tiranës. Eshtë cilësuar si një ndër administratorët më të mirë në shtetin shqiptar të kohës kur Shqipëria me të vërtetë kishte ngritur një shtet.

Me vendim të këshillit bashkiak të Shkodrës, më 25 qershor 1930 shpallet "Qytetas nderi", për kontribute të veçanta në ndërtimin dhe imazhin publik të qytetit.

Me ardhjen e regjimit komunist Izeti dëbohet nga Tirana për në Shkodër dhe e gjithë pasuria e tij grabitet në mënyrën më të paskrupullt. Shkodra të nderoi me titull qytetas nderi, ndërsa diktatura i tha: tani shko atje (në Shkodër), si i internuar. Ndërroi jetë në vitin 1964.

Shkodër, 6 qershor 2017

Kumtim i mbajtur në veprimtarinë përkujtimore të Shoqatës "Bashkimi Dibran", të zhvilluar në Tiranë në"Hotel Tirana Internacional", (në Sallën e Konferencave) më 7 qershor 2017, me rastin e dekorimit nga ish-presidenti i Republikës së Shqipërisë z. Bujar Nishani me titujt e lartë "NDERI I KOMBIT" dhënë këtyre veprimtarëve të Rilindjes. Me atë rasat edhe shumë personaliteteve të tjerë, dibranë të Tiranës, iu dha titulli "Mjeshtër i Madh i Punës".

1. Dr. Mahmud Hysa, Dibra dhe etnokultura e saj II, Dibër, 1995, f. 274.
2. Sotir Temo, Lulzim Bilbili, Petrit Najdeni, "Said Najdeni (Hoxhë Voka)", Sh. B. "8 nëntori", 1980, f. 40, 41.
3. Po aty, f. 79.

Jeta e antikomunistit nga Reçi i Dibrës. Rezistenca ndaj Italisë fashiste në vitin 1939, rob lufte i gjermanëve në Kretë, ku u dënua tri herë me vdekje dhe një herë më burgim të përjetshëm dhe si mundi të fitonte lirinë; përballja me regjimin komunist të Tiranës...

ADEM GJURRA, *nacionalisti që u përball me fashistët,*

Nga **Mina HYSA**

Jeta e antikomunistit nga Reçi i Dibrës. Rezistenca ndaj Italisë fashiste në vitin 1939, rob lufte i gjermanëve në Kretë, ku u dënua tri herë me vdekje dhe një herë më burgim të përjetshëm dhe si mundi të fitonte lirinë; përballja me regjimin komunist të Tiranës si i desantuari i Komitetit "Shqipëria e Lirë", por që nuk ra në duart e tyre, edhe pse misioni ishte tradhtuar, si dhe vuajtjet në burgjet e Jugosllavisë deri në largimin në SHBA

Adem Gjurra lindi në vitin 1912 në Reç të Dibrës. Ishte i biri i Hysen (Shaban) Gjurrës e Zahide Vladit. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje, të mesmen e mbaroi me korrespondencë rreth vitit 1931 në Peshkopi. Shkollën e nënoficerëve (të ushtrisë) e mbaroi në vitin 1932, por për arsye të mungesës së buxhetit shtetëror s'pati vend për aspirantët e rinj për t'u veshur ushtarakë. Në janar të vitit 1933, Adem Gjurra u regjistrua në shkollën e nënoficerëve të Xhandarmërisë Mbretërore me rekomandim nga oficeri Zyber Lita. Pas disa muajsh shkolle në Durrës, më shumë se 30 studentë me rezultatet më të mira u dërguan me detyrë në Shkodër për ruajtjen e rendit dhe qetësisë. Aty vazhduan me mësime; teori e praktikë prej 18 muajsh, me shërbim dhe nën komandën e Xhaklin Martinit, drejtor. U diplomua me sukses, i shtati në klasë prej më shumë se 100 të diplomuarve. Fitoi të drejtën e nënoficerit të xhandarmërisë, por shteti sërish nuk kishte buxhet për rroga të gradave të reja. I bënë thirrje që të pranonte gradimin edhe rrogën si xhandar, por me detyrë të nënoficerit. Shumica refuzuan, kurse Adem Gjurra dhe rreth 30 të tjerë pranuan për të qenë në shërbim të shtetit. U dërguan nëpër rrethe të postëkomandave në të gjitha anët e Shqipërisë. Shërbeu në Malësinë e Shkodrës, Dibër, Lumë, Gjirokastër**,** Labëri, Dukagjin etj. Gradimet erdhën me radhë deri tek grada me e lartë, "Toger". Postet që ka mbajtur Adem Gjurra ishin: inspektor arkive në postrreth, inspektor arkiva postëkomanda, zv.post komandë, postëkomandant, post e rrethkomandant dhe komandant zone.

ROLI I ADEM GJURRËS NË PUSHTIMIN E ITALISË NË VITIN 1939

Në vitin 1939, kur Italia sulmoi Shqipërinë, Adem Gjurra e marshall Isuf Jashari me 40 xhandarë e rreth 200 civilë nga Luma e Dibra u nisën për në Tiranë. Arritën në Krujë natën dhe u takuan me kapiten Shukri Baftjarin dhe nën komandën e tij u nisën për në luftë. Pas pak orësh arritën në kala të Prezës, ku u takuan me major Çaush Bashën dhe kontingjentin e Akademisë së Burrelit.

Morën lajmin e keq se Mbreti u detyrua të linte vendin. Oficerë të lartë dhanë urdhra të Mbretit që të mos krijoheshin lëvizje pa marrë fjalë prej tij, se do të sigurohej ndihma ushtarake e materiale për kombin nga jashtë. Porosia ishte të organizoheshin fshehtas e të përgatitnin popullin për luftë sa të lajmëronte Mbreti. Adem Gjurra u kthye në vendlindje edhe thirri krerët e fiseve Reç, Dardhë, Lurë, Arraz, Arrën etj. dhe u konsultuan për veprimtari të mëtejshme. Ademi u takua me Muharrem Bajraktarin e me Cen Elezin e më vonë me kapiten ushtrie Qazim Lushën. Pas bisedës mes tyre, Ademi vazhdoi me krijimin e një rrjeti rezistence, pjesët e së cilës ishin shumë thellë e sekrete, por gjithmonë me marrëveshje me personat kryesorë të lartpërmendur. Siguruan ndihma e strehime, bukë, pak armë, morën informacion për aksionet e italianëve. Pritnin lajmin për ndihmë nga jashtë dhe rikthimin e Mbretit, por ai nuk erdhi. Ademi filloi një përgatitje. Meqë nuk mundi të duronte më gjendjen, filloi një propagandë se kishte çuar fjalë Mbreti të fillonin të dilnin në Greqi për të marrë ndihma për luftë. Ka pasur shpresë se do të gjenin ndihmë nga aleatët, nëse e kalonin kufirin.

IKJA NË GREQI, DËNIMI 3 HERË ME VDEKJE DHE 1 HERË BURG PËRJETË

Në nëntor të vitit 1940, Adem Gjurra u nis me 40 shokë, oficerë, nënoficerë, xhandarë e të tjerë nga vendi i takimit, Korça. E gjetën kufirin në "zjarr". U përplasën me forcat italiane e ca shqiptarë dhe pas një lufte të fortë e thyen frontin dhe u bashkuan me ushtrinë greke e disa aleatë. Grekët i trajtuan në fillim si heronj edhe u dhanë ushqim e veshmbathje. Pas dy ditësh u erdhi një grup nga Athina dhe i morën duke u thënë se do t'u



Adem Gjurra

siguronin kushte më të mira dhe të duhurat për rikthimin në Shqipëri. Ky rezultoi një mashtrim, pasi disa orë më vonë grekët i arrestuan dhe i dërguan në kamp si robër lufte në Kretë. Ata u tradhtuan. Në fund të qershorit të vitit 1941, gjermanët e pushtuan Kretën. Grekët ikën edhe e lanë Ademin dhe shokët në duart e gjermanëve. Ata, sa panë se kush ishin, se e morën në dorë dokumentacionin e kampit, i dërguan në Itali për gjyq ushtarak. Italia i dërgoi në Shqipëri. Në gjyq dolën me dënime tri herë me vdekje e një herë burg përjetë. Ata ishin Adem Gjura, Mustafa Imeri (Pukë), Idris Sadiki (Tropojë), Cerim Verediki (Korçë), Gaço Sotiri (Korçë), si udhëheqës të lëvizjes. I torturuan në burg, duke u përgatitur për t'i pushkatuar; çdo ditë i linin në këmbë tek porta e oborrit të pushkatimit duke pritur "radhën" e në mbrëmje i çonin prapë në birucë. Avokati shqiptar mendoi dhe sugjeroi të merrnin një avokat italian (një mik të rinisë së tij me lidhje të forta tek ushtarakët), por do t'u kushtonte shumë. Familjet e të burgosurve, mes tyre dhe Adem Gjurra, shitën tokë, pasuri dhe plotësuan vlerën rreth 1200 lira ari. U paguan oficerët e Lartë të Gjykatës dhe të burgosurit shpëtuan jetën, por me humbje të të drejtave civile.

KTHIMI NË REÇ, LUFTA PËR LIRINË E SHQIPËRISË DHE REFUZIMI I OFERTËS KOMUNISTE

Pasi i shpëtoi pushkatimit dhe burgimit përjetë, Adem Gjurra u kthye në vendlindje i sëmurë. Kur u përmirësua, doli në mal, u arratis. Luftoi kundër forcave gjermane në shumë beteja dhe sipas librit të shkruar për Cen Elezin, Ademi u dallua si luftëtar i zoti. Sipas Ademit, në luftë forcat komuniste iknin nëpër fshatra për të rritur vlerat e veta, duke bërë propagandë; i merrnin përsipër meritat, edhe nëse nuk ishin në front. Për këtë arsye Ademi i largoi disa që i ishin bashkuar grupit të tij. Ademi mori pjesë në shumë mbledhje të të arratisurve edhe në mbledhjen e Mukjes e dërguan si përfaqësues i grupeve të arratisurve të Dibrës e të Lumës. Në shtator të vitit 1944, forcat komuniste filluan një operacion të fortë në Lumë e në Dibër. Vdiqën shumë nacionalistë të mirë. Ademi pasi pa se kauza nacionaliste humbi, i shpërndau shokët edhe shkoi në shtëpi të vendoste çfarë do të bënte më tej. Rreth fundvitit i erdhi urdhri nga Tirana për të



Adem Gjurra me Milicen dhe kusheririn Shaban Gjurra

qenë pjesë e administratës së qeverisë së re. Dy oficerë e dy civilë erdhën me disa shokë në Reç dhe i dorëzuan urdhrin të paraqitej në Shkodër brenda 10 ditësh të merrte postin inspektor i Arsimit për Shqipërinë e Veriut. Ademi e dinte se çfarë njerëzish ishin ata dhe u tha se nuk pranonte, pasi ishte i lodhur nga lufta, arratisja, burgu dhe vuajtjet e shumta si dhe babai i kishte vdekur e i duhej të kujdesej për familjen. Kaluan ditët edhe ai nuk shkoi. Çuan disa komunistë të rrethit të Dibrës ta merrnin, por Ademi i largoi. I morën kushërinjtë e xhaxhallarët në hetuesi, por Adem Gjurra i liroi, se dheu e njihte edhe kishin respekt, po edhe mjaft frikë në atë kohë.

ADEMI NIS SULMIN NDAJ KOMUNISTËVE NË 1945-ËN DHE VUAJTJET E FAMILJES

Pas refuzimeve të njëpasnjëshme të Adem Gjurrës, iu lutën sërish duke i çuar njerëz nga Tirana duke i thënë në formë kërcënimi: "Je me ne apo kundra nesh?" Edhe në këtë rast Ademi gjeti si justifikim shëndetin dhe u kërkoi tre muaj afat të shihte punët se si i kishte. Këtë kohë Ademi e donte të përgatitej për një luftë të vërtetë. Në 1945-ën erdhi te Ademi për strehim Muharrem Bajraktari me një grup përafërsisht 50 veta, i përbërë nga të arratisurit nga Veriu, por edhe disa nga Kosova. Ademi ka pasur një mbështetje të fortë në vendlindje si dhe në zonën e tij. I strehoi dhe u siguroi bukë, veshmbathje e armë. Por një grup aq i madh nuk kaloi pa ra në sy, nga ata që ishin me qeverinë. Pasi i përcolli të strehuarit e Muharrem Bajraktarit, Ademi doli në mal me disa shokë dhe kushëririn e vet, Shaban Gjurrën. Komunistët e mbushën



Ademi ne Itali ne 1967

Reçin me ushtri e polici, ku pati edhe përplasje me armë, si beteja e Koziakut, por Adem Gjurrën nuk e kapën. Pas disa javësh luftë i rrethuan familjen dhe shtëpinë e dogjën, pasurinë ia konfiskuan, i prenë një shumicë të madhe bagëtish edhe i lanë të mos i prekte kush për ta treguar si shembull. Familjet e Ademit dhe Shabanit i çuan në internim në Berat. Atje vdiq djali i Ademit, Skënderi e dy vajza të vogla të Shabanit. Dy fëmijë të tjerë vdiqën më vonë te shtëpia (pasi u liruan nga kampi). Gjatë atyre viteve në mal, Adem Gjurra asnjëherë nuk ka marrë as bukë, as strehim me forcë. Ai është larguar, edhe nëse zoti i shtëpisë e mirëpriste, nëse shihte varfëri të tepërt ose rrezik të tepërt për atë shtëpi. Kjo shpjegon se askush nuk i shiti, nuk i tradhtoi as në vitin 1950, as më përpara.

AKTIVITETI NË ARRATI DHE ARRATISJA NË GREQI

Gjatë qëndrimit në mal, Ademi Gjurra ka marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e të arratisurve: Thark (maj 1945), Bresht të Oroshit (fund i qershorit - 18 korrik), Lurë, ku ka përfaqësuar shumë grupe, si për shembull: të Mehdi Ndreut, Qazim Lushës, si edhe të Reçit e të Dali Meçit, Sali Shehut dhe shumë grupe të tjera të vogla e të mëdha. Në mbledhje ishin shumë grupe nga gjithë Shqipëria, por një numër i madh ishin kundërshtarë politikë me Ahmet Zogun, por Ademi u foli për mbretërinë. I bënë oferta të shumta të kalonte me parti të tjera, por ai mbeti besnik i idealit të vet. Në fund të korrikut të vitit 1946, Ademi Gjurra mori kërkesë nga Muharrem Bajraktari të bashkoheshin për të kaluar kufirin për Greqi, sepse shokët nuk niseshin pa Ademin. U takuan në Kolosian te Lera e Sorrave më 18 gusht dhe u nisën me datë 25 gusht. U bënë 56 vetë nga krahina të ndryshme të Shqipërisë dhe nga Kosova. Rreth datës 5 shtator, gabimisht ranë në Maqedoni. Plasi lufta, e cila zgjati dy ditë e net. U ndanë dhe u bashkuan natën e parë. Vendosin dhe provojnë për të kaluar natën e dytë pa zhurmë dhe pasi ecën deri diku, panë se vendi ishte plot me ushtri të armatosur. Sërish plasi lufta, u ndanë dy grupe për dy drejtime, me shpresën se do të shiheshin matanë kufirit. Ato dy ditë u vranë 27 shokë. Nebi Seda nga Arrni, Lum e Haxhi Agaj nga Puka nga grupi i Ademit. Përfundimisht kaluan në Greqi me shumë humbje në shokë dhe plot dhimbje. Me disa shokë që u ndanë atë natë, u takuan më vonë në një kamp. U dorëzuan edhe u dërguan nëpër kampe rajonale, ku vuanin shumë edhe për bukë. Në kampin e Haxhi Qiriakos kaluan pak më mirë. Ademi me shokët: Myftar Spahija, Hysen Salku, Sejdi Bajo, Hysen Terpeza, Fiqiri Dina organizuan Lëvizjen Monarkiste në Greqi.

ADEMI CAKTOHET KRYETAR I RINISË PËR ANËTARËSIMET E LËVIZJES MONARKISTE

Adem Gjurra u caktua kryetar i Rinisë për anëtarësimet dhe zbatimin e programit. Shpenzime për materiale i paguanin të rinjtë deri në shitjen e racionit të bukës. Në mars të vitit 1949, i dërguan shoqata humanitare në kampin "Santa Fara" në Bari të Italisë, atje ku jeta e përditshme u përmirësua. Në kamp, Ademin e punësuan si përkthyes edhe organizator i refugjatëve shqiptarë me një rrogë të vogël, të cilën e përdorte për nevoja të shokëve. Në pranverë të vitit 1950, u formua Komiteti "Shqipëria e Lirë", organizatë që përfshinte e përfaqësonte të gjitha grupet nacionaliste edhe Mbretin Zog, me qendër në Romë. Kryesia u caktuan: Abaz Ermeni, Abaz Kupi, Mit'hat Frashri, Sait Kryeziu e pas vdekjes së z. Frashërit, Hasan Dosti, sekretar u caktua Gaqo Goga. Kjo organizatë u krijua në marrëveshje me SHBA-në dhe Anglinë për stërvitje, materiale e transport, për një veprim për Shqipërinë e Lirë. Gjatë viteve të qëndrimit në Greqi dhe Itali, Adem Gjurra inkuadroi rreth 1000 anëtarë në organizatë që e mori emrin "Organizata Lëvizja e Legalitetit". Në muajin maj, Gaqo Gogo u takua me Ademin edhe i shpjegoi situatën dhe me takime të vazhdueshme e ngarkoi të rekomandonte shokë më të afërt për këtë organizim politik në shërbim të kombit. Ademi pati takime me drejtuesit e Komitetit, të cilët e autorizuan të zgjidhte 25 shokë të vet për mision, ku njëri prej tyre ishte kushëriri Shaban Gjurra.

NË VITIN 1950 DËRGOHEN NË GJERMANI SI PJESË E "KOMPANISË 4000" DHE MISIONI NË SHQIPËRI

Në qershor 1950, i dërguan në Gjermaninë Perëndimore në një kompani ushtarake Amerikane në afërsi të Mynihut, që quhej "Kompania 4000". U formuan tri toga, Legaliteti, Balli Kombëtar dhe të Pavarurit e Sait Kryeziut. Adem Gjurra u caktua zv.komandant i togës së Legalitetit, me detyrë oficer roje i objekteve të ushtrisë amerikane në Gjermani, për faktin sepse kishte pasur eksperiencë, sepse kishte qenë në xhandarmëri në kohën e Mbretit Zog. Të tjerët u caktuan në punë të tjera: kuzhinë, magazinë, shofer, arkiv etj. Pas disa muajsh kanë ardhur dhe e kanë hipur në makinë, nuk ka pasur as paralajmërim, e kanë marrë me të tjerë duke i çuar në stërvitje për t'u përgatitur në 2-3 vende. Brenda kompanisë gjërat personale të tyre janë sekuestruar, i kanë magazinuar me çelës, sepse këta do të ishin njerëz pa dokumente ku do të shkonin. Gjatë stërvitjes, Ademin e kanë caktuar komandant i personave në stërvitje. Ata stërviteshin nga amerikanët dhe anglezët, por me marrëveshje të plotë me Komitetin "Shqipëria e Lirë". Pas një prej stërvitjeve janë ndarë në 4 grupe për t'u nisur për Shqipëri. Ademi ishte komandant i grupit të parë, por për arsye të ndryshme u caktua të ishte edhe kryetar i Misionit të Parë të organizuar prej Komitetit "Shqipëria e Lirë" dhe erdhi të luftonte për çlirimin e shqiptarëve nga regjimi komunist. Dy grupe u ndalën para desantimit. Të Dibrës e të Lumës vazhduan. Grupi i Ademit ishte caktuar për desantim në Martanesh, Dibër; me u bashkua edhe Iljaz Toptani. Natën e 19 nëntorit të vitit 1950, ata janë lëshuar me parashutë teksa kanë rënë në pritën e komunistëve, duke qenë se ky mision rezultoi i tradhtuar. Siç më vonë u kuptua, ai që kishte tradhtuar ishte Kim Filbi. Kur kanë rënë me parashutë, Xhetan Daci është vrarë duke rënë dëshmor, Selim Daci dhe Iljaz Toptani janë kapur

Adem Gjurra ishte pjesëtar i një familjeje atdhetare, e cila kishte luftuar për çlirimin e Shqipërisë që nga koha e Turqisë.

gjermanët, regjimin komunist të Tiranës dhe Beogradit



Letra e Nikolla Bethel per Ademin

të gjallë, kurse Adem Gjurra, i plagosur dy herë dhe Sali Dalliu pas një rezistence, kanë mundur të largohen nga vendi. Me ndihmën e popullit dibran ka mundur të shkojë deri në Reç, ku është takuar me pjesëtarë të familjes, tek shtëpia e kushërinjve, Rexhep dhe Zenel Gjurra, dhe është mjekuar për t'u larguar sërish. Ushtria e policia zhvilluan operacion të ashpër në rajon, ku u vra kushëriri i Ademit, Rexhep Gjurra, dhe u burgosën e u torturuan shumë të tjerë, si dhëndri i Ademit, Maliq Qenani nga Arrëni. Ademi vendosi të kalonte kufirin që të lajmëronte Komitetin të mos vazhdojnë misionet, se ishin tradhtuar.

PAS OPERACIONIT TË "KOMPANISË 4000", ADEMI LARGOHET NGA SHQIPËRIA, TORTUROHET NË BURGUN E SHKUPIT

Adem Gjurra, pas misionit të tradhtuar të "Kompanisë 4000", e kaloi kufirin shqiptar në fund të dhjetorit të vitit 1950, me Sali Dalliun, ku i kapi roja kufitare jugosllave. Në fillim i trajtuan shumë mirë dhe madje i mjekuan edhe këmbën e plagosur Ademit. Pasi lajmëruan qendrën, erdhën të tjerët, me uniformë e civilë, dhe i transferuan në burg të Shkupit. "Varri i shqiptarëve" e kujtonte Ademi Gjurra sa ishte gjallë. Atje filluan me pyetjet rreth arsyeve të kalimit të kufirit. Ademi kuptoi se i kishin fakte të misionit të "Kompanisë 4000" edhe u tregoi se kishin qenë me një mision kundër Enver Hoxhës. Pas një kohe jugosllavët i kërkuan të pranonte se ky plan e përfshinte edhe Jugosllavinë. Ademi nuk pranoi. Pas disa ditëve nisën të pyesnin rreth kalimit nëpër Maqedoni në vitin 1946, ku ishin vrarë mjaft ushtarë jugosllavë. Ademi shprehu çudi karshi numrit që ata deklaronin, por refuzoi të pranonte se kishte kaluar nëpër tokën jugosllave. U betua se këmbën nuk e ka lëshuar në tokën jugosllave (pasi për Ademin aty ku kishte shkelur, ishte tokë shqiptare). E kërcënuan duke i thënë se dinin çdo gjë rreth tij dhe se do ta masakronin. Filluan torturat me drogim. Kur i dilte gjumi, e gjente veten në një tjetër birucë. Nuk kujtonte çfarë kishte kaluar. Duke e ditur se i hidhnin drogat në ushqim, refuzoi të hante, por ia hodhën në ujë e pa të nuk mund të rrinte. Vendosi të vriste veten. Biruca ka pasur një dritare të vogël me tel e hekur shumë lart. E ktheu krevatin e hekurit së gjati, e vuri kundër murit, hipi në majë, kapi hekurin e dritares me një dorë dhe me tjetrën vuri stilografin në gjoks tek zemra edhe kërceu poshtë në tokë. Stilografi u thye, gjysma brenda gjoksit, po nuk vdiq. Ia morën krevatin, e lanë në tokë, me një batanije të grisur, për sa kohë qëndroi në birucë.

LIRIMI NGA BURGU, MBAJTJA NËN SURVEJIM DHE FTESA E REFUZUAR PËR BASHKËPUNIM

Pas lirimit nga burgu Adem Gjurrën gjithmonë e mbanin nën survejim. Ademi e lajmëroi Komitetin në mënyrë sekrete të mos çonin më misione në Shqipëri. Nuk i vunë rëndësi. Misionet fatkeqësisht vazhduan. Njëkohësisht autoritetet jugosllave haptas i kërkonin bashkëpunim, se gjoja ishte më i miri nga të tjerët, por Ademi ishte nacionalist dhe nuk e hante atë çorbë. Rreth fundit të vitit 1951, e dërguan në një spital për mjekim. Ishte spital psikiatrik, por atje ekzistonte një departament që merrej veç me kundërshtarët politikë. Ademi u torturua me drogë dhe korrent e gjithçka tjetër. Adem Gjurra kujton se ka pasur nacionalistë nga gjithë pjesa e Jugosllavisë. Aty futeshin kundërshtarë dhe dilnin të çmendur. Ademi u lirua pas një muaji e gjysmë. E lejuan të shkonte në Mitrovicë, Kosovë, me banim. E lavdëronin, e merrnin në tubime e mbledhje të kosovarëve. Pasi Ademi e pa se si i kështilloi shteti vetë të griheshin në luftë kundër shtetit, filloi t'i kështillonte kosovarët të kishin kujdes, se askush nuk do t'u vinte në ndihmë dhe ushtria jugosllave do ta bënte Kosovën hi. Gjatë këtyre viteve filluan e vazhduan misionet jugosllave në terren në Shqipëri. I ofruan Ademit t'i sillnin familjen në Jugosllavi, por ai refuzoi, se e dnte se do t'i përdornin t'i strehonin për bashkëpunim. Në atë kohë u mor vesh për disa vrasje nga terrenistët në Shqipëri edhe Ademi i denoncoi si tradhtarë të shitur te armiku.

INTERNIMI NË SHABAC TË SERBISË DHE VENDOSJA NË KAMPIN GEROVA NË SLLOVENI

Për arsyet e mësipërme Adem Gjurrën e bënë pako natën edhe e internuan në Shabac, një qytet në veri të Serbisë, pa popullatë shqiptare. Ka qenë viti 1953 dhe atë vit u internuan rresta e parashutistëve e ca të tjerë, përafërsisht 60 vetë. Disa i kthyen, po çuan të tjerë gjatë vitit 1954. Sali Dalliu u martua me një grua kosovare, sikurse edhe Halil Nerguti. Ademi, ngaqë ka jetuar më shumë nën presion, vendosi të martohej me një vajzë nga zona e Shabacit. Më 28 shkurt 1954, Adem Gjurra u martua me Milica Risticin, me lejen e familjes së saj. Më 15 janar 1955, i lindi një vajzë, Afërdita. Një shok i luftës antikomuniste, Gjon Gjini nga Fani i Mirditës, e bëri kumbarë. Gjatë vitit 1954, shokët nisën të emigronin për në Perëndim, disa nga ndihma e organizatave politike, të tjerë fetare e disa pa shpjegim. Ademi i mblodhi shokët e misioneve të Komitetit edhe vendosën që të mos i nënshtroheshin Jugosllavisë për të fituar të drejtën e emigrimit. Në vjeshtën e 1954-ës, të gjithë shokët bënë të kundërtën. Iu dha leja për në Kosovë edhe pastaj njëri pas tjetrit në Perëndim. Ademi mbeti vetëm dhe i vetmi pa u dorëzuar. Në mars të vitit 1955-ës, Ademi me fëmijën e vogël, Afërdita vetëm 6-javëshe, bashkë me gruan iu dha leja të hynin në kampin Gerova në Sllloveni për procesim të emigrantëve që dëshironin të linin Jugosllavinë. Kur arritën në Gerovë, u pa se ishte një kamp përqendrimi, rrethuar me tre rreshta tel të ashpër, me kasolle për ushtarë të armatosur; lagështirë, ftohtë, shumë pak ushqim. Ishin 80-100 vetë në një dhomë (ndërtesat kanë qenë kazerma ushtarake të shumë kohëve përpara). Filluan sëmundje. Për dënim u dërguan njerëz në podrum. Shumë nuk dolën më, pasi nuk mbijetuan. Hungarezët u torturuan edhe më keq, u vranë shumë.



Ademi ne Kompanine 4000



Familje qe la Ademi ne Shqiperi

E KTHEJNË SËRISH NË SHABAC PAS 5 MUAJSH NË NJË SHTËPI 3 ME 3 METRA

Pas 5 muajsh i kthyen të gjithë personat me nënshtetësi jugosllave, Milicën e Afërditën. Qanin fëmijët dhe baballarët. Më vonë e kthyen dhe Ademin në Shabac, me gjithë të tjerët që ndodheshin në atë kamp. Adem Gjurra me familjen u strehua të prindërit e Milicës për një kohë. Në fund të 1955-ës u detyruan të futeshin në një dhomë 3 me 3 metra në qytet, pjesë e ish-stallës së kuajve, ndërtuar me qerpiç të dobët. Kushtet ishin skandaloze, çatia pikonte, rridhnin ujë muret. Ishte dimër, akull brenda muresh, fëmija (Afërdita) u sëmur rëndë, ilaçe kishin shumë pak ose hiç. Adem Gjurra u sëmur dhe shkoi në spital, por prej andej doli më rëndë. Pas një kohe e diagnostikuan me TBC, sëmundje që nuk e pati kur hyri në spital në vitin 1956. Gjithmonë besonte se e kishin helmuar të UDB-së, që të vdiste nga sëmundje natyrale, se në këtë kohë nuk mund ta vrisnin më. Nuçi Kota, pasi u bë kryetar i Lëvizjes së Legalitetit, e regjistroi në shumë organizata edhe të OKB-së, në Komisionin për Persona në Rrezik për Arsye Politike, Kombësie ose Feje. Jugosllavët kishin pak frikë reaksionin në vise shqiptare në Jugosllavi ta burgosnin ose ta vrisnin drejtpërdrejt. Kushëriri i tij, Shaban Gjurra, i çoi disa antibiotikë, sikurse edhe shokët, shumë prej të cilëve emigruan në SHBA nga Gjermania. E ndihmonin edhe me pak para ose pako. Kjo ndihmë për Ademin, ndonëse e vogël, ishte e madhe, pasi ai e kuptoi se nuk ishte i harruar. Sa për udhëheqjen e OKLL, përveç Nuçi Kotos, askujt nuk i ka ra mendja. Fatkeqësisht, Nuçi vdiq pas pak vitesh. Megjithëse shteti merrte rreth 80 $ në muaj për çdo emigrant nga ndërkombëtarët, Ademit i dorëzonin 3$... më vonë 5... 7... deri pasi 10 vjetësh u bënë 21. Milica filloi me punë të rëndë, punë burrash. Sa ta merrte vesh UDB-ja, e urdhëronin ndërmarrjen ta përjashtonin Milicën nga puna. Ademi ka qenë i kufizuar të lëvizte vetëm brenda qytetit. I thanë se po të zgjatej një hap më shumë, nuk e kishte jetën të sigurt. Jugosllavët do të gjenin një mënyrë ta vrisnin. Edhe 10 km te prindërit e Milicës, veç me leje të shkruar shkonte, nëse e jepnin. Tek spitali nuk kishin të drejtë mjekët ta vizitonin, edhe nëse ishte në rrezik jete, pa autorizim nga policia dhe UDB-ja. Adem Gjurra ka vuajtur shumë me gjithë familje në Serbi. Shumicën e veshmbathjeve që u vinin nga SHBA-ja, i shisnin për qira, korrent, të paguante borxhet te dyqani etj. Gjatë qëndrimit në Shabac, gjithmonë i bënin oferta Ademit të bashkëpunonte, të paktën të marrte nënshtetësinë, por ai e refuzoi.

KUSHËRIRI E NDIHMOI TË LARGOHEJ NGA JUGOSLLAVIA NË ITALI E MË PAS NË SHBA

Në vitin 1966, dikush bëri gabim te konsullata në Amerikë edhe i dhanë Shaban Gjurrës vizë për Jugosllavi. Sa u mor vesh në Shabac, e transportuan Ademin me familje në një banesë me një kuzhinë dhe një dhomë në periferi të qytetit, e cila kishte kushte të mira krahasuar me atë ku ishin. Shabani, kushëriri i Ademit, shkoi në Jugosllavi e bëri plane të vinte pas një viti ta ndihmonte Ademin për t'u larguar. Në vitin 1967, Shaban Gjurra shkoi sërish në Jugosllavi. U paguan disa zyrtarë dhe u gjet një pasaportë false për Ademin. U thanë të gjithëve se do të shkonin në bregdet me Shabanin edhe u nisën me tren. Në fillim të gushtit arritën në Trieste. I priti një mik, Zef Shyti, edhe i dorëzoi tek kampi për refugjatët. Atje qëndruan një muaj, u transferuan në kampin në Latina, ku qëndruan 5 muaj. Arritën në Nju-Jork më 6 shkurt 1968. Ademi punoi pak kohë dhe doli në pension sikurse gruaja e tij, Milica, pak më vonë. Vajza e Ademit, Afërdita Gjurra, në vitin 1977 mbaroi Universitetin e Qytetit Nju-Jork në degën e Antropologjisë dhe punoi në sektorin privat.

AKTIVITETI POLITIK I ADEM GJURRËS

Aktiviteti politik i Adem Gjurrës nuk pushoi kurrë. Ka vazhduar punën dhe lidhje politike me Abaz Kupin e me shokë të tjerë në Amerikë. Ademi komunikimin me Abaz Kupin e ka pasur vazhdimisht në Amerikë, po edhe në Shqipëri gjatë luftës, shpesh përmes të nipit, Hasani Kupit. Ademi ka qenë mik dhe bashkëpunëtor i Gaqo Gogës, Xhemal Laçit, Fuat Myfties etj. Vazhdimisht ka qenë në kryesinë e Legalitetit në Komitetin Qendror të OKLL-së gati gjatë gjithë kohës. Në vitin 1976, dega Nju-Jork u shkatërrua gati e gjitha, po shuhej, dhe me urdhrin e Mretit Leka e mori Ademi edhe



Adem Gjurra

e ngriti fuqishëm si degë për t'ua dorëzuar më vonë të tjerëve. Ademi nuk ka pasur aspak xhelozi dhe nuk ka qenë ambicioz më shumë sesa duhej. Dëshira dhe puna e jetës e tij ka qenë të njihen sakrificat e anëtarëve të "Kompanisë 4000"; ata që u vranë, u kapën, u torturuan, edhe të gjitha familjet e tyre kanë vuajtur shumë. Për fat, kjo ndodhi me dekorimin që Presidenti Nishani i bëri "Kompanisë 4000". Adem Gjurra është takuar me Mbretin Leka shumë herë. Ka marrë pjesë dhe ka kontribuar tek shoqata shqiptaro-amerikane "Vatra", në hapjen e xhamisë së parë të komunitetit në Nju-Jork, ka kontribuar për Legalitetin dhe mbrojtjen e kosovarëve të burgosur nga shteti jugosllav etj., por shpeshherë në mënyrë private. Ka kontribuar edhe në shoqatat për mbrojtjen e drejtave të njeriut si edhe të atyre që punonin për zhdukjen e varfërisë në vende të ndryshme të botës. Gjithmonë ka këshilluar se arsimi është shpëtim për njeriun dhe Atdheun. Ndihma dhe inkurajimi për studentin ka qenë një filozofi e jetës për Ademin. Adem Gjurra është dekoruar "Pishtar i Demokracisë" nga Presidenti Sali Berisha.

KUSH ËSHTË ADEM GJURRA

Adem Gjurra ka lindur në Reç të Dibrës më 13 mars 1912 dhe vdiq më 6 janar 1985. Ishte pjesëtar i një familjeje atdhetare, e cila kishte luftuar për çlirimin e Shqipërisë që nga koha e Turqisë. Ishte i biri i Hysen Shaban Gjurrës, i dalluar për trimëri. Në Shqipëri ka qenë i martuar me Xhevahire Markun me të cilën pati gjashtë fëmijë dhe vetëm dy i jetuan, Ismail Gjurra dhe Sali Gjurra. Ndërsa jashtë Shqipërisë u martua me Milica Risiçin, me të cilën ka një vajzë, Afërdita Gjurrën. Fatkeqësisht, vdiq në vitin 1985 në SHBA dhe nuk e pa më Atdheun e dashur ose familjen që la në Shqipëri. Në varrimin edhe në pamje erdhën rreth 4000 shqiptarë dhe të huaj.

Bulqiza është një vend me klimë të ashpër, por me njerëz të butë, shpirtmirë, besnikë, bujarë e arsimdashës.

Ditë festive *në shkollën "Xhevdet Doda"*

25-Nëntori i sivjetmë ishte ditë festive në shkollën "Xhevdet Doda" të Bulqizës. Erdhën këtu për të festuar bashkë me mësuesit dhe nxënësit e shkollës, që mban mbi shpatullat e saj 65 vjet, ish mësues e nxënës të kësaj shkolle, aq të dashur për të cilën ruajnë mbresa e kujtime të shumta. Këta të fundit u pritën me dashuri e respekt, me këngë e valle, siç dinë të presin qytetarët e Bulqizës. Bulqiza është një vend me klimë të ashpër, por me njerëz të butë, shpirtmirë, besnikë, bujarë e arsimdashës.

Ambientet ishin të bukura, që nga hyrja. Shkolla ishte rikonstruktuar dhe mirëmbajtur mirë, si klasat e kabinetet, gjithçka ishte në vendin e duhur. Që në hyrje, korridoret e kësaj shkolle tregonin për punën e madhe e plot pasion që bëhet në këtë shkollë nga kolektivi pedagogjik dhe drejtuesit e saj.

Sipas programit, vizita në shkollë, nisi me takime me mësuesit, që krijoi një ngrohtësi e dashamirësi tek të gjithë. Në një dhomë muzeale me stenda, ishin disa foto të hershme, ku shumë prej nesh gjetëm veten tonë. Kjo tregon kujdesin e mësueses të historisë, Valbona Vladi (Cani). Kjo mësuese është angazhuar për plotësimin e freskimin e historikut të shkollës nga viti në vit, punë për të cilën është për t'u përshëndetur. Në klasat dhe kabinetet mësimore, sidomos në klasat e para të 9-vjeçares, janë sistemuar me kujdes historiku, të dhëna nga informatika, kabineti i edukimit fizik, që bashkë me stendat e afishuar në korridoret e gjëra me shumë dritë, janë sistemuar me kujdes nga mësuesit. Aty ishte puna e mësuesit Raimond Cani, ku kishte veçuar stendën e ish drejtuesve të kësaj shkolle. Këto të dhëna nga stendat, rikthyen secilin prej nesh në vitet e punës sonë disa vite më parë.



Në klasat dhe kabinetet mësimore, sidomos në klasat e para të 9-vjeçares, janë sistemuar me kujdes historiku, të dhëna nga informatika, kabineti i edukimit fizik, që bashkë me stendat e afishuar në korridoret e gjëra me shumë dritë, janë sistemuar me kujdes nga mësuesit.

BASHKËBISEDIME ME KOLEGË E ISH KOLEGË

U mblodhëm bashkë, të moshuar e flokëbardhë, me më të rinj, që dy palët kanë një qëllim: mbarëvajtjen e edukimit të brezit të ri. Nisën të bisedojnë të moshuar e të rinj, pensionistë e mësues në punë. Pra gërshetim brezash mësuesish. Bisedat u hapën për ish nxënësit ekselencë të shkollës, si Zenel Duriçi, Ylber Sh.Cani, Lulëzim Daci, Lulëzim Sharku, Flutura Stojku, Selami Xhepa, Behije Duka, Engjëll Qorlaze, Altin Muça e Edi Kola. Fjalën e merr mësues Selmani, i cili thotë se në shumë konkurse të rrethit tonë kanë kanë shkëlqyer nxënësit tanë, si në matematikë, biologji etj, gjë që ka ndikuar shumë në fitimin e të drejtës në shkolla të larta. Përveç këtyre shumë nxënës të tjerë kanë shkuar për studime në Turqi, siç është Ornela Doçi; në Gjermani Elizabeta Marku, në Oksford Eridona Duriçi, në Angli Klara Mera etj.

Vjollca Kosaqi, u shpjegon mësuesve të rinj, se puna me pasion e mësuesve zgjedh talentet. Ajo, duke kujtuar disa ish nxënës të saj, thotë se ata që kishin talent, vazhduan specialitete të zgjedhura, siç ishin Petrit Duriçi në pikturë, Luan Hysa dhe Behar Mera për aktrim etj. Beharin e patëm edhe koleg këtu në shkollën tonë. Ndërsa Elida Abdiu (mësuese muzike) flet për veprimtaritë e shumta kulturore-artistike, që mbajtën gjallë pallatin e Kulturës në Bulqizë, duke përmendur nxënës e mësues të kësaj shkolle, si Jete Mazari, Hide Jangulli, Fllanxa Çupi etj.

"Unë, -thotë Bujar Navaku, - kam qenë mësues në vitet 1961-1962 dhe 1965-1967. Bulqiza ka patur gjithnjë mësues të mirë e nxënës cilësorë. Më kujtohen, Jonuz Muça, Skënder Sharku, Shemsi Ceka, Zymbyle Zeneli, ZiseMuça, Kize Zeneli, Ramiz Gjoka, Sabri Alliu etj. Në koridor, në një stendë, ishin afishuar mësuesit që nuk jetojnë: "Ata i njeh gjithë qyteti. Ne kemi punuar bashkë, kemi përjetuar ngjarje, episode, kemi qarë hallet familjare etj. Ishim qytetarë të Bulqizës, miq shokë e dashamirës të njëritjetrit. Aty është Ramizi, Musai, Sabri Abdiu, Skënder Sharku, Faik Cani etj. Të gjithë mund të flasim për shokët tanë. Ata meritojnë mirënjohje e respekt. Qyteti i nderoi, duke u dhënë titullin e lartë "Qytetar Nderi", bashkë me Myfitin, Selmanin, Bashkimin, të pranishëm sot në festën e shkollës.

SË BASHKU DUKE VIZITUAR AMBIENTET E SHKOLLËS

Jashar Shehu, Violeta Kurti, mësuese e edukimit fizik, së bashku me zv.drejtoreshën Albana Elmazi, na shoqërojnë për të vizituar palestrën. Enver Mera me Mukadesin dhe Rolandën thonë, se 'ju kemi zili' për terrenin e bukur sportiv e palestrën, jo se nuk i kemi patur atëherë, bile vetë i kemi ndërtuar me ndihmën e ndërmarrjeve dhe nxënësve, por sot ato ishin më cilësore e moderne. Vajzat tona atëherë shkuan në Lezhë, në vitin 1981, si përfaqësuese të Dibrës në basketboll, ku ishin rrethet e Veriut. "Antoneta Koçi, -ndërhyri Enveri, -qysh më 1986 mban rekordin kombëtar të hedhjes së gjyles. Shpresa Cukalla, Sulltana Voka, Luba Dançe, bashkë me Sanie Gjapin, thanë se ishin me klasat e ciklit ulët, u mrekulluan me bazën materiale didaktike në dispoziçion dhe punën krijuese, që kishin organizuar mësuesit për realizimin cilësor të mësimit, Osmanin, Eminin dhe Shqipe Meçe u njohën me punën e mirë të mësuesve të gjuhëve të huaja dhe të Altin Ketës me kabinetin e informatikës.

Një koktej mbylli vizitën në shkollë, për t'u lënë pak kohë në dispozicion miqve, të lënë me shkrim përshtypjet në librin që ishte vendosur në hollin e katit dytë. Në oborrin e shkollës, grupi artistik, nën drejtimin e mësueses Izabela Kocaqi dha koncertin e përgatitur për festën. Mësuesit grupe-grupe bënë fotografi në kujtim të kësaj veprimtarie, të kësaj dite të shënuar.

Një foto me Sami Ramën, i cili gjithë jetën ia kushtoi mësuesisë, bashkë me të shoqen, Zelihen. Të entuziazmon fakti që Bujar Novaku, ndonëse mësues ndër më të mirët në Grykë të Madhe, tashmë është me gjashtë pjesëtarë në profesionin e mësuesisë, siç janë mësues Rizai, Fiqiriu e Bashkimi (vëllezër), Hazbia (e shoqja), vajza Yllka është mësuese në shkollën "Xhevdet Doda" në Bulqizë. Myfit Dervishi gjithashtu me të shoqen, Safijen; vajza Ilda, bashkë me Hamitin (vëllai) mësues. Ylber Cani është nga Ternova. Ku s'ka qenë mësues, së bashku me Ulvijen, erdhën nga Klenja në vitin 1981.

VEPRIMTARI ARTISTIKE, JO VETËM NË SHKOLLË

Grupi artistik dhe orkestra, veshur me kostumet bulqizake, na prinë përmes qytetit me



vallet karakteristike. Takime të përzemërta e urime të sinqerta morëm nga shumë qytetarë e kalimtarë të rastit, të cilët me buzëqeshje na përshëndesnin.

NË TAKIM SOLEMN

Në restorant "Dani" u mblodhëm bashkë. Të pranishmit i përshëndeti zonja Lindita Kaja, drejtoreshë e shkollës. Ajo i falënderoi pjesëmarrësit dhe u uroj mirëseardhjen, ku ndër të tjera tha:

"Erdhët pas shumë vitesh në vatrën tuaj të dijes. Sot kujtoni me nostalgji punën plot pasion, që ju së bashku realizuat në procesin mësimor. Nuk kursyet asgjë nga vetja juaj, dijet, kohën lirë, mendimet, të cilat i vutë në dispozicion në shërbim të fëmijëve të Bulqizës, për ta radhitur shkollën tonë në pararojë të shkollave si motra të rrethit të Dibrës.

Pak më shumë se dy breza, së bashku me ju, ne po luftojmë për formimin e elitës së nxënësve ndër vite, gjë që na mbush me krenari, për gjithçka që është arritur në këtë shkollë. Shumë energji, djersë e sakrifica është dashur të shënohen këto arritje që sot marrin dimensione të reja, si qendër e zhvillimit e përcjelljes së përvojave më të mira, të cilat do t'I pasurojmë e do i çojmë përpara.

Na gëzon fakti – vazhdoi ajo, -që në vitin 2016-17 shkolla jonë u radhit e para në Kartën e Performancës në shkollat e rrethit Bulqizë, çka tregon se kjo shkollë dhe mësuesit e saj janë të motivuar për realizimin e detyrave që shtron shoqëria jonë para shkollës.

Shkolla jonë ka 266 nxënës në ciklin e ulët, me dy grupe, në kopësht parashkollor me 60 fëmijë japin mësim 35 mësues me arsim përkatës e të profilizuar. Në ciklin e lartë janë 283 nxënës. Prania juaj na jep kurajo, forcë e energji për të punuar më shumë në rritjen e cilësisë mësimore-edukative, në shtimin e veprimtarive kulturoro-artistike dhe sportive, duke ruajtur mjediset që ju patë me sytë tuaj", përfundoi fjalën drejtoresha.

Në shenjë respekti, për mësuesit që nuk rrojnë, u mbajt një minutë heshtje. Drejtoresha falënderoi sponsorët e kësaj veprimtarie, si Myfit Duriçi, Bukurosh Koçi, Lefter Alla, Faik Deda, Eduart Keta, Eltion Deda, Egert Disha, bashkë me TV-Bulqiza, që ndoqi festën gjatë gjithë ditës.

Zv.drejtoresha, Durime Lleshi i bëri një rezyme historikut të shkollës, që u ndoq me interes nga të pranishmit. Grupi artistik i shkollës dha disa numra të zgjedhur me këngë e valle, për më se dy orë, bashkë me mësuesit, duke zbukuruar akoma më shumë festën.

Gjatë drekës përshëndeti kolektivin e mësuesve Myfit Dervishi, ish drejtori më i vjetër, ku për 30 vjet punoi në këtë shkollë. Pas tij përshëndeti Bashkim Lami në emër të shoqatës Atdhetare-Kulturore të Bulqizës, duke i dhënë Certifikatë Mirënjohje shkollës "Xhevdet Doda". Drejtoria e shkollës nderoi gjithashtu me Certifikatë Mirënjohje mësuesen e Frëngjishtes, Nekie Shehu, si ndër mësueset e dalluara që punoi 30-vjet në këtë shkollë.

Me urimet më të mira, u ndamë me mësuesit dhe nxënësit të shkollës "Xhevdet Doda", me dëshirën për të festuar jubilarë të tjerë. Për ne ish-mësuesit ishte një ditë feste e paharruar, që do e ruajmë në kujtesën tonë si model organizimi, si vlerësim e respekt për ish mësuesit e shkollës "Xhevdet Doda" – Bulqizë.

Zabit LLESHI
Ish mësues në shkollën "Xhevdet Doda", Bulqizë

sport

Argjendi, vogëlushi dibran që përfaqësoi Shqipërinë në Europë



Dibra gjithmonë ka qenë nje burim i madh i talenteve të cilët kanë shkëqyer në fushat ku ato kanë operuar. Argjendi është një prej tyre. Ai është vetëm 13 vjec, lindur më 16 shtator 2004 nga një familje e thjeshtë e cila e mbështet kudo që ai shkon. Ai është 2 herë kampion Shqipërisë, fitues i 9 të medalieve dhe përfaqësues i Shqipërisë në kampionatin Ballkanik zhvilluar në Edirne të Turqisë. Argjend Demozeti sportist I një sporti me origjinë Koreane si "TaeKwonDo" që kohët e po përhapet shumë edhe në Shqipëri. Në një moshë kaq të vogël por me nje vullnet prej të madhi ky djalosh tepër premtues dhe këmbëngulës po arrin një sukses në këtë sport. Prej më shumë se 2 vitesh Argjendi ushtron këtë sport në palestrën e "TaeKëonDo Peshkopi" me trajnerin e apasionuar dhe të palodhurin Arjan Salkurti. Dikur ai ndiqte futbollin, më pas ndryshoi kurbën e sukseseve të tij në një sport pothuajse të panjohur jo vetëm nga ai por dhe nga një masë e gjerë e popullsisë. Ky sport e bëri atë të njohur jo vetëm në shkollë, komunitet por edhe në ballkan ku ai ngriti me plot krenari flamurin kombëtar. Këto fryte erdhën si pasojë e punës së zotit Salkurti.

Profesor Arjani: sic e thërrasin sportistët e vegjël bëri me të vërtetë një punë të palodhur ashtu sic prej disa vitesh e bën pothuajse vullnetarisht për të pasur pjesmarrës në kampionatin Ballkanik të paktën një nxënës të tij. Ai shprehet teper entuziast duke harruar për një moment sakrificat e panumerta që has për të mbajtur të gjallë këtë sport që prej vitesh ai e ka ushtruar vetë në shtetin Grek. Në kampionatin ballkanik të mbajtur në Turqi morën pjesë sportistët më të mirë të ekipeve në federatën kombëtarë të TaeKwonDo në Shqipëri mes tyre edhe kampinoni ynë i vogël që si për ironi të fatit edhe në emrin e tij pasqyron të njëtat aftësi si në jetën reale. Në këtë kampionat morën pjesë 29 sportistë nga e gjithë Shqipëria duke u ndeshur me lojtarë të vëndeve të ndryshme të ballkanit. Argjendi u pati fatin e mirë dhe të keq njëkohësisht duke u ndeshur në ndeshje të drejtëpërdretjtë me ish kampionin ballkanik të 2016 dhe më vonë të 2017 Enes Kapllan, duke e bërë të pamundur që kampioni jonë të fitonte atë ndeshje.

Por kjo nuk e ul asnjëherë dëshirën dhe pasionin e tij për punuar edhe më fort. Ai vazhdon të stërvitet dhe më fort duke qenë më sistematik në stërvitje për të menduar për të tjera ndeshje, kupa, medalje dhe certifikata mirënjohje.

Tranjeri Salkurti u shpreh mjaftë optimist për të duke shprehur që si Dibra ka qindra talente so Argjendi të cilët me pak punë dhe këmbëngulje mund të na bëjnë krenar në Shqipëri, europë apo në botë. Entuziast janë edhe prindërit e djaloshit të vogël Dibran që po bëjnë të pamundurën që biri I tyre te ndjekë ëndërrën e tij. Babai i tij, Durimi një prind model, tregon për gazetën tonë që ndihet me të vërtetë krenar që biri i tij i vetëm po del kampion Shqipërie dhe përfaqesues i Shqipërisë në kompeticione eurpiane. Ai bashkë me gocën dhe gruan e tij e ndjekin atë pothuajse në cdo ndeshje që ai zhvillon kryesisht brënda qytetit të Peshkopisë. Sakrifica të pafund të një prindi për ta parë fëmijën e tyre sa më lart të jetë e mundur.

Argjendi thot se ishte me të vërtetë një eksperience e paharrueshme kampionati në Turqi që edhe pse nuk fitoi ndeshjen. Ai u njoh me sportistë të shteteve të tjera dhe duke krijuar mardhënje shoqërore të reja. Por ai, nuk është vetëm një sportist i mirë, por dhe një shok dhe nxënës shembullorë që din ta alternojë mjaftë mirë kohën e tij. Mësusit e shkollës 9-vjecare "Selim Alliu", shkollë kjo ku Argjendi zhvillon cdo ditë mësimin shprehen që ai është një djalë aktiv dhe që përpiqet shumë të mësojë. Shokëria e trajton atë si kampion dhe për të ato janë një mbështetje shumë e madhe dhe e pakrahasueshme, dukeqenë se në cdo ndeshje që ai zhvillon shokët dhe familjarët e tij e ndjekin me vëmendje.

Profesori Arjan Salkurit tregon për për vështirësinë e panumërta që ka hasur dhe po has për zhvillimin e këtij sporti në qytetin e Peshkopisë. Një nga vështirësitë ishte mosnjohja e llojit të sportit nga masa. Shumë prindër tregon ai, kishin hezitonin të regjistronin fëmijët e tyre në kurse për këtë arsye. Problemet të shumta të cilat kanë shoqëruar zotin Salkurti në hapjen e kësaj palestre kanë qenë mungesa e ambjenteve, fondeve për mirëmbatjen e mjeteve sportive dhe jo vetëm. Ai shpreson shumë që në të adhmen me kontributin e tij, të sportistëve dhe Federatës Shqipëtarë të TaeKwonDo të bëjnë të mundur që kjo palestër të mos mbetet kaq por të kthehet në "Klubi TaekwonDo Korabi" dhe të ketë mbështetje nga bashkia në bashkëpunim me federatën. Sipas tij këto talentë kanë me të vërtetë nevojë për mbështetje sepse kanë me të vërtetë potencial kampioni. I mbetur peng nga vetja që nuk u bë kampion po punon pa pushim dhe pothuajse falas që të rinjtë Dibran ta kenë këtë mundësi. I kthyer nga shteti Grek, Arjani paguan taksat, qeranë dhe shumë detyrime të tjera pa marrë ndihmën e askujt, gjë kjo që duhet të vlerësuar maksimalisht nga të gjithë. Përvec kësaj ky projekt që zoti Salkurti ka marrë përsipër duhet ti bëhët më shumë promo që zëri të arrijë atje ku Arjani nuk mundet dhe për këtë gazeta jonë do mundohet të bëjë të pamundurën.

Por cfarë është ky sport për të gjithë ato që nuk e dinë?

Taekwondo është emri I artit marcial të kthyer në sport modern ndërkombëtar që është ushtruar prej rreth 20 shekujsh në Kore. Tipari kryesor i këtij sporti është luftimi i lirë. Të gjithë lëvizjet e tij bazohen në shpirtin e mbrotjes, meqënëse Taekwodo është zhvilluar si një mbrojtje kundër sulmeve të armikut. Ky sport e ka origjinën nga Koreja e Jugut dhe përdoret për një sërë arsyesh; vetë-mbrotje, shendet fizik, rekreacion, si dhe zhvillim mendor dhe shpirtëror. Është një sport që zhvillon, shpejtësinë, forcën, ekujlibrin,fleksibilitetin e hallkave të trupit dhe qëndrueshmërinë.

Samet Zagradi





Shkolla e parë shqipe në Kala të Dodës, mbartëse e traditave të dijes e shkollimit

(vijon nga faqja 13)

Shkolla 8 vjeçare Radomirë kishte në varësi:Shkollën e ciklit ulët Tejs, Çernjevë dhe Strodok e cila u hap në vitin 1984.

Në shkollën e ciklit ulët Çernjevë(Kullas)kanë dhënë mësim këta mësues:Faik Shehu,Subi Abazi,Misim Shehu,Mahmut Çima,Dostan Kolgjini,Lindita Domi e Safet Shira.

Në ciklin e ulët Tejs,kanë dhënë mësim:Që në vitin 1946 kur u hap për herë të parë mësuesit:Harun Jakupi,e më pas mësuesit e ardhur nga Shkodra:si Vaskë Peraj,Luçie Ndoja,Lezina Gjini,Luigj Pici,dhe mësues vendas si:Zurie Ahmati(Koka),Fatime Brika,Burbuqe Domi,Sabihate Domi,Mimoza Domi;si Ismet Çorja,Agim Shehu,Bajram Çekiçi,Bedri Abazi,Bashkim Hoxha,Vasfi Cibaku,Xhevdet Hoxha.

Elektrifikimi i vendit në vitin 1970,ishte një ngjarje e rëndësishme edhe për nxënësit e mësuesit e sistemit shkollor në Kala të Dodës.Drita elektrike pranë çdo familje,jo vetëm që lehtësoi punën përgatitore të nxënësve e mësuesve por ndikoi edhe në nivelin e pervetësimit të dijeve nga ana e tyre .

ARSIMI I MESËM NË KALA TË DODËS.

Nevojat e arsimimit të mesëm,për mësues,punonjës shëndetësie,specialistë në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë,si agronomi,zotekni,veterinari,ekonomist etj,deri në vitin 1676,u morën përsipër nga qeveria shqiptare që të plotësoheshin me dërgimin e kontigjenteve të planifikuara për në shkollat e mesme në qytet Peshkopi, Kukës, Tiranë, Elbasan e Shkodër etj.

Në vitin 1962 për herë të parë,nga shkolla 7 vjeçare e Fshatit, me punën e madhe të drejtorit të kësaj shkolle Ali Shehu, u arrit të dërgohen me bursë shteti në shkollën pedagogjike 11 vajza,duke thyer kështu konservatorizmin krahinor,që pengonte arsimimin e vajzave në shkollat e mesme.

Shkolla e parë e mesme,në krahinën e Kalasë Dodës,u hap në vitin mësimor 1976-77,pranë shkollës 8 vjeçare "Sabri Poti "në vendin e quajtur Guri i Qyqes,në mesin e fshatrave Bushtricë,Gjegje,Matranxh, e Palush. Në vitin e parë u rregjistruan 23 nxënës që vinin edhe nga Vila,Kalisi, por edhe nga Vasijet, Ploshtani,Cereni e Radomira. Lëndët e përgjithshme mësimore i jepnin mësuesit e shkollës 8 vjeçare si Zylfi Matranxhi që ishte drejtor i shkollës Hebib Palushi,zv.Drejtor i shkollës,Selaudin Tabaku,Basri Drazhi etj, ndërsa lëndët e specialitetit, që ishte agronomi, i jepnin specialistët e bujqësisë.

Në vitin 1976 u hap edhe klasa e parë e shkollës mesme në degën agronomi në Fshat, ku do të ndiqnin mësimet nxënës nga gjithë krahina e Grykë-Çajës.

Në vitin 1978 hapet shkolla e mesme në Kalis.

SHKOLLA E MESME CEREN.

Në vitin mësimor 1976-77, u hap klasa e parë e shkollës mesme pa shëputje nga puna me 20 nxënës, në degën agronomi,në Ceren, ku jepnin mësim mësuesit e shkollës 8 vjeçare Ploshtan dhe Radomirë, e cila vazhdoi deri në vitin 1981. Më 1 shtator 1981 u hap shkolla e mesme me shkëputje nga puna me drejtor Xhemal Domin,deri në 1983,Metush Skejën;nga viti 1983 deri në vitin 1991,Fadil Daku nga viti 1991 deri në vitin 1993 dhe Iljaz Palushi nga viti 1993 deri në vitin 1995.Nga shkolla e mesme Ceren kanë dalë 9 matura:Matura e parë në vitin 1985 dhe matura e fundit në vitn 1995. Kanë mbaruar arsimin e mesëm në këtë shkollë 150 vetë nga të cilët 60 kanë vazhduar e mbaruar arsimin e lartë. Kanë dhënë mësim në këtë shkollë:Metush Skeja e Ismet Kuteli Biologji,Fadil Daku,Rushit Karaj,Fetah Cala e Isa Lita; matematikë-fizikë. Fiqiri Farruku,Abdurrahman Çekiçi;agronomi,Tajar Domi zootekni, Hasan Përzhilla,Fiqiri Farruku,Jahe Delia e Iljas Palushi, letërsi, dhe më pas Kadri Rrapi mësues i lëndve shoqërore, Petro Koçi e Besnik Shehu anglisht,Hajri Gurabardhi, Shpëtim Brika , Besurim Xhepa, Burbuqe Domi eHurije Skeja etj.

Në vitin 1992,shkollës mesme ju ndryshua profili nga agronomi në arsim të përgjithshëm, por për arsye të lëvizjes demografike të popullsisë së kësaj krahine,dhe largimit për punësim jashtë shtetit, të pothuaj gjithë të rinjve që mbaronin shkollën 8 vjeçare,shkolla e mesme u mbyll.

Ndikim të rëndësishëm në mbarvajtjen e punës në shkolla kanë patur edhe organet e pushtetit si në fshatrat e veçanta edhe në Këshillat Popullore të Bashkuara pranë Kooperativave Bujqësore.

Në Këshillin e Bashkuar Kala e Dodës: Mahmut Hasani,Destan Visha, Rasim Deda,Fadil Daku, Zyber Lita.

Në Këshillin Popullor të fshatit Vasije:Azem Lika, Rexhep Shira,Ajet Shehu,Xhavit Mena,Avdil Shira,e Muharrem Shehu.

Në Këshillin Popullor të fshatit Ploshtan: Ziadin Brika, Hysen Ferati, dhe Zabit Përzhilla.

Në Këshillin Popullor të fshatit Shullan: Sinan Deda.

Në Kshillin Popullor të Fshatit Ceren:Ymer Kadia, Xhemal Shehu,Hasan Skeja,Eshref Visha.

Në Këshillin Popullor të fshatit Radomirë: Isuf Ferati,Shazivar Koka,Vasip Gjorgji,Vjollca Ahmati.

tregim/poezi

Trinom kujtese

Jeta jote nuk është ajo që ke jetuar, por ajo që të kujtohet, ashtu siç të kujtohet për ta rrëfyer. Gabriel Garcia Marquez

Sa herë i kthej vektorët e kujtesës prapa, më del që mbaj mend në imazhe të vagullta deri në moshën 5-vjeçare, ndërsa më tutje, të tjerat nuk janë pos imazhe të ndërtuara me ata çka më kanë treguar prindërit dhe ata që janë më të mëdhenjë se unë, teksa sot, në mënyrë krejt të pavetëdijshme i kam vetësuar si kujtime të miat. Shtëpia ku linda dhe kalova 20 vite të jetë sime, qe një shtëpi përdhesë, pa ziklaturë (ngritje, shkëputje nga toka), rrafsh me tokën, e cila përbëhej nga dy dhoma dhe një sallon. Deri para vitit '97, njëra nga dhomat ishte e pasuvatuar, për tullash dhe për trarësh.

Ndër imazhet e para që kanë zënë vend në kujtesën time janë dy sende: një çifteli dhe një pushkë 10-she. Çiftelia qëndronte e varur në murin e dhomës së rregullt e cila shërbente si dhomë ndenjeje dhe njëkohësiht dhomë gjumi, ndërsa pushka, e varur në murin e dhomës së parregulluar (në odën e pandreqme) Tingullin e çiftelisë e dëgjoja çdo natë ndërsa tingullin e pushkës se kisha dëgjuar kurrë. Kështu që gati sa nuk fillova që për çiftelinë të ndjeja një urrejtje të paprovuar ndonjëherë, dhe nga ana tjetër një keqardhje për pushkën, sepse kudo dëgjoja tinguj pushkash, dhe kurrë tigullin e pushkës sonë, tek në të kundërt askund tingull çiftelie ndërsa në shtëpinë time çdo natë. Pse duhej një armë që s'e përdorje kurrë?!

Pas unë u rrita , dhoma u rregullua, dhe pushka u hoq, ndërsa im atë si për inatin tim, bleu edhe një çifteli dhe e vendosi bash në gozhdën ku mbahej pushka. Ndoshta deshti të zhbënte kujtesën e tij, por fiksoi më fort timen. Ndërkaq, tek rritesha, e gjithë Bota ime ishte fshati im. Mandje rrethi i Botës mu zgjerua deri në horizontet që rrokte syri im. Tashmë e gjithë jeta ime ishte në Luginën e Drinit të Zi, rrethuar me vargmale. Kujtesa mbivendosi imazhe të tjera, të cilat shpesh rëndojnë aq sa ngjeshin në të kujtime që vetë ndonjë qetësi e gjatë mundet ti shpluhuros.

Peshkopia lindi si shkak dhe mandej si pasojë e lënies jashtë kufijve qytetin e Dibrës. E gjithë ajo qendër tregtie, kulture, e zhvillimi, nuk ishte më pos rrëfim në buzët e pleqve me mustaqe. Shpesh im gjysh, rrëfente histori me burrat e Lumës, që kalonin natën në fshatin tonë për të shkuar për tregti në Dibër. Por me çpo shohim dita-ditës, kujtesa kolektive ia ka lënë vendin problemeve politike aktuale.

Në një dokumentar televiziv, rrëfenin disa plaka dibrane se sa mallë ndjenin për familjet e mbetura matanë kufirit, ku s'iu lejohej të kthenin as kokën nga Vija e Kuqe. Ardhja e demokracisë, dhe së fundmi liberalizimi i vizave, nuk bëri gjë tjetër vetëm se polli marrëveshje policore për zhvatjen e xhepave të qytetarëve. Sa herë më duhet të kaloj në doganën që ndan Dibrën me Dibrën, duhet që veç kontrolleve të imtësishme, të paguaj edhe baksishe, sepse polici maqedonas (nuk) ka të drejtën të ndaloj një dibran të futet në Dibër. Nëse do ti referohemi Oscar Wilde-it ku thotë: " Kujtesa… është ditari që ne të gjithë e mbajmë me vete", kur më përmendin Dibrën, për dreq në mendje më vjen polici maqedonas dhe kjo është si me thënë një zhagarravinë në mendjen time.

Njëzetë e tre gushti i 1944-s, është Dita e Çlirimit të Peshkopisë nga pushtuesit gjermanë, ndërsa historiani Uran Butka thekson se Peshkopia, nuk u çlirua nga askush, por përkundrazi u pushtua nga komunistët, duke qenë se në Dibër nuk kishte këmbë gjermani. Pasja e komunizmit për 45 vjet, i zbehu në thelb traditat dibrane, që nga mënyrat e festimeve të dasmave deri tek ceremonite dhe ritualet mortore.

Në një fazë të parë kjo u arrit shumë lehtë, pas miratimit të ateizmit me kushtetutë, duke u bërë kështu të parët në historinë e ekzistencës, shtet ateist. Pra duke qenë se feja mbante në këmbë disa norma kulturore e mandej fetare, nuk kishte një ingranazh në duart e popullit për ti patur e mandej përçuar këto norma në breza.

Pas ardhjes së pluralizmit politik në vendi tonë dhe vendosjes së sistemit kapitalist, pritej që gjërat të viheshin në vijë. Fatkeqsisht, syresh, ndodhi komplet e kundërta. Hapja e kufijve dhe ikja e një pjese të mirë të rinisë Dibrane (Shqiptare në tërësi) dhe kthimi i tyre pas disa kohësh, kontribuoi në zbehjen e kulturës dhe rrjedhimisht të kujtesës sonë kombëtare, duke i rrasur tone të larta mentalitetesh greke, italiane, etj-etj dhe fjalë parazite nga të cilat gjuha jonë nuk sheh kurrëfarë dobie.

Duke parë shkaqet dhe pasojat e kësaj kujtese që gëzojmë ne si komb, mund të them fare lehtë që nuk kemi tjetër pos një "kujtese vegjetative" (term i imi ky). Në këtë përpasje tonën ndikojnë thelbësisht disa elementë: historia që ne studiojmë sot, mediat, letërsia dhe thuajse të gjithë komponentët jetësorë që mban një shoqëri.

Duke qenë se njeriu i kthehet pashmangshëm origjinës së vet, as unë nuk bëj përjashtim (as dua të bëj), madje edhe në këtë ese. U rrita nëpër konaqe burrash: shpesh me histori që rrëfeni krisma, krekosnin gjakmarrje, por edhe shumë raste tingëllonin melodi çiftelishë, këngë burrash dhe vajtime grashë. Gjatë kësaj kohe, kisha një dëshirë të pashterrshme të kuvendoja me tim gjysh.

Një rast e pata pyet: "Po si ka mundësi mor bab' që edhe kur vdes një njeri ju burat por edhe gratë keni akoma dëshira me rrëfy ngjarje të qena e të paqena, madje keni guximin edhe të qeshni me ato që rrëfeni vetë?". Teksa pëdredhte me dorën e majtë cepin e mustaqeve, ndoshat me qëllim më la pak kohë të kuptoja se kisha bërë një pyetje deri diku cinike dhe mandej u përgjigj: Historitë (rrëfenjat, alegoritë e gjithë ç'bëhet në konaqe), janë kujtesa jonë, e shkuara jonë dhe duke i përmendun nëpër mortje, nuk bajm gja tjetër vetëmse mbajm mendt në kreje. Me e degdis dhimbën".

Im gjysh qe një burr tipik dibran. Kishte gjithnjë një mendim të kthjellët dhe ide shumë fine, rrëfente histori dhe alegori sikur të qe diplomuar për aktrim. Dhe thellë mendjen time qe kujtesa e burrit të Dibrës. Të njihje atë, njihje një kulturë. Deri kur e la takati, i binte ëmbël çiftelisë, të cilën ia kishte mësuar i ati që në vegjëli, e ky mandej ia përcolli të birit, domethënë tim ati.

Ja pra e shkuara jonë gjendet në trinomin: pushkë, çifteli, rrëfime. Të vije nga larg dhe t'i dëgjoje tek flisnin, do të dukeshin të gjitha sajesa, por akoma gjërat zgjidhen në mënyra të tilla asburde në vendin tim. Për sa i përket pushkës, nuk ia pata kurrë lakminë, veç atij tingullit që s'ia dëgjova kurrë. Por rrëfimet, çiftelia? Ja që për asnjërën nuk ia kam idenë, aq më pak çiftelinë.

Shkoj shpesh në fshat, dhe sa futem në dhomën e ndenjes varet "enciklopedia" dibrane e varur në mur. I them tim ati dhe e vë në dyzeni. E dëgjoj me një dëshirë të përzier herë pas here me një zhgënjim të thellë dhe kur mendoj që babai s'do jetë më, më bëhet sikur unë jam litari më i kalbur që lidh kujtesën me të ardhmen.

Alban Tufa

"Frymëzimi im" i Dhurim Nazifit

Enjoh nipin tim Dhurimin si njeri me natyrë gazmore, i qeshur, me humor të mprehtë, i qejfit, i valles e i këngës në tavolinat familjare. E kam për zemër. Por, kur rastësisht më lanë në dorë disa poezi të shkruara vite më parë, u befasova, më bënë shumë përshtypje, më lanë mbresa. Me kohë u kthjellova e mendja më tha: "Selami, mos u çudit shumë, gjiri ynë i familjes është shtrat për të lindur poetë, artistë dhe njerëz".

Duke lexuar vargjet e Dhurimit nuk është e vështirë të krijosh në mendje imazhin e autorit. Vargjet e Dhurimit e marrin nismën nga ngjarjet e jetuara, nga emocionet, frymëzimi i çastit, ku Dhurimi trupvogël dhe i imët i ka kthyer ato episode nëpërmjet vargjeve me shumë ndjenjë e dashuri në art.

Ndjeshmëria e tij, prirja natyrale, bëjnë që vargjet e tij të kenë naivitet, melankoli, delikatesë e pastërti, disa herë protestuese, me një protestë të qytetëruar e plot edukatë. Po pa lëshim e me qëndrim moral të qartë e pa mëdyshje.

Vargjet botohen pa iu nënshtruar redaktimit, duke dashur të mbeten këto vargje siç janë, të pastra, të virgjëra e me një stil që është i Dhurimit. Në fund të fundit janë vargje që kanë gjetur rrugën e shpërthimit si nevojë shpirtërore.

Dhurim! Nëse unë jam kënaqur e gëzuar shumë, akoma më shumë janë kënaqur prindërit, familja, fëmijët, të cilët nesër do të jenë krenarë për ty. Po pse jo edhe të gjithë ne.

Selami Nazifi

Pastroju, o flladi im

Dimër ish at'herë, acar i vërtetë
Kur fryni lehtas për ne flladi pranveror
Shiu pushoi dhe u shpërndanë retë
Të gjithë njer'zit morën
ushqimin shpirtëror.

Në revolt' dy gishte, të gjithë ngritëm lart
Dhe diktatorin njëzëri e dënuam
Europën në nuk donim ta kishim larg
Për këtë ideal së bashku luftuam.

Por sot të drejtohem ty fllad i dikurshëm
Përse merr me vete grimcat e acarit?
A nuk të duket ky një veprim i turpshëm
Të vishemi trashë në mes të beharit?

Pastroju, pra, o fllad e fry prapë si dikur
Kur palltot i hoqëm në mes të dhjetorit
Grimcat e acarit kanë veç një flamur
Jo të Europës, por të diktatorit.

Qyteti im

Të dua qyteti im
Në dëborë, diell dhe shi
Çdo pëllëmb' më mbush me frymëzim
Dhe frym' i qet' marr veç tek ti.

Kur largohem ndonjëherë
Për pun' pune a pushime
M'duket vetja si i mjerë
Se jam larg vendlindjes sime.

E kur kthehem, lumturohem
Porsi foshnja npreh'r të nënës
Zotit lart i përgjërohem
T'jem me ty n'çdo rrahje t'zemrës.

Shtrat'n e vdekjes një dit' kur t'zë
Ndoshta n'lindje a n'perëndim
Amanet për eshtrat do lë
T'më prehen veç n'qytetin tim.

Lypësi

Në cep të trotuarit qëndron ulur
Mban një xhaketë të vjetër
dhe një shkop në krah
Njërën dorë shtrirë për t'u lutur
Me shpresën se dikujt do t'i bëjë gjynah.

Përpara syve të tu jeta e gjallë
Me dallgët e saj ti shpeshherë je ndeshur
Ndalet pran'teje ndokush në të rrallë
Por ndonjëherë dhe të kanë përqeshur.

Del çdo mëngjes e largohesh në mbrëmje
Sheh gjithçka por s'trembet kush na sytë e tu
I dëshpëruar shpesh ke thënë me mendje
Kjo botë qenka e keqe veç për mua.

Kur paturpësisht dikush t'ka akuzuar
Ti vetëm qesh pak e me vehte belbëzon
Të kollarisurit po marrin me dy duar
Ndaj një dorë e shtrirë për lutje
s'më turpëron.



Prej mendimeve të mia s'dua të vuaj

Për mendimet e mia dje më denoncove
Pse s'më pëlqente komunizmi
Sot je përsëri ti që prapë m'u afrove
Të mësosh ç'mendoj për këtë demokraci.

Por unë mendimet prapë i kam të lira
Ruaj demokracinë si delet bariun
Por ti që bukën han veç me pun' të ndyra
S'je gjë tjetër veç kafshë me fytyrë njeriu.

Unë vërejtje kam për demokracinë
Derisa te njerëz si ty ajo të mbështetet
Vuajta dje pse fjala nuk kish lirinë
Sot s'pranoj mendimi pa shprehur t'më mbetet.

Qeveritarët

Ju që betimin bëni para flamurit
Dhe merrni emrin qeveritarë
Mos luani rolin e të korruptuarit
Se djersa e popullit ka për t'ju vrarë.

Parlamentarit

Ti që dje më vure prangat mua
E për idetë e mia më the tradhtar
Sot vjen t'më kërkosh votën dhe thua
Demokracinë e dua si çdo shqiptar.

Kur të shoh në sallën e parlamentit
Një grusht të fuqish, si Migjeni kërkoj
Të të godas si vaporin dallga e detit
Dhe se prapë në pranga
prej teje do përfundoj.

Prindi dhe hapat e fëmijës

Çdo shkelje e fëmijës në dërrasë të kalbur
Është për prindin një thikë në zemër
Kur e sheh të hedhë veç hapa të matur
Të çliron nga vitet e të zgjat jetën.

elegji

Një amanet që dhimshëm po e përcjell

Elegji për FatimeTrupen (Shehu) vajzën e Teze Naxhies...



Ajo është e bija e XhemalTrupes nga Staravecii Dibrës dhe e Naxhie Zhuzhit (Trupes), motrës së nënës sime, Defes, kushërira ime e parë, motra e vetme e shtatë vëllezërve me të parin Halilin e në vijim Ramadanin,Menduin, Emriun, Robertin, Ulviun e Ulsiun, bashkëshortja e Riza Shehut, nëna e Iridës dhe e Edit, gjyshja e...

E kërkova në arkivin tim të gjerë fotografik. E gjeta Ditën e Verës të vitit 1991 midis pishave të pyllit modest të Llixhave, në rrethin e ngushtë familjar, qetësi shpirtërore që ta jep gëzimi kur je me rrënjët e tua të jetës...

Po e përcjell zbardhur për herë të parë...

E kisha amanet kushërirën time të dashur, FatimeTrupen (Shehu), amanet nga babai i saj Xhemali që kishte një besim të jashtëzakonshëm për mua. Nuk e di nga i buronte ky besim por për çdo gjë që i thosha nuk e bënte dysh. Kështu ndodhi edhe kur e lidha në miqësi me familjen e Myrteza dhe Mereme Shehut, kur u martua me Rizain...

E kisha amanet nga teze Naxhia, punëtore dhe e dashur sa nuk kishte kandar ti peshonte...

Kam edhe një fotografi të Fatimes. E kam vënë në kopertinën e dytë të librit "Rilindësit e kohës sonë", kohë kur Ajo, pa shkëputje nga puna, vazhdonte shkollën e mesme.

Punonte në Ndërmarrjen e Prodhimeve të Ndryshme në Peshkopi, ishte mjeshtre në punimin e xunkthit dhe të lëvoreve të misrit...

E ku nuk janë shpërndarë prodhimet e shporterisë dalë nga gishtat e saj që fluturonin si mbi tastierën e pianos, në Evropë dhe në kontinentet e tjerë...

Pa arritë të mbushë moshën e pensionit ajo do të merrte një "pension" që rrallë njerëz e marrin si ajo, pensionin e dashurisë të fëmijëve, vëllezërve, kunatave, Edit, djalit të saj, që siç thonë "çfarë i shihte syri ia bënte dora", por edhe nuses,Rezartës një korçare që ia kishte marrë që ditën e parë dhuntinë e dashurisë për t'ia kthyer ditë për ditë e orë për orë. Të mos harroj Iridën vajzën që i kapërceu të gjitha shkallët e dijes me notën më të lartë e ishte krenari e saj.

Vuajti Fatimja një sëmundje të pashërueshme. U tret si qiriri. U tret aq sa kur e pashë para disa muajsh në një foto familjare, një lot më rrodhi brazdave të moshës sime. Më mirë mos e kisha parë, më mirë ta ruaja në kujtesë me atë pamjen e saj dasmave kur vente mashtrapën me ujë mbi kokë e kërcente duke përjetuar nënën e saj dasmave të hershme e gëzimeve familjare...

I qëndruan pranë të gjithë por më duhet të veçoj kunatat e saj, nuset e të shtatë vëllezërve, që ndërroheshin njëra pas tjetrës çdo javë, duke u kujdesur në detaje e duke i dhënë kurajë...

Një kujdes që më ngjan si në legjenda...

Gjashtë javë më parë iku e fundit rrjedhës së hershme të familjes Shehu, Meremja, nëna që do të bëhej jo vetëm gjyshe por edhe stërgjyshe me fëmijën e nipit të saj Edit, djalit të Fatimes. E dinte sëmundjen e saj ndaj uronte që të mos arrinte kurrë ta përcillte. Madje kishte lënë amanet që Fatimja ta qante tek koka sepse ajo dinte ti radhiste fjalët si vajtojcat e motit.

Kushërira ime iku për të mbetur në kujtesën e shtatë vëllezërve, të mbesës më të madhe, Irmës, të kunatave, kunetërve, nipërve e mbesave... një fushe të madhe lulejete.

Natasha, bashkëshortja imeqë bashkë folëm për ta ngushëlluar për ikjen e nënës së saj të dytë, Mereme Shehut, nuk u mbaj kur i tregova lajmin e hidhur. E lau mermerin e bardhë të verandës me lot...

E kisha një amanet për Fatimen, amanet nga babai i saj XhemalTrupja, amanet nga nëna e saj NaxhieZhuzhi (Trupja).

Po e përcjell me dhimbje nga larg...

Hidhni edhe për mua një dorë dheu e ua fshini lotët njerëzve që e deshën si nënë, si gjyshe, si një njeri të thjeshtë të dashurisë së tyre...

Ajo iku midis dashurive të mëdha...

Abdurahim Ashiku

Athinë, 4 dhjetor 2017



TË JESH MËSUES...

Është gjë e bukur të jesh mësues, të shohësh si lëshojnë shtat fëmijët e thithin dituri, si rriten e ngjiten, si lulëzojnë e piqen...
E kam pasur këtë fat vetëm për pesë vjet, nga shtatori i vitit 1967 në shtatorin e vitit 1972. Kam qenë mësues i lëndëve teknike në Shkollën e

Ndahet nga jeta piloti ALLAMAN DESTAN ISAKU



Më 12 dhjetor 2017 u nda nga jeta pas një sëmundje të rëndë piloti i parë dibran Allaman Destan Isaku. Ai lindi në Dovolan të Maqellarës më 18.10.1939. U rrit si fëmija i parë i një familje patriote brez pas brezi, bazë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Arsimin fillor e kreu në fshatin e lindjes dhe atë 7 vjeçar në Shupenzë me rezultate shumë të mira.

Në vitin 1953 filloi shkollën ushtarake "Skënderbej" ku kreu arsimin e mesëm. Në qershor të vitit 1957 i doli bursa për pilot në shkollën e Aviacionit gjuajtës në qytetin Borisoglebsk të Bashkimit Sovjetik. Pas tre vitesh në atë shkollë përfundoi fluturimet në avionët me helikë JAK-18 dhe në avionët reaktivë MIG-15 Bros. Në vitin e fundit, maj 1960 u transferua shkolla në Krasnadar ku kreu fluturimet në avionin MIG-17 dhe u diplomua pilot gjuajtës.

Në fund të tetorit 1960 u kthye në Atdhe, ku u titullua oficer nëntoger dhe u emërua në detyrën komandant ekuipazhi, pilot shoqërues në Skuadrilen e II-të të Regjimentit të 23-të të avionëve gjuajtës "Peza" në Qytetin Stalin (Kuçovë). Gjatë punës së tij ka kryer detyrën komandant çifti, komandnt katërshje, komandant skuadrilje dhe pilot AN-2. Është specializuar për fluturimet në avionë Superzanorë MIG-19S në Rinas më 1970. Ka qenë pilot i talentuar duke fluturuar në të gjitha llojet e fluturimit, ditën dhe natën.

Ka meritуar titujt Pilot luftarak i klasit të III-të dhe klasit të II-të. Ka qenë miratuar dhe ka punuar pilot instruktor për të gjitha kushtet metereologjike, ditën dhe natën. Ka përballuar me sukses të gjitha vështirësitë fizike e mendore të ndeshura në fluturim, duke meritуar dhe medalje e dekorata të ndryshme të shërbimit ushtarak.

Ka qenë i thjeshtë, njerëzor, i dashur me shoqërinë, human dhe dashamirës. I lidhur ngushtë me familjen dhe hallet e saj në Dovolan. Ka punuar vetë dhe me bashkëshorten në aksionin për elektrifikimin e fshatit të tij dhe lokalitetit duke dhënë një shembull të shkëlqyer për popullatën e krahinës, duke u vlerësuar nga Drejtuesit Vendorë të Pushtetit. Ka qenë aktivist i dalluar shoqëror dhe ka kryer shkollën e lartë të Partisë në Tiranë.

Ai krijoi një familje të theshtë, u martua me Dritën, arsimtare me origjinë nga Përmeti dhe banuese në Kuçovë, ku lindën dhe rritën dy fëmijë të mbrekullueshëm, Drinin dhe Valbonën.

Më 1972 për arësye shëndetësore ndërpreu fluturimet me avionët reaktivë dhe vazhdoi në ato me helikë AN-2 ku u transferua në Tiranë.

Duke qenë i drejt për drejtë në kryerjen e detyrës, i hapur e kritik ndaj disa veprimeve të tepruara në ushtri, si shumë të tjerë edhe Allamani nuk i shpëtoi veprimtarisë së ligjit famëkeq të Agjitacion propogandës duke e ndaluar nga fluturimi e liruar nga ushtria. Por Allamani nuk u dorëzua, përballoi me sukses ndëshkimin e pa meritуar dhe qëndroi dinjitoz për veten, familjen dhe shokët që nuk e braktisën.

Ai ka gëzuar gjithmonë respektin e shokëve, të vartësve dhe eprorëve, të gjithë njerëzve të fisit, të të dy familjeve, atyre Dibrane dhe Përmetare.

Sëmundja e tij e rëndë dhe e parakohëshme shqetësoi gjithë njerëzit që e kanë njohur, por në rradhë të parë familjen, bashkëshoten Drtën e fëmijët Drinin e Valbonën, vëllezërit, nipërit e mbesat dhe ne shokët e shkollës ushtarake e të punës në ushtri që i qëndruam afër dhe i dhamë kurajo. Lamtumirë shoku ynë i dashur dhe i paharruar Allaman !

U mprehsh në paqë në tokën Mëmë !

Qirjako Dhima, Agim Vodopi, Sybi Koçi, Drini Shtylla, Budjon Tollkuçi, Zydi Meçe, Bajram Dervishi

Big Market "Ken"

ju uron

Gëzuar vitin e Ri 2018!



JANAR

E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË	E DIEL
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31	1	2	3	4

SHKURT

E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË	E DIEL
29	30	31	1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	1	2	3	4

MARS

E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË	E DIEL
26	27	28	1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	1

PRILL

E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË	E DIEL
2	3	4	5	6	7	1/8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	1	2	3	4	5	6

MAJ

E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË	E DIEL
30	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31	1	2	3

QERSHOR

E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË	E DIEL
28	29	30	31	1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	1

KORRIK

E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË	E DIEL
2	3	4	5	6	7	1/8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31	1	2	3	4	5

GUSHT

E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË	E DIEL
30	31	1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31	1	2

SHTATOR

E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË	E DIEL
27	28	29	30	31	1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30

TETOR

E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË	E DIEL
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31	1	2	3	4

NËNTOR

E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË	E DIEL
29	30	31	1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	1	2

DHJETOR

E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E SHTUNË	E DIEL
26	27	28	29	30	1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	23	23
24/31	25	26	27	28	29	30

Adresa: **Rr. "Durrësit", Blloku Gintash, Laprakë, Tiranë.** *Tel/Fax:* **+355 4 24 13 261** *Mob.* **+355 68 20 36 394.** *E-mail:* **nimet_ricku17@hotmail.com**

cyan magenta yelloë black